



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 93

Tiranë – E premte, 22 maj 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 20.5.2020	Për miratimin e dokumentit të politikave “Për qeverisjen e sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, 2020-2030”..... 5433
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 403, datë 20.5.2020	Për një ndryshim në vendimin nr.270, datë 2.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS)”..... 5483
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 404, datë 20.5.2020	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikim urban Sheshi Borsh, Himarë”..... 5484
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 20.5.2020	Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor në Shqipëri 2020-2025..... 5486
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 20.5.2020	Për daljen jashtë përdorimit, për qëllime kullimi, të një pjese të infrastrukturës së kullimit, në Bashkinë Berat..... 5509
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 20.5.2020	Për miratimin e çmimeve të shitjes së teksteve të botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, “Klasikët dygjuhësh” dhe “Fjalor dygjuhësh për fëmijë” dhe të kategorive që përfitojnë falas kopje të teksteve..... 5517
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 409, datë 20.5.2020	Për lirim nga detyra..... 5518
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 193/2, datë 14.5.2020	Për një ndryshim në urdhrin nr. 193, datë 20.3.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 5518
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 193/3, datë 15.5.2020	Për një ndryshim në urdhrin nr. 193, datë 20.3.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 5518

Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 193/4, datë 15.5.2020	Për një ndryshim në urdhrin nr. 193, datë 20.3.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	5519
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 319, datë 15.5.2020	Për disa ndryshime në urdhrin nr 263, datë 17.4.2020 “Për përcaktimin e orareve të lëvizjes për këmbësorët pensionistë, të sëmurëve kronikë në trajtim mjekësor dhe të rregullave për lëvizjen e mjeteve private”, të ndryshuar.....	5519
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 320, datë 15.5.2020	Për disa kufizime në ofrimin e shërbimeve në bare, restorante dhe lokale, <i>fast-food</i> ’	5520
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 326, datë 15.5.2020	Për kufizimin e aktiviteteve sportive.....	5520
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 327, datë 18.5.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 193, datë 20.3.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	5520
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 328, datë 18.5.2020	Për disa shtesa në urdhrin nr.279, datë 25.4.2020 “Për lehtësimin e posaçëm të lëvizjes në “Zonat e Gjelbërta”, të ndryshuar.....	5521
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 333, datë 20.5.2020	Për miratimin e udhëzuesit të Institutit të Shëndetit Publik për “Masat ndaj COVID-19 që duhet të ndërmerren institucionet e kopshteve dhe çerdheve”	5521



VENDIM
Nr.402, datë 20.5.2020

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË
POLITIKAVE “PËR QEVERISJEN E
SEKTORIT TË INFORMACIONIT
GJEHAPËSINOR NË SHQIPËRI,
2020-2030”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit të politikave “Për qeverisjen e sektorit të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri, 2020-2030”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr.144, datë 22.2.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit të politikave “Për krijimin e infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Bordi për Informacionin Gjeohapësinor (BIG), autoritetet publike përgjegjëse për temat e informacionit gjeohapësinor, si dhe çdo autoritet tjetër që mbledh, përpunon, përditëson dhe përdor informacion gjeohapësinor për realizimin e funksioneve të tij publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

DOKUMENT
POLITIKAT E QEVERISJES SË SEKTORIT
TË INFORMACIONIT GJEHAPËSINOR
NË SHQIPËRI
2020-2030

PËRMBAJTJA

LISTA E AKRONIMEVE

1. KONTEKSTI I QEVERISJES SË SEKTORIT

1.1. INFORMACIONI GJEHAPËSINOR

1.2. RËNDËSIA E INFORMACIONIT GJEHAPËSINOR

1.3. SEKTORI I INFORMACIONIT GJEHAPËSINOR

1.4. SISTEMI I INFORMACIONIT GJEHAPËSINOR

2. DOKUMENTI I POLITIKAVE TË QEVERISJES SË SEKTORIT IG

2.1. ORIENTIMI I POLITIKAVE

2.1.1. FILOZOFIA E QEVERISJES

2.1.2. SYNIMET AFATGJATA

2.1.3. PARIMET UDHËHEQËSE

2.1.4. VLERAT KRYESORE

2.2. POLITIKAT MBI DISPONUESHMËRINË E INFORMACIONIT GJEHAPËSINOR

2.2.1. POLITIKA NR. 1 “PËRCAKTIMI I KËRKESËS DHE ZGJIDHJES SË DUHUR”

2.2.2. POLITIKA NR. 2 “GJENERIMI I IG TË DUHUR”

2.2.3. POLITIKA NR. 3 “AKSESIMI I LIRË & PA PENGESË I INFORMACIONIT GJEHAPËSINOR”

2.3. POLITIKAT E PËRDORIMIT TË INFORMACIONIT GJEHAPËSINOR

2.3.1. POLITIKA NR. 4 “PËRGJEGJËSIA & DETYRIMI PËR PËRDORIMIN NGA INSTITUCIONET PUBLIKE”

2.3.2. POLITIKA NR. 5 “PARTNERITET & PËRFTIM RECIPROK ME SIPËRMARRJET PRIVATE”

2.3.3. POLITIKA NR. 6 “PROMOVIMI & NDËRGJEGJËSIMI PËR PËRDORIMIN E IG NGA PUBLIKU”

2.4. POLITIKAT E SISTEMIT FUNKSIONAL TË INFORMACIONIT GJEHAPËSINOR

2.4.1. POLITIKA NR. 7 “ORGANIZIM INSTITUCIONAL FUNKSIONAL”

2.4.2. POLITIKA NR. 8 “DIJA INSTITUCIONALE DHE KAPACITETE NJERËZORE NË SEKTORIN E IG”

2.4.3. POLITIKA NR. 9 “INFRASTRUKTURË & TEKNOLOGJI FUNKSIONALE DHE E RRJETËZUAR”

2.5. DREJTIMET E POLITIKAVE PËR MIRËADMINISTRIMIN E SEKTORIT IG

2.5.1. POLITIKA NR. 10 “FINANCIM I QËNDRUESHËM I SEKTORIT”



2.5.2. POLITIKA NR. 11 “MIRËRREGULLIMI I TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE”

2.5.3. POLITIKA NR. 12 “MBI ZHVILLIMIN E SEKTORIT TË IG”

3. ZBATIMI I POLITIKAVE

3.1. PROGRAMI I MASAVE PËR JETËSIMIN E POLITIKAVE

3.1.1. PEMA/SISTEMI I POLITIKAVE

3.1.2. PRIORITETET E POLITIKAVE

3.1.3. PROGRAMI I INTEGRUAR I MASAVE

3.1.4. REALIZUESHMËRIA E MASAVE

3.2. PROCESI I ZBATIMIT TË POLITIKAVE

3.2.1. STRUKTURAT PËRGJEGJËSE

3.2.2. PËRHAPJA

3.2.3. MONITORIMI

3.2.4. NDRYSHIMI

LISTA E AKRONIMEVE

Nr.	AKRONIMI	EMËRTIMI
1	BE	Bashkimi Evropian
2	BB	Banka Botërore
3	BERZh	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
4	NSDI	National Spatial Data Infrastructure (Infrastruktura kombëtare e informacionit gjeohapësinor)
5	Projekti	Reforma rregullatore në sektorin e informacionit gjeohapësinor
6	Kartverket	Norwegian Mapping Authority
7	ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
8	IG	Informacion Gjeohapësinor
9	IPA	Instrumenti i Para-aderimit
10	KM	Këshilli i Ministrave
11	VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
12	MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
13	MBZhR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
14	MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
15	MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
16	MM	Ministria e Mbrojtjes
17	MB	Ministria e Brendshme
18	MD	Ministria e Drejtësisë
19	MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
20	DAP	Departamenti i Administratës Publike
21	AKShI	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit
22	ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit & Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale
23	ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
24	AITPP	Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike
25	INSTAT	Instituti i Statistikave
26	SBP	Strategic Business Plan
27	KRGjSH	Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare
28	AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
29	AZhT	Agjencia e Zhvillimit të Territorit
30	GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
31	GIS Kombëtar	Sistemi Kombëtar i Informacionit Gjeohapësinor
32	CORS	Continuously Operating Reference Stations
33	ALBCORS	Sistemi CORS në Shqipëri
34	GNSS	Global Navigation Satellite System
35	IGjEUM	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
36	HEC	Hidrocentral
37	KPI	Key Performance Indicators
38	Benchmark	Renditje (krahasuese) mbi performancë
39	4P's	“Product, Price, Place, Promotion”
40	DTM	Digital Terrain Model
41	ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
42	NjVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
43	SME	Small and Medium-sized Enterprises

Aktualisht
**ASHK/Agjencia
Shtetërore e
Kadastrës**, 4/2019



44	Start-up	Biznes i ri & aktivitetet fillestare për të nisur një biznes të ri
45	QA/QC	Quality Assurance / Quality Control
46	WFS/WMS	Web Feature Service / Web Map Service
47	DST	Dokumentet Standarde të Tenderit
48	IGjIU	Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake
49	PBA	Projekt Buxheti Afatmesëm
50	UN-GGIM	The United Nations Committee of Experts on “Global Geospatial Information Management”
51	IGIF	The Integrated Geospatial Information Framework (United Nations framework)

1. KONTEKSTI I QEVERISJES SË SEKTORIT


1.1 INFORMACIONI GJEOPHAPËSINOR

Pavarësisht se mund të mos e kuptojmë, të gjithë ndërveprojmë me informacionin gjeohapësinor (*p.sh. harta e një qyteti apo sistemet e navigimit nëpër automjete bazohen në këto lloj të dhënash*). Informacioni Gjeohapësinor (IG), është një ‘aset’ i rëndësishëm në jetën publike dhe private. Më parë, harta ishte e vetmja formë e dukshme e informacionit gjeohapësinor, ndërsa në ditët e sotme informacioni gjeohapësinor regjistrohet me anë të metodave kompjuterike të gjeo-shkencave, përpunohet, analizohet, dhe në fund prezantohet në multimedia (*si në internet*). Si shembuj ilustrues, mund të përmenden modelet 3D të ndërtesave dhe qyteteve, kombinimi i informacionit gjeohapësinor me informacione shitesë në sistemet e navigimit të makinave apo planifikimi i linjës së rrugëtimit nëpërmjet internetit, etj.

Sa më sipër, Informacioni Gjeohapësinor (IG) është pasqyrim i realitetit ekzistues në mënyrë virtuale, duke projektuar të gjitha pamjet e sistemit jetësor të këtij realitetin në një sistem koordinativ gjeohapësinor, me origjinë në qendrën e tokës. ‘Realiteti virtual’ nënkupton kalimin e një grupi të dhënash nga bota reale në format dixhital dhe procesimi i tyre sipas një algoritmi të caktuar, duke na dhënë si rezultat informacion mbi këtë realitet që na jep mundësitë për të kuptuar procese dhe fenomene të karakterit gjeohapësinor. Duke qenë se çdo gjë, objekt, aktivitet apo fenomen, gjendet apo ndodh diku, çdolloj informacioni për çdo

aspekt të jetës sonë, i shoqëruar me të dhënat mbi pozicionimin hapësinor, na jep projeksionin e tyre në hapësirë në formën e informacionit gjeohapësinor.


Informacionigjeohapësinor mund të kategorizohet në një tërësi ndarjesh, duke e parë realitetin ekzistues në këndvështrime të ndryshme në përputhje me objektivat, qëllimet dhe nevojën. Nëse do të bënim një zbrëthim hierarkik të kategorizimit të informacionit gjeohapësinor, do të kishim një ndarjesipas dimensioneve kryesore tërealitetit tonë jetësor, si ai *natyror, social, ekonomik dhe politik*. Më pas mund të vijohet me një ndarje të këtyre dimensioneve sipas sektorëve të caktuar, si psh.(i) sektorët e mjedisit, biordiversitetit, klimës për *dimensionin Natyror*;(ii) apo sektorët edukim, kujdes social, shëndetësi për *dimensionin Social*;(iii) apo bujqësi, turizëm, industri për *dimensionin Ekonomik*;(iv) apo shërbime publike, qeverisje, siguri për *dimensionin Politik*. Ndërsa mëpas, për çdo sektor kemi zbrëthimin në temat specifike, që japin pamjen e shtresave të caktuara të realitetit sipas një teme të caktuar, psh. tek sektori *imjedisit* mund të kemi temën e zonave të mbrojtura, të zonave ekologjike, habitateve, hidrografisë;apo tek *industria* mund të kemi infrastrukturën industriale, burimet energjetike, burimet minierare, etj.; apo tek *qeverisja* mund të kemi kufijtë enjësisve administrative, sistemin e adresave, njësitë statistikore, apo përtej temave të INSPIRE mund të kemi edhe zonat zgjedhore. Çdo temë më pas mund të ndahet dhe zbrëthet në një numër nëntemash në varësi tëtributeve, apo elementëve specifike të kërkuar.



Direktiva INSPIRE (Directive 2007/2/EC e përafruar në ligjin nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”), ka përcaktuar 34 tema bazë, duke shtruar themelet mbi bazën e së cilës mund të ngrihen edhe shumë fusha të tjera tematike që hedhin dritë dhe ndihmojnë vendimarrjen në drejtime specifike, ndërkohë që një pjesë e temave që shërbejnë si shtresa bazë dhe që janë të nevojshme për çdo temë në sektorët e tjerë, konsiderohen si informacion gjeohapësinor bazë, siç janë korniza referuese gjeodezike, sistemet e rrjeteve gjeografike, emërtimet gjeografike, imazhi i hartës bazë, modeli dixhital i terrenit, dhe ortoimazheria.

Të dhënat kombëtare gjeohapësinore dhe për rrjedhojë informacioni gjeohapësinor për nga vetë natyra ka një shtrirje gjithëpërfshirëse që nuk kufizohet nga kufijtë administrativë, kufijtë natyrorë, apo kufijtë sipërfaqësorë. Kështu informacioni gjeohapësinor shtrihet përtej kufijve të një vendi pasi fenomenet, mjedisi, tregjet, etj., nuk përfundojnë dhe nuk funksionojnë sipas kufijve. Lumenjtë nuk fillojnë dhe mbarojnë tek kufiri përkatës, apo cilësia e ajrit nuk ndryshon sipas kufijve.

Gjithashtu, të dhënat dhe për rrjedhojë Informacioni Gjeohapësinor Kombëtar nuk kufizohet vetëm në aspektin fizik të territorit (duke parë kufijtë tokësorë dhe duke analizuar dukuritë dhe fenomenet që ndodhin mbi këtë territor), por përfshin edhe të gjithë hapësirën detare që është në administrim të shtetitshqiptar si dhe nuk kufizohet në sipërfaqen e tokës apo detit, por dhe në nëntokën apo objektet dhe fenomenet që ndodhin në hapësirën mbi tokë, si linjat e fluturimit, klima, reshjet, burimet nëntokësore, etj.



1.2 RËNDËSIA E INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR

Informacioni në përgjithësi dhe informacioni gjeohapësinor në veçanti, kanë një rëndësi jetike jo vetëm për qeverisjen por për çdo aspekt të jetës sonë. Rëndësia e tij jetike është rrjedhojë e faktit të nevojës për përdorim të Informacionit gjeohapësinor, në çdo dimension dhe aspekt të jetës, nga të gjitha kategoritë dhe aktorët e shoqërisë, për të gjitha funksionet kryesore të aktivitetit tonë dhe gjatë gjithë kohës. Me specifikisht Informacioni Gjeohapësinor ka një rëndësi jetike sepse:

-Të duhet dhe vlen në çdo aspekt të jetës, dhe shtrihet në të gjitha fushat e sektorit, pasi informacioni gjeohapësinor nuk vlen vetëm për një sektor, por vlen kudo, si në aspektin politik, ekonomik, mjedisor, social.

-I duhet dhe vlen për të gjitha kategoritë dhe për të gjithë përdoruesit (*institucione shtetërore, biznese, qytetari, publiku i gjerë, organizmat e tjerë*), duke u përdorur nga institucionet shtetërore në procesin e vendimmarrjes për politikën e zhvillimit; në aspektin ekonomik ndihmon aktivitetin e bizneseve dhe sipërmarrjeve në zhvillimin sipas kërkesës së rezultuar nga informacioni; përdoret nga publiku i gjerë në jetën e përditshme për t'u orientuar dhe kuptuar çfarë ndodh rreth tyre; nga komunitetet e grupet e ndryshme të interesit që kanë nevojë për produktin IG për të plotësuar objektivat e tyre sipas temave specifike të interesit.

-Është i domosdoshëm për çdo përdorues për të mundësuar vendimmarrjen e duhur në realizimin e çdo funksioni, duke bërë të mundur njohjen e realitetit ekzistues, analizën dhe kuptimin e këtij realiteti dhe mënyrën sesi ai ndryshon dhe sillet në kohë, projeksionet e këtij realiteti në të ardhmen dhe sintezën e opsioneve dhe mundësive, duke na mundësuar vlerësimin e duhur në funksion të zgjedhjes dhe vendimmarrjes më të mirë.

-Informacioni gjeohapësinor është i domosdoshëm në çdo kohë, pasi është i nevojshëm në mënyrë të vazhdueshme dhe jo në momente të caktuara kohore, dhe vlera e tij nuk humbet me kalimin e kohës, përkundrazi merr vlerë të shtuar historike për të kuptuar ngjarjet dhe ndodhitë në të shkuarën.

1.3 SEKTORI I INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR

Sektori IG është tërësia e grupeve të ndryshme të interesit në fushën e informacionit gjeohapësinor, së bashku me filozofinë dhe politikë qeverisjes dhe akomodimit të interesave, planeve dhe programeve të zhvillimit, ligjeve, rregullave dhe normave që rregullojnë marrëdhëniet në sektor, burimet, buxhetet dhe financimi i aktiviteteve, në një fushë veprimtarie të përcaktuar si ajo e informacionit gjeohapësinor dhe që përfshin realizimin e katër funksioneve themelore të qeverisjes:

-*Orientimin e Sektorit IG* nëpërmjet synimeve, politikave dhe programit kombëtar sektorial, si dhe masave të nevojshme në zbatim të tyre;

-*Zhvillimin e Sektorit IG* përmes strategjive, programeve dhe projekteve të zhvillimit, komunikimit dhe implementimit të tyre, analizimit dhe vlerësimit të arritjes së objektivave dhe rezultateve;

-*Rregullimin e Sektorit IG*, përmes hartimit të kuadrit ligjor në lidhje me IG, rishikimin/përmirësimin e tij, ndjekjes së zbatueshmërisë nga institucionet përgjegjëse (autoritetet publike) dhe vlerësimit të impaktit;

-*Financimin e Sektorit IG*, përmes analizimit të kosto-përfitimeve ekonomike të IG, vlerësimit të nevojave për financim të sektorit, në përputhje me politikën dhe strategjitë e hartuara, identifikimit të burimeve dhe sigurimit të financimit nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera alternative (hua, grante dhe donacione), mbikëqyrjes dhe auditimit të buxheteve në dispozicion.

1.4 SISTEMI I INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR

Sistemi Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor (GIS-i Kombëtar), është tërësia e elementëve të sistemit që, ka për qëllim garantimin e informacionit gjeohapësinor dhe përdorimin e tij në funksion të vendimmarrjes nga të gjithë përdoruesit, në mënyrë të integruar, të standardizuar, efiente dhe efikase, që kanë një ndërveprim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me njëri-tjetrin, ku mungesa apo mosfunksionimi i secilit prej elementëve do të shkaktohte pasoja në funksionalitetin, aktivitetin dhe performancën e të gjithë sistemit.

Informacioni, për nga vetë natyra ka karakter ndërsektorial, sepse përbën një input të rëndësishëm për të gjithë sektorët e tjerë. Kjo vlen njësoj edhe për Informacionin Gjeohapësinor si një

prerje e informacionit në tërësi, që përfshin dimensionin *hapësinor* dhe *kohor*. Sistemi i Informacionit Gjeohapësinor formësohet nga ndërveprimi me njëri-tjetrin i nënsistemeve të mëposhtëm, ku secili prej tyre është i përbërë nga elementët përbërës të tij:


-nënSistemi Organizativ: që përfshin funksionet e nevojshme dhe arkitekturën e duhur për realizimin e aktivitetit për gjenerimin e informacionit gjeohapësinor, si dhe organizimin strukturor të institucioneve publike, rolin dhe funksionet e tyre, marrëdhëniet dhe ndërveprimin institucional, organizimine brendshëm, rrjedhën e punës, detyrat dhe përgjegjësitë për çdo strukturë e deri tek pozicionet e punës.

-nënSistemi i Burimeve Njerëzore dhe Dijes institucionale: që përfshin stafet profesionale dhe të specializuara, së bashku me ekspertizën (*Know-how*) dhe përvojën që ata zotërojnë, dijen institucionale që përfshin standardet për çdo temë të informacionit gjeohapësinor, metodologjitë dhe procedurat standard të punës, si dhe sistemin e

shpërblimit, motivimit dhe angazhimit të burimeve me aktivitetin dhe organizatën.

-nënSistemi i Infrastrukturës dhe Teknologjisë: Elementi tjetër thelbësor që formëson sistemin e IG është Infrastruktura dhe teknologjia e duhur në sektor për të mbështetur aktivitetin dhe realizimin e produkteve dhe procesve në kohën më të mirë dhe të shpejtë, si dhe për të mbështetur strukturat në realizimin e funksioneve të tyre, që përfshin të gjithë teknologjinë (*hardware dhe software*) në dispozicion të aktorëve; rrjetet dinamike të komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave në përputhje me rregullat dhe protokollat e përcaktuara; pajisjet dhe mjetet që garantojnë ndërlidhjen/ndërveprueshmërinë mes aktorëve të ndryshëm.

Ndërsa, po t'i referohemi praktikës ndërkombëtare, në përgjithësi elementët përbërës të një sistemi GIS grupohen në pesë komponentë (*hardware, software, të dhënat, njerëzit, metodat*), siç paraqiten në skemën e mëposhtme:





2. DOKUMENTI I POLITIKAVE TË QEVERISJES SË SEKTORITIG

Politika është një drejtim veprimi për të ardhmen, duke treguar se cili është kursi nga do të shkojmë. Politika duhet të sigurojë udhëheqjen për një periudhë të caktuar kohe, duke pasur si qëllim të orientojë dhe përcaktojë vendimmarrjet aktuale dhe të së ardhmes, si dhe të përvijojë masat që lidhen me to. Dokumenti i politikave është një dokument për sektorin e informacionit gjeohapësinor, i shoqëruar me një program masash për jetësimin e tij, duke pasur si cilësi kryesore:

-Është një *Dokument për të Ardhmen* pasi orienton sektorin drejt gjendjes së dëshiruar (*ndaj nuk është thjesht një plan pune për zgjidhjen e problematikave të sotme*). Dokumenti i Politikave për informacionin gjeohapësinor është projektuar për të përcaktuar drejtimit e politikës së qeverisjes për 10 vitet e ardhshme me pikë fundore vitin 2030.

-*Aktualizon Sfidat*, pasi vlerëson sfidat e së ardhmes duke u bazuar në kontekstin aktual, kohor, gjeografik, social, ekonomik dhe politik. Sfidat e së ardhmes në sektorin e informacionit gjeohapësinor trajtohen duke patur parasysh realitetin ekzistues në Shqipëri në të gjithë elementët e tij, në mënyrë që drejtimit e së ardhmes të jenë me “*këmbë në tokë*” në të sotmen, duke bërë të mundur transformimin e këtij realiteti ekzistues në drejtimit që duam për të ardhmen.

-Është një Marrëveshje e Negociuar ndërmjet qeverisë dhe aktorëve, për çështjet dhe interesat e tyre, duke i ekuilibruar sipas peshës që kanë (pra nuk është një dokument që hartohet në mënyrë të njëanshme nga përfaqësues të administratës publike apo ekspertët). Politikat nuk janë studime, analiza, apo plane pune, por projektim në të ardhmen i interesave të grupeve të ndryshme të aktorëve në sektor, duke pasqyruar dhe marrë në konsideratë të gjitha këto interesa, sipas peshës dhe impaktit që ato përfaqësojnë dhe duke formuluar një drejtim të qeverisjes që plotëson në mënyrë optimale të gjitha këto interesa.

-Është një *Vendimmarrje Politike* që balancon interesin e gjerë publik përkundërt interesave të aktorëve, duke identifikuar masat e duhura në zbatim të politikave. Interesat e grupeve të ndryshme duhet të vendosen përkundërt interesit të gjerë publik, i cili përfaqësohet nga mazhoranca qeverisëse, që është mandatuara nga shumica e qytetarëve pikërisht për të përfaqësuar dhe

mbrojtur këtë interes publik. Prandaj dokumenti i politikave duhet të shqyrtohet dhe konkludohet me vendimmarrje politike, që garanton balancimin e interesave të grupeve të ndryshme të aktorëve përkundërt interesit të gjerë publik.

2.1 ORIENTIMI I POLITIKAVE

2.1 Filozofia e Qeverisjes

Politikat e qeverisjes së sektorit të informacionit gjeohapësinor përputhen me parashikimet e programeve qeverisëse dhe janë të harmonizuara me dokumentet sektoriale, duke respektuar angazhimet ndërkombëtare dhe përafrimin me BE. Në këtë drejtim është konsideruar edhe korniza strategjike gjithëpërfshirëse - IGIF (Integrated Geospatial Information Framework) e zhvilluar nga UN¹ dhe BB, me qëllim që nëpërmjet e-ekonomisë, e-shërbimeve dhe e-tregtisë, të mundësohet përmirësimi i shërbimeve ndaj qytetarëve, ngritja e kapaciteteve për përdorimin e teknologjisë gjeohapësinore, përmirësimi i proceseve vendimmarrës të qeverisë nëpërmjet mirëinformimit, lehtësimi i zhvillimit të sektorit privat, ndërmarrja e veprimeve praktike për të arritur një transformim dixhital gjeohapësinor në zbatimin e prioritetëve strategjike kombëtare si dhe Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Mbështetur në këtë kuadër të gjerë mbi politikat qeverisëse, përvijohet edhe filozofia e politikave të sektorit.

-Qëllimi, si thelbi i filozofisë qeverisëse, është plotësimi i kërkesës që buron nga diferenca midis nevojës aktuale dhe dëshirës për të ardhmen, ndaj qëllimi fundor i qeverisjes është mirëqenia e qytetarëve të saj. Një qeverisje e mirë, ka në themel vendimmarrjen për trajtimin e çështjeve ekzistuese dhe planifikimin e së ardhmes. Vendimmarrja nuk mund të konceptohet pa informacion dhe vendimmarrja me bazë hapësinore nuk mund të konceptohet pa informacionin gjeohapësinor, ndaj qëllimi fundor i qeverisjes së sektorit të informacionit gjeohapësinor është: “*Orientimi i vendimmarrjes së duhur të qeverisjes, në funksion të mirëqenies së qytetarëve, për një të ardhme më të mirë të vendit.*”

-Vizioni është ai element i filozofisë qeverisëse, që na përshkruan rezultatin që dëshirojmë dhe shohim për të ardhmen e informacionit

¹United Nations Committee of Experts on Global Geospatial Information Management (UN-GGIM)

gjeohapësinor. Vizioni që imagjinojmë është: *“Informacion gjeohapësinor i plotë në të gjitha drejtimet, sektorët dhe temat për pasqyrimin e plotë dhe të saktë të realitetit ekzistues, në kohë reale dhe të përditësuar në mënyrë të vazhdueshme, duke na dhënë një pamje virtuale të realitetit dinamik dhe fenomeneve të sotme, ndryshimit dhe sjelljes së tyre në të shkuarën dhe projeksioneve të mundshme për të ardhmen.”*

-Misioni i qeverisjes përbën thelbin e punës dhe sintezën e aktiviteteve që duhet të kryhen në mënyrë që të shkojmë më pranë drejt vizionit që aspirojmë, duke i dhënë përgjigje pyetjes se *“Çfarë duhet të bëjmë?”*, për të arritur vizionin dhe realizuar qëllimin, ndaj misioni i qeverisjes për sektorin e informacionit gjeohapësinor është: *“Krijimi i një sistemi të integruar, i cili mundëson gjenerimin e informacionit të saktë, të plotë dhe në kohë reale për të bërë pasqyrim të realitetit ekzistues, për të analizuar informacionin historik të këtij realiteti në kuptimin e sjelljeve dhe ligjësive, për të lejuar bërjen e projeksioneve për të ardhmen kundrejt përmbushjes së qëllimit final që lidhet me mirëqënien e qytetarëve.”*

-Besimipërbëhet nga supozimet bazë të qeverisjes, mbi të cilat mbështetemi për të kryer misionin, realizuar vizionin dhe arritur qëllimin në sektorin e informacionit gjeohapësinor: *“Ne besojmë se qeverisja ka ndjeshmërinë dhe predispozicionin për të kuptuar rëndësinë e informacionit gjeohapësinor dhe ka angazhimin e duhur për të mbështetur zhvillimin e sektorit të informacionit gjeohapësinor. Besojmë se Shqipëria mund të jetë avangard në rajon në fushën e informacionit gjeohapësinor, bazuar në modelin dhe shpejtësinë e suksesit të arritur nga ASIG në pesë vitet e fundit, ku nga një institucion që nuk ekzistonte, sot është referencë dhe lider në rajon.”*



2.1.2 Synimet Afatgjata

Mbështetur në kornizën strategjike gjithëpërfshirëse IGIF të UN-GGIM dhe BB, përcaktohen 8 synime për t'u arritur në mënyrë progresive si dhe 9 drejtime strategjike për të ardhmen e projektuar dhe marrjen e benefiteve optimale nëpërmjet sistemeve të integruara të informacionit gjeohapësinor. Por të përdhura në realitetin e vendit tonë, synimet kryesore afatgjata për t'u realizuar deri në vitin 2030 nga politikat e qeverisjes për sektorin e informacionit gjeohapësinor në Shqipëri, janë si vijon:

-Synimi Strategjik I “Disponueshmëria e Informacionit Gjeohapësinor”: Garantimi i disponueshmërisë së informacionit gjeohapësinor, që plotëson nevojën e të gjithë përdoruesve të tij, në të gjitha dimensionet (natyror, ekonomik, social dhe politik) të realitetit, nëpërmjet pasqyrimin virtual të këtij realiteti, në të gjitha shtresat dhe elementët e tij, në mënyrë të plotë, të saktë, të vazhdueshme dhe në çdo moment kohor (në të shkuarën, tashmen dhe të ardhmen). Për të realizuar synimin e garantimit të IG që duam, duhet të kemi proceset dhe rezultatit në fund të tyre për ‘formulimin e kërkesës së duhur’ që plotëson nevojën e përdoruesve për informacion gjeohapësinor; grumbullimin e të dhënave dhe gjenerimin e informacionit gjeohapësinor të plotë për të gjitha fushat dhe temat; si dhe aksesimin e këtij informacioni në mënyrë të hapur, të integruar, të shpejtë dhe të thjeshtë, nga të gjithë përdoruesit e tij.

-Synimi Strategjik II “Përdorimi i Informacionit Gjeohapësinor”: Përdorimi i plotë dhe i vazhdueshëm i Informacionit Gjeohapësinor nga institucionet shtetërore (autoritetet publike), sipërmarrja private, organizatat komunitare dhe publiku i gjerë, për të njohur realitetin ekzistues në të gjithë elementët e tij, për të kuptuar ndryshimin, sjelljen dhe ligjësinë e ndryshimit gjatë kohës dhe për të projektuar të ardhmen në funksion të vendimmarrjes së duhur për një qeverisje dhe të ardhme më të mirë. Për të realizuar këtë synim, është i nevojshëm ndërjegjësimi, edukimi dhe angazhimi i përdoruesve të informacionit gjeohapësinor, duke shpjeguar rëndësinë dhe nevojën jetike që ky informacion ka për çdo aspekt të aktivitetit dhe jetës sonë, si dhe duke shpjeguar përfitimet e përdorimit si dhe dëmin e shkaktuar në

mungesë të tij, duke optimizuar kostot dhe përfitimet në raport me kohën, si dhe duke garantuar cilësinë dhe funksionalitetin e informacionit gjeohapësinor.

-Synimi Strategjik III “Funksionaliteti i Sistemit të Informacionit Gjeohapësinor Shtetëror”: Ngritja dhe vënia në funksionim e një sistemi shtetëror të informacionit gjeohapësinor, të integruar dhe funksional në të gjithë elementët e tij, që garanton realizimin e të gjithë funksioneve të qeverisjes, në mënyrë eficiente dhe efektive. Duke qenë se IG është një input në çdo aktivitet dhe çdo aspekt të qeverisjes, sektori i IG është një sektor horizontal që pritet me të gjithë sektorët e tjerë të qeverisjes, duke bërë që sistemi shtetëror i informacionit gjeohapësinor të përbëhet nga elementët e IG në çdo sektor tjetër të lidhur në logjikë të integruar dhe horizontale. Për të bërë të mundur integrimin dhe një performancë të lartë të sistemit, duhet të kemi: *projektimin e kuadrit institucional* dhe organizimin funksional të institucioneve shtetërore qeverisës që operojnë në sektorin e IG; *përvaktimin e standardeve*, rregullave uniforme, praktikave të unifikuara, manualeve dhe udhëzuesve në lidhje me IG; integrimin dhe *optimizimin e kapaciteteve dhe dijës njerëzore* për Informacionin Gjeohapësinor nëpërmjet ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve institucionale dhe profesionale të burimeve njerëzore, si dhe nxitjen e mbështetjen e kërkimeve, studimeve dhe publikimeve me karakter shkencor dhe informues; dhe integrimin dhe ndërveprimin e infrastrukturës shtetërore të informacionit gjeohapësinor.

-Synimi Strategjik IV “Mirë Administrimi i Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor”: Garantimi i një sektori të informacionit gjeohapësinor, dinamik, në rritje dhe zhvillim të vazhdueshëm, me të drejta dhe detyrime të përcaktuara në mënyrë e duhur, i qëndrueshëm nga ana financiare, ku interesat e aktorëve të ndryshëm janë të harmonizuar dhe maksimalizuar përkundrejt interesit të gjerë publik. Për të realizuar këtë synim, nevojitet një orientim i sektorit drejt politikave dhe synimeve të qeverisjes, planifikimi i duhur i zhvillimit, rregullimi i marrëdhënieve dhe buxheteve përkatës, zbatimi i këtyre planeve në mënyrë të shpejtë dhe eficiente, si dhe monitorimi dhe kontrolli i sektorit IG për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm, marrëdhënie të rregulluara në

mënyrën më të mirë dhe garantuar financimin e nevojshëm për një sektor të qëndrueshëm.



2.1.3 Parimet Udhëheqëse

Parimet bazë që na drejtojnë dhe udhëheqin gjatë rrugëtimit për të realizuar synimet afatgjata janë qëndrueshmëria, ekuilibri, optimizimi i vlerave dhe të qënurit ‘openness’ mbi informacionine hapur. Në mënyrë të detajuar, parimet themelore në përvijimin e politikave për qeverisjen e sektorit të informacionit gjeohapësinor, zbërthehen si vijon:

-Parimi i ekuilibrit mes aktorëve, funksioneve, teknologjisë, kapaciteteve sipas peshës që kanë për të arritur vendimmarrjen e duhur, si qëllim final të sektorit.

-Parimi i qëndrueshmërisë duke nxitur qëndrueshmërinë në zhvillim, qëndrueshmërinë e marrëdhënieve mes institucioneve dhe autoriteteve përgjegjëse bazuar në përfitimin reciprok, qëndrueshmërinë financiare duke balancuar kostot me përfitimet, me qëllim që marrëdhëniet e rregulluara mirë të prodhojnë rezultatin e duhur dhe zhvillimin e synuar.

-Parimi i optimizimit të vlerës, në kohën dhe cilësinë e duhur, sipas prioriteteve për t’u optimizuar në efikasitet dhe efikasitet.

- i hapjes për të pasur të dhëna dhe informacion të hapur dhe të aksesueshëm, në çdo kohë, për të gjithë përdoruesit, duke konsideruar të drejtat e privatësisë, të autorit, dhe pa cënuar sigurinë kombëtare.

2.1.4 Vlerat Kryesore

Qeverisja e sektorit të informacionit gjeohapësinor do të mbështetet në disa vlera bazë

që lidhen me aktualitetin e informacionit gjeohapësinor në Shqipëri, vlera këto të cilat lehtësojnë rrugën për të shkuar drejt përmbushjes së vizionit, duke ofruar një bazë të vlefshme dhe të qëndrueshme, si më poshtë:

- *Pasja e të dhënave historike të shumta* - Historia dhe rrjedha e popullit shqiptar shoqërohet me të dhëna të shumta arkivore (edhe pse jo në format dixhital), të cilat flasin dhe i japin jetë një realiteti të shkuar. Të dhënat janë të larmishme dhe datojnë që nga periudha osmane, ka informacion të trashëguar nga sistemi komunist për shkak edhe të procedurave rigoroze të mbledhjes dhe regjistrimit të të dhënave në mënyrë manuale gjatë asaj periudhe, dhe deri tek rrugëtimi drejt tranzicionit që është shoqëruar me të dhëna të ndryshme, ku tashmë gjendemi në përpjekjen për automatizimin dhe regjistrimin në mënyrë dixhitale të tyre. Pavarësisht se pjesa më e madhe e këtyre të dhënave janë të vjetëruara dhe manuale, ato përbëjnë një vlerë në kuadër të kuptimit të realitetit historik dhe në çdo moment mund t'i dixhitalizosh dhe përpunosh për të siguruar informacion dhe analiza me vlerë të madhe.

- *Qasja e lartë ndaj teknologjisë & rinia* - Shteti shqiptar, për shkak edhe të një popullsie tepër të re në moshë, renditet në listën e vendeve me përdorim të lartë të internetit dhe trendeve teknologjike. Përdorimi masiv i internetit, koha e gjatë në rrjetet sociale, azhurnimi me ndryshimet dhe risitë në teknologji, përbëjnë përditshmërinë e një të riu shqiptar. Qasja miqësore ndaj teknologjisë është vlerë/potencial dhe ofron siguri në ndryshimet pozitive të së ardhmes, duke dhënë mundësi për aplikimin e çdo lloj teknologjie optimale në përdorim dhe që ekuilibron përmbushjen e interesave të aktorëve të ndryshëm.


- *ASIG si institucion* - Ngritja e ASIG, si institucioni qëndror i informacionit gjeohapësinor, përbën një vlerë të shtuar dhe një bazë mbi të cilën ngrihen politikat e qeverisjes së sektorit. Pavarësisht viteve të pakta të operimit, ASIG është simbol i një institucioni të ngritur nga zero, për t'u shndërruar në një strukturë shumë funksionale në terma të kapaciteteve të duhura, motivimit dhe kualifikimit, trendeve teknologjike, standardizimit të funksioneve, etj. Modele të tilla suksesi krijojnë vlerë për të vazhduar ndërtimin e një sektori të integruar dhe funksional të informacionit gjeohapësinor.

- *Dështimet dhe eksperiencat e së kaluarës* – duhen analizuar dhe konsideruar me qëllim për të pasur të qartë çfarë nuk ka funksionuar siç duhet në të kaluarën, problematikat dhe dështimet e lidhura me to, me qëllim për t'i shfrytëzuar si mësim të së shkuarës (*lessons learned*) dhe për të mos i përsëritur në të ardhmen. Mund të përmenden shembuj të ndryshëm nga këto eksperiencat, si ato që lidhen me mospërputhshmërinë e infrastrukturave dhe teknologjive për të cilat është investuar shumë ndër vite, apo të metodologjive të ndryshme të të punuarit dhe mungesës së ndërveprueshmërisë së sistemeve përkatës institucionale, apo problematika e izolimit të të dhënave dhe informacionit gjeohapësinor brenda institucionit përkatës, etj.

2.2 POLITIKAT MBI DISPONUESHMËRINË E INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR

Realizimi i Synimit “Për garantimin e disponueshmërisë së informacionit gjeohapësinor” mundësohet nga realizimi siç duhet i proceseve në fazat kryesore që janë: përcaktimi i kërkesës së duhur, gjenerimi i informacionit gjeohapësinor të duhur, si dhe mundësimi i aksesimit dhe lëvrimit i informacionit gjeohapësinor në mënyrën dhe kohën e duhur.

Drejtimet e politikave që lidhen me synimin e parë strategjik për disponueshmërinë e IG, janë në përputhje edhe me kornizën strategjike gjithëpërfshirëse (IGIF) të UN-GGIM, konkretisht me: Drejtimin Strategjik 4 “Të Dhënat”, Drejtimin Strategjik 5 “Inovacion” dhe Drejtimin Strategjik 9 “Komunikim dhe angazhim”.





Sa më sipër, tre drejtimet kryesore ku do të orientohet politika për garantimin e disponueshmërisë së informacionit gjeohapësinor që duam, janë:

-Politikat për përcaktimin e nevojës dhe formulimit të kërkesës së duhur për IG *“Doing the right thing”*, përfshirë, identifikimin e aktorëve, mbledhjen e kërkesave, kuptimin e nevojës, përcaktimin dhe formulimin e kërkesës së duhur.

-Politika për gjenerimin e informacionit gjeohapësinor në përputhje me direktivën INSPIRE, ofrimi i IG, përfshirë bazën e të dhënave gjeohapësinoe, procesimin e tyre dhe integrimin, me të gjitha shtresat (*multilayer*) të IG duke na dhënë realitetin virtual në territor.

-Politika për aksesimin e IG, në mënyrë të menjëhershme, me të gjitha funksionet, në të gjitha pikat, dhe i thjeshtë për t'u marrë dhe përdorur, pa barriera, monetare, lokale, etj.

2.2.1 Politika nr. 1 “Përcaktimi i kërkesës dhe zgjidhjes së duhur”

Përcaktimi i kërkesës së duhur është një nga politikat për disponueshmërinë e informacionit gjeohapësinor, e cila përbën zanafillën e procesit të ofrimit të informacionit të plotë dhe të përdorshëm. Për këtë arsye kjo fazë duhet të përmbushet saktë në mënyrë që vazhdimi të jetë sa më eficient. Duke pasur kërkesë të bazuar në realitetin dhe nevojën aktuale, do të mund të kemi një sektor të orientuar drejt realizimit të synimeve dhe objektivave për informacion gjeohapësinor të integruar dhe funksional, me kërkesë të mbledhur nga aktorët, tregu dhe përdoruesit.

Referuar problematikave në këtë aspekt, ka rezultuar se informacioni gjeohapësinor prodhohet bazuar në kërkesën dhe nevojën e momentit, duke e marrë të mirëqenë se çfarë na duhet dhe pa bërë vlerësimin e kërkesës. Shumë institucione shprehin se kanë nevoja kundrejt informacionit gjeohapësinor, por shpeshherë janë të paqarta në arsyet e përdorimit të tij, ose përcaktojnë një nevojë bazuar në situatën aktuale ose në ato që kanë ndodhur në të kaluarën, ndërkohë që është shumë e vështirë që të përcaktohet se si ky informacion mund të plotësojë nevojat e reja që mund të shfaqë e ardhmja. Gjithashtu, këto kërkesa përqëndrohen kryesisht vetëm në nevojat e brendshme të institucionit përkatës dhe pa ndërvepruar me elementë të tjerë, për t'u bërë pjesë e qëllimeve më të mëdha.

Pavarësisht se sipas nenit 20 të ligjit 72/2012 ASIG-u duhet të sigurojë bashkërendimin ndërinstitucional si dhe veprimet apo nismat e autoriteteve publike në fushën e informacionit gjeohapësinor, rezulton se institucionet nuk e zbatojnë këtë detyrim ligjor (për më tepër që ky ligj nuk përcakton penalitete në rast të moszbatimit të tyre, duke bërë që ASIG ta ketë të pamundur marrjen e masave në këtë drejtim, përveç mënyrës së sensibilizimit të institucioneve). Praktikisht, filozofia dominuese pothuajse në çdo autoritet publik është “ta kryejë të gjithë detyrën vetë” bazuar në rregulla të përcaktuara aty për aty, pa marrë aspak në konsideratë sesi kjo kërkesë lidhet ose integrohet me institucione të tjera brenda sektorit. Gjithashtu shpeshherë problem mbetet edhe fakti që kërkesa është e paformalizuar, duke sjellë një nevojë kundrejt standardizimit të saj nga një institucion qendror, në të njëjtën linjë sikurse është kryer standardizimi i të dhënave.

Aktualisht situata është e tillë që secili institucion e përcakton vetë kërkesën, formëson një projekt që e dërgon më pas në ASIG, i cili ‘kontrollon’ në qoftë se plotësohet ose jo standardi. Ky proces realizohet në kah të kundërt, kjo pasi kontrollohet sesa i përmbush standardet një projekt, por nuk analizohet nëse kjo kërkesë plotëson nevojat e momentit apo shtrihet më gjerë. Çdo proces duhet të lindë nga kërkesa në mënyrë që produkti final të jetë i duhuri, ndërkohë që në të shumtën e rasteve kontrollohet projekti dhe jo fakti nëse nevoja ka qenë reale ose jo, pasi institucionet e justifikojnë si ndërhyrje nëobjektin e punës së institucionit propozues dhe në legjislacionin e tyre të brendshëm.

Nga sa më sipër, si çështje problematike evidentohet kryerja e kërkesave për IG bazuar në të tashmen dhe të shkuarën, pa marrë në konsideratë nevojat reale apo ato që mund të lindin në të ardhmen si kërkesë kundrejt informacionit gjeohapësinor, duke pasur kështu paqartësi për mënyrën e implikimit të tij në zgjidhjet e mundshme, duke pasur mungesë koordinimi ndërmjet nismave me institucione që refuzojnë të bashkëpunojnë, dhe duke rezultuar në një kërkesë të paformalizuar/standardizuar për IG.



Deklarata e Politikës Nr.1 “Përcaktimi i kërkesës dhe zgjidhjes së duhur”:

“Ngritja e një sistemi efikas për të mundësuar planifikimin, ekzekutimin dhe kontrollin e integruar të proceseve si identifikimi, formulimi dhe përcaktimi, i kërkesës dhe zgjidhjes së duhur për Informacion Gjeohapësinor, nga përdorues të ndryshëm, në përputhje me standardet e direktivës INSPIRE, praktikave më të mira ndërkombëtare dhe ato lokale.”

Për të mundësuar ecjen në kahun e duhur dhe përcaktimin e kërkesës së duhur, është e nevojshme që kërkesat të bëhen bazuar në realitetin dhe nevojën aktuale, duke marrë në konsideratë problemet sot dhe mundësinë e zhvillimit për të ardhmen. Kërkesat duhet të jenë të tilla që ndërveprojnë me të tërën dhe institucionet, si dhe që janë të orientuara në realizimin e synimeve dhe objektivave të sektorit. Në përmbushje të kësaj politike mund të ndiqet parimi i “qendërimit” ku ASIG si institucioni qendror mund të realizojë fillimisht mbledhjen e nevojave kundrejt IG për të gjitha institucionet e interesuara, analizimin e tyre dhe formulimin e kërkesave të integruara ndërmjet të gjithë përdoruesve, duke nxjerrë në pah edhe nevoja të tjera të së ardhmes.

Një shembull pozitiv sesi mund të realizohet analizimi i kërkesave dhe koordinimi ndërmjet nismave, është rasti i ortofotos. Shumë aktorë shprehën nevojën për ortofoto, por e shikonin procesin si përmbushje të nevojave vetëm për të sotmen dhe për interesin e tyre, duke qenë të paorientuar me qëllimin e qeverisjes. Në këtë kuadër ASIG integroi këto kërkesa, duke bërë analizë, në bashkëpunim me profesionistë të fushës, për të përcaktuar cila ishte nevoja që duhej zgjidhur, për të dhënë më pas opsionet dhe formësimin e detyrës së projektimit. Shembuj të tillë nxjerrin edhe njëherë në pah nevojën për të identifikuar nevojat reale, për të formësuar kërkesën dhe për të mundësuar menaxhimin e integruar të tyre.

Masat për jetësimin e politikës nr. 1:

1.1 Identifikimi i Përdoruesve: Duke ngritur dhe përditësuar një bazë të dhënash për të gjithë përdoruesit, me atributet e nevojshme për të mundësuar përcaktimin e profilit për secilin prej tyre, si dhe duke vlerësuar peshën dhe rëndësinë që ata kanë në sektorin e informacionit gjeohapësinor.

Kjo masë do të sjellë përfitim të lartë, pasi tashmë të gjithë përdoruesit do jenë lehtësisht të përcaktueshëm dhe në të njëjtin vend, duke ditur ekzaktesisht se kujt duhet t'i drejtohem dhe si duhet të realizojmë komunikimin me secilin prej tyre, duke qenë lehtësisht të realizueshme.

1.2 Mbledhja e kërkesave për IG: Identifikimi dhe regjistrimi i kërkesave të ndryshme për IG nga të gjithë përdoruesit dhe në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet një sërë formash dhe metodologjish si, ngritja e një portali që funksionon në kohë reale për të grumbulluar kërkesa që aktorët e ndryshëm kanë për IG, kryerjes së pyetësorëve në mënyrë periodike dhe të standardizuar apo nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta me përdoruesit e interesuar. *Përfitimi që do sjellë kjo masë është shumë i lartë, pasi tashmë secili prej përdoruesve shpreh nevojat e veta kundrejt informacionit gjeohapësinor, duke reflektuar dhe ndërgjegjësuar për përdorimin dhe vlerën e shtuar të tij. Krijimi i portalit është shumë i mundshëm dhe promovimi i tij nxit përdoruesit që në çfarëdolloj momenti të paraqesin nevojat e tyre kundrejt IG. Ky proces duhet të ndërthuret edhe me procesin e hartimit të projekt buxhetit afatmesëm (PBA), në mënyrë që të jetë më efektiv.*

1.3 Formulimi i zgjidhjeve të integruara: Formulimi i zgjidhjeve të integruara dhe menaxhimi i tyre nga një institucion qendror, bazuar në nevojat e shprehura nga përdoruesit, duke u nisur nga praktikrat dhe modelet më të mira. *Kjo masë do të sjellë përfitim shumë të lartë pasi tashmë zgjidhja do formulohet jo vetëm duke u bazuar tek këndvështrimi i së tashmes dhe së shkuarës, por edhe duke analizuar se sa janë realisht nevojat në përputhje me kushtet e realitetit ekzistues dhe njëkohësisht duke përcaktuar nevojat e mundshme për të ardhmen, në sinkron me të gjitha strukturat e tjera që ndikohen nga kjo kërkesë.*

1.4 Angazhimi i Aktorëve për Implementim: Koordinimi i nismave duke përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e secilit prej aktorëve kundrejt përmbushjes së kërkesave dhe realizimit të zgjidhjes së integruar. *Përfitimi që vjen nga kjo masë është i lartë, pasi secili prej aktorëve e ka të qartë rolin dhe detyrën e tij kundrejt përmbushjes së kërkesave specifike. Vendorsja e sanksioneve ligjore dhe fuqizimi i rolit monitorues dhe kontrollues të ASIG, do mundësojnë realizueshmërinë e saj.*

2.2.2 Politika Nr. 2 “Gjenerimi i IG të duhur”

Gjenerimi i informacionit gjeohapësinor është një ndër drejtimet kryesore të politikave për disponueshmërinë e informacionit gjeohapësinor, e cila mundëson kapjen, ruajtjen, mbrojtjen dhe



përditësimin e të dhënave gjeohapësinore, integrimin e tyre në një bazë kombëtare të të dhënave gjeohapësinore, procesimin dhe harmonizimin e këtyre të dhënave për prodhimin e informacionit gjeohapësinor sipas temave specifike dhe kombinimi i tyre për të na dhënë hartat tematike dhe multifunkionale në përputhje me direktivën INSPIRE.

Referuar problematikave të vërejtura në aspektin e gjenerimit të informacionit gjeohapësinor, mungesa e të dhënave të plota për të gjitha temat është një çështje e rëndësishme, sepse pengon në zhvillimin e mëtejshëm të procesit të ofrimit të shërbimeve të duhura mbi disponueshmërinë e IG. Problematikat mbi të dhënat e paplota, vijnë si rezultat i mënyrës së gabuar të grumbullimit të të dhënave dhe mosndjekjes së standardit, duke u bërë kështu të paaksesueshme. Kjo sjell që përdorimi i tyre të mos jetë efektiv dhe të iniciohen procese të tjera të grumbullimit dhe gjenerimit të të dhënave, të dublikuara në karakterin e informacionit dhe duke shkaktuar kaos në organizimin e përgjegjësive të institucioneve përgjegjëse lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave.

Një problem tjetër që lidhet me proceset e gjenerimit të informacionit gjeohapësinor është pasja e databazave jo të sinkronizuara, shkak që institucionet të mos bashkëveprojnë me njëri-tjetrin në mënyrën e dëshiruar. Në këtë aspekt, vërehet se të dhënat janë të shpërndara në databaza të ndryshme dhe të paintegruara, duke penguar procesimin/harmonizimin në kohë reale dhe në mënyrën e duhur për të na mundur një pamje shumëdimensionale.

Nevoja për të pasur të dhëna të plota, të sakta dhe përmirësimin e vazhdueshëm në kohë të bazës së të dhënave, dikton problemin e pasjes së informacioneve që nuk përditësohen. Kjo shkakton problem në disponueshmërinë e të dhënave në momentin, cilësinë dhe situatën që duhet për efekt të orientimit të duhur të vendimmarrjes.

Së fundmi janë miratuar nga Këshilli i Ministrave në datë 29.05.2019 disa ndryshime në vendimin për KRGJSH (Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare), duke përcaktuar ndër të tjera se Stacionet e rrjetit aktiv të pozicionimit global ALBPOS, që posedohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, kalojnë në administrim të

ASIG-ut dhe integrohen në rrjetin aktiv të stacioneve CORS.

Në mënyrë të përmbledhur, çështjet kryesore të identifikuara lidhur me politikën e gjenerimit të informacionit gjeohapësinor, janë:

-Mungesa e të dhënave të standardizuara dhe të përshtatura me ndryshimet e kohës, të cilat edhe nuk mirëmbahen, duke degraduar dhe duke u bërë të papërdorshme.

-Mungesa e një databaze qendrore kombëtare për informacionin gjeohapësinor, e cila të integrojë databazat tematike që janë të shpërndara dhe shkaktojnë vështirësi në sigurimin, analizimin dhe përpunimin e informacionit.

-Përpunimi manual i të dhënave, për shkak të mospasjes ose mosfunksionimit të teknologjive të duhura, të mbajtura në kushte të papërshtatshme, për procesin e dixhitalizimit.

-Problematikë në gjenerimin e informacionit gjeohapësinor jo sipas sistemit të KRGJSH, duke krijuar problematikë në integrimin e të dhënave dhe të informacionit gjeohapësinor nga burime të ndryshme. Shembull tipik është ZRPP me ALUIZNI-n (tashmë të bashkuara si ASHK), ku e para ende sot nuk i regjistron pronat në sistemin e KRGJSH. Duhet koordinuar dhe trajtuar kjo çështje me krijimin tashmë të ASHK (Agjencia Shtetërore e Kadastrës) dhe sesi do të integrohen sistemet apo metodologjitë përkatëse të punës.

-Gjenerimi jo në kohën dhe cilësinë e duhur i Informacionit Gjeohapësinor për shkak të moszbatimit të standardeve të caktuara, si dhe përditësim jo periodik i të dhënave.

Deklarata e Politikës nr.2 “Gjenerimi i IG të duhur”:

“Garantimi i një sistemi të integruar i të dhënave gjeohapësinore, në përputhje me sistemin shtetëror referues gjeodezik, që mbliidhen vetëm njëherë, përditësohen vazhdimisht, të aksesueshme për të gjithë aktorët, që procesohen dhe harmonizohen në mënyrë të plotë e të shpejtë, për të mundur informacionin gjeohapësinor që duam, i cili pasqyron një pamje besnike, në kohë reale dhe shumëdimensionale të realitetit.”

Politika e gjenerimit të informacionit gjeohapësinor mundëson pasjen e informacionit të procesuar në mënyrë të harmonizuar, të prodhuar në cilësinë, kohën dhe standardin e duhur. Për të realizuar këtë duhet të ngrihet një sistem i integruar



në elementët e tij, në të dhëna, në burime, në mënyrën si procesojnë, sipas drejtimeve dhe parimeve që orienton direktiva INSPIRE për të na mundësuar një pamje shumëdimensionale të realitetit fizik, ekonomik, natyror, social dhe politik në të gjithë shtresat dhe elementët e tij.

Kjo politikë bën të mundur që të dhënat të mbliidhen vetëm njëherë duke penguar rrezikun e dublikimit të tyre dhe pasjen e të dhënave të ndryshme për të njëjtën çështje, me qëllim që projektimi i së ardhmes të jetë i bazuar në të dhëna të sakta dhe reale, të mbledhura nga një aktor dhe të përditësuara në mënyrë periodike. Gjenerimi dhe përditësimi i informacionit periodikisht ndihmon në ruajtjen e vlerës historike të të dhënave, si dhe krijon mundësi aksesimi për të gjithë aktorët në kohën e duhur.

Kjo politikë orienton kombinimin, procesimin dhe transformimin e të dhënave apo grup të dhënave gjeohapësinore të ndryshme, duke përdorur *software* të përshtatshëm për procesimin e një volumi të madh të dhënash për çështje, tema, apo fusha të ndryshme; integrimin e informacionit gjeohapësinor dhe pamjet *multilayer*, duke ngritur dhe vënë në funksionim gjeoportalet sektoriale pranë një sërë institucioneve qendrore, si dhe fuqizimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të gjeoportalit kombëtar pranë ASIG.

Si pjesë e zbatueshmërisë së kësaj politike, konsiderohet edhe përdorimi i Hartës Bazë vektor², që po mundësohet nëpërmjet projektit me JICA (duke qenë kështu pjesë e politikave për përdorimin e IG), e

cila duhet të mbështetet edhe nëpërmjet ndryshimeve ligjore në këtë drejtim (si pjesë e politikave për mirëadministrimin dhe rregullimin e dubur të sektorit).

Masat për jetësimin e politikës nr. 2:

2.1 KRGJSH: Përfundimi i ngritjes, vënies në funksionim dhe mirëmbajtjes së KRGJSH me të gjitha sistemet/rjetet e saj (si rrjeti shtetëror GPS, rrjetin shtetëror të nivelimit, rrjetin shtetëror gravimetrik, rrjetin e stacioneve mareografike, rrjetin e stacioneve magnetometrike), që na mundëson gjeoreferim të saktë dhe të integrueshëm me çdo vend tjetër, të çdo të dhëne dhe informacionit gjeohapësinor.

2.2 Dixhitalizimi i Arkivave: Një masë e rëndësishme që bën të mundur realizimin e politikës për pasjen e një informacioni gjeohapësinor të plotë, është dhe dixhitalizimi në mënyrë të vazhdueshme i arkivave me të dhëna historike përgjatë 10 viteve të ardhshëm, duke e prioritetizuar realizimin e kësaj mase në varësi të rëndësisë së informacionit historik, gjendjes fizike të tij dhe rrezikut për t'u shkatërruar dhe humbur, si dhe volumit dhe mundësive financiare.

2.3 Kalimi drejt imazherisë: për detin, tokën, nëntokën dhe ajrën. Realizimi i imazherisë ka impakt pozitiv në ofrimin e shërbimeve mbi disponueshmërinë e IG, sepse lejon grumbullimin dhe ruajtjen/mbajtjen (store) automatike të të dhënave të të gjitha kategorive. Imazheria jep informacionin bazë dhe më pas e përpunon sipas specifikës së kërkuar, duke na dhënë pamje të realitetit në mënyrë virtuale. Aktualisht imazheria është lehtësisht e implementueshme, sepse zotërohen teknologjitë e duhura.

2.4 Crowdsourcing: për të bërë përditësimin, saktësimin dhe kontrollin e të dhënave nga disa burime, duke identifikuar të gjitha burimet potenciale, nga individët, tek biznesi dhe institucionet. Mënyrat e jetësimit të kësaj mase janë nëpërmjet përdorimit të fotove selfie, dronëve dhe kamerat e sigurisë apo të makinave, duke ngritur skema incentivuese përkatëse për angazhimin e burimeve dhe duke përgatitur bazën ligjore dhe strukturat përkatëse për grumbullimin dhe verifikimin e këtyre të dhënave apo informacioneve. Crowdsourcing është një masë lehtësisht e implementueshme, sepse angazhon vetë përdoruesit e IG, duke i ndërgjegjësuar në këtë mënyrë për rëndësinë e përdorimit dhe kontributin

²Harta bazë i referohet një grup të dhënash GIS dhe/ose imazheve të ortorektifikuara, që formojnë një hartë mbështetëse bazë, e cila përmban të dhëna gjeohapësinore thelbësore dhe përdoret për të mbështetur punime të ndryshme hartografike. Të dhënat tipike vektor dhe/ose imazhet, që përbëjnë shtresat për një hartë bazë mund të jenë: rrugët, kufijtë (*vendi, qarku, kufijtë e qytetit*), rrugët ujore, ortoimazheria, imazhet satelitore etj. Në varësi të llojit të hartës, çdo kombinim i këtyre shtresave mund të përdoret. Harta bazë krijohet si kornizë me funksion përpunimi. Të dhënat e një harte bazë, janë të dhëna minimale që duhet të ketë çdo hartë që krijohet (nga institucione shtetërore/private/ apo dhe përdorues të thjeshtë), sipas tematikave të ndryshme. Një hartë bazë është paraqitja grafike në një shkallë të caktuar e informacioneve kryesore të përzgjedhura dhe ajo përdoret si një kornizë mbi të cilën mund të përpunohen të dhëna gjeohapësinore të tjera, të një natyre të specializuar. Llojet e hartës bazë mund të ndryshojnë nga tipi, shkalla dhe informacioni i trajtuar, si hartat bazë vektor dhe hartat bazë mbulim.



që mund të japë secili prej tyre për zhvillimin e sektorit.

2.5 Teknologji opensource: Përdorimi i teknologjisë opensource dhe web-based, e cila ka avancuar në mënyrë të dukshme dhe jep mundësi të shumta për të plotësuar nevojën e institucioneve. Kjo do ndikonte në aplikimin e gjerë të sistemeve GIS nga përdorues të ndryshëm dhe në çdo kohë dhe vend, duke ulur ndjeshëm kostot për licencat dhe aplikimin e teknologjisë.

2.2.3 Politika Nr. 3 “Aksesimi i lirë & pa pengesë i Informacionit Gjeohapësinor”

Aksesimi i duhur është procesi në fund të të cilit kemi informacion gjeohapësinor të gatshëm për t’u përdorur nga klientët. Kjo fazë e ofrimit të shërbimeve mbi informacionin gjeohapësinor mbyll ciklin që fillon me kërkesën e shprehur nga klienti, për të qenë plotësisht e gatshme për të plotësuar nevojat e klientit, pasi është procesuar dhe formësuar. Aksesimi është i nevojshëm, sepse ofron mundësinë e shfrytëzimit të së drejtës së përdorimit nga tërësia e përdoruesve, duke ofruar një produkt të plotësuar në të gjitha komponentët, të servirur në vendin e duhur.

Sot shumë sisteme/produkte janë të dizenuara në mënyrë cilësore dhe funksionale, por përsëri tregtueshmëria e tyre mbetet e ulët, kjo pasi njerëzit nuk e dinë ekzistencën e tyre. Nëse një produkti të prodhuar nuk i gjen treg, do rezultojë në një dështim, pavarësisht se mund të jetë shumë mirë i dizenuar, funksional dhe praktik. E njëjta situatë paraqitet edhe në sektorin e informacionit gjeohapësinor, ku pavarësisht se gjeoportali funksionon duke ofruar të dhëna dhe informacion për një sërë fushash tematike (sipas Pyetësorit të Gjeoportalit, rezulton se më së shumti ai përdoret³ për qëllime profesionale institucionale, për përfitim informacioni hartografik, për arsye studimore bulumtuese, për zhvillim projektesh, për qëllime private dhe një pjesë për turizëm dhe mapping), përsëri përdorimi i tij mbetet në nivele shumë të ulëta, kryesisht për shkak të njohjes dhe shfaqjes së paktë të tij kundrejt përdoruesve.

Urgjenca bazë kundrejt sektorit është pasja e një informacioni të plotë, *multilayer* dhe të aksesueshëm në kohë reale, për t’u vënë në dispozicion të të

gjithëve. Gjithashtu shpeshherë nevojë për përdoruesit është pasja e *tutorials* dhe manualeve shpjeguese për të ditur sesi mund ta aksesojnë informacionin gjeohapësinor dhe cilat janë mënyrat e ndryshme të përdorimit të tij në zgjidhjen e problemeve dhe situatave të ndryshme. Lidhur me këtë, sipas rezultateve të fundit të Pyetësorit të Gjeoportalit, rezulton se 64.4% e përdoruesve janë shprehur se tutorialët duhet të jenë video dhe 33.1% mendojnë si më efektiv formatin në PDF, duke arritur në përfundimin se janë ndihmuar shumë nga publikimet e tutorialëve gjatë punës së tyre. Pavarësisht se krijimi i gjeoportalit ka sjellë një ndryshim thelbësor në mënyrën e të menduarit, duke integruar dhe ofruar akses pa pagesë të një sërë informacionesh, përsëri vëmendje duhet t’i kushtohet hapjes së shërbimeve të informacionit gjeohapësinor në të gjitha format e veta, duke lehtësuar aksesueshmërinë nëpërmjet opsioneve: *view*, *upload/download*, *edit*, *opsionet mbi matjen*, etj.

Nga sa më sipër si çështje kryesore për t’u adresuar evidentohen:

-Akses i kufizuar dhe shpeshherë me barriera tarifore apo ligjore për aksesimin e informacionit gjeohapësinor, në të gjitha institucionet, qoftë ai manual, dixhital apo në sistemet GIS. *Shembull për këtë është IGJEUM që shet kundrejt tarifave të larta informacionet për hidrografinë, gjeologjinë, sizmiken, etj, apo informacioni nga ZRPP që pavarësisht sistemit teknologjik, nuk ka shërbimet e nevojshme të rrjetit për të mundësuar shfaqjen e tij në gjeoportalin e ASIG.*

-Mungesa e njohurive për vendndodhjen, natyrën dhe mundësinë e pasjes së informacionit gjeohapësinor në çdo institucion në përgjithësi dhe një njohje e kufizuar për funksionimin dhe mundësitë që ofron gjeoportali kombëtar, reflektuar kjo në përdorimin e kufizuar të tij, pavarësisht trendit në rritje që ka përdorimi i këtij gjeoportali në mënyrë të vazhdueshme.

-Njohuri e kufizuar e përdoruesve për ta aksesuar, shkarkuar dhe përpunuar informacionin gjeohapësinor në të gjitha format e veta, që dikton nevojën për të patur manuale apo *tutorials* të qarta dhe të thjeshta shpjeguese, si dhe një cikël periodik dhe të vazhdueshëm ngritjeje kapacitetesh për aksesimin e informacionit nga përdoruesit.

-Ndërgjegjësim i ulët kundrejt përfitimit dhe vlerës së shtuar të informacionit gjeohapësinor në vendimmarrje të fushave të ndryshme, që çon në mungesën e vullnetit dhe angazhimit për të qenë

³Shiko edhe të dhënat statistikore të publikuara në Raportin “Vepimtarja e ASIG 2014-2018”:

http://www.asig.gov.al/images/DokumentaPDF/Vepimtarja_e_ASIG_2014_2018.pdf



pjesë aktive e sistemit të integruar të informacionit gjeohapësinor, pavarësisht detyrimeve ligjore apo institucionale që mund të ekzistojnë.

Deklarata e Politikës nr.3 “Aksesimii lirë & pa pengesë i Informacionit Gjeohapësinor”:

“Garantimi i aksesit të hapur dhe të menjëhershëm në informacionin gjeohapësinor, i përdorshëm në të gjitha format e veta dhe nga të gjithë përdoruesit, i thjeshtë për t’u marrë dhe përdorur, pa barriera monetare apo teknologjike, nëpërmjet një promocioni “agresiv” për njohjen e produktit dhe edukimit të përdoruesve për mënyrën e aksesimit dhe shfrytëzimit të informacionit të vënë në dispozicion.”

Në mënyrë që IG të përdoret duhet që të rritet ndërgjegjësimi kundrejt përdoruesve për ekzistencën e gjeoportalit, të lehtësohet aksesueshmëria, të shpjegohet nëpërmjet manualeve të thjeshta sesi mund të aksesohen të dhënat si dhe të rritet dija për mënyrën e përdorimit dhe të implikimit të informacionit gjeohapësinor në situatat dhe problemet e ndryshme të jetës së përditshme të institucioneve / organizatave apo përdoruesve individualë.

Kjo politikë synon të përdorë një marketing “agresiv” kundrejt përdoruesve apo metoda interaktive për transferimin e njohurive/dijes (*si video-tutorials*), duke përdorur të gjitha mjetet dhe mënyrat e nevojshme në mënyrë që produktit të prodhuar, të plotësuar në të gjithë komponentët e tij, t’i gjendet tregu potencial. Kjo përbën një sfidë më vete pasi ndërgjegjësimi synon të ndryshojë një mënyrë shumë vjeçare të të menduarit dhe të zgjidhjes së problemeve, ku pjesën më të madhe të rasteve shkohet drejt perceptimit kuturu të realitetit fizik, në vend të kryerjes së analizave të detajuara dhe kuptimplota të cilat kanë një bazë të rëndësishme të tyre mbështetjen në IG.

Masat për jetësimin e politikës nr. 3:

3.1 Fuqizimi i gjeoportalit dhe përmirësimi i shërbimit bazuar në feedback-un e përdoruesve (mund të dizajnohet si një “hartë” ku tregohet se çfarë mund të gjendet, ku mund të gjendet, në çfarë formati, etj, për të gjitha institucionet dhe bizneset, etj.) si dhe rritja e aksesueshmërisë dhe lehtësisë në përdorim nëpërmjet krijimit të aplikacioneve GIS të përshtatshme në versione të ndryshme mobile, ipad etj. Përfitimi që vjen nga kjo masë lidhet me marrjen e reagimeve dhe mundësinë për të bërë

ndryshime të shpejta në përputhje me kërkesat e përdoruesve dhe problematikat e shprehura prej tyre, duke rritur funksionalitetin dhe shkallën e përgjigjshmërisë, si dhe lehtësi aksesimi nëpërmjet krijimit të platformave user-friendly, të përshtatshme në të gjitha pajisjet (devices), duke rritur informimin dhe përdorimin nga të gjithë, në cilindo moment apo vendndodhje.

3.2 Rritja dhe hapja e shërbimevetë informacionit gjeohapësinor, si view, download, edit, etj, për të mundësuar aksesimin në të gjitha format e informacionit gjeohapësinor. Kjo masë do të sjellë lehtësi në procesimin e të dhënave, duke ndihmuar përdoruesit në shkarkimin, shikimin, ndërtimin e query të ndryshëm, etj., duke nxitur drejtim më të shpejtë kundrejt gjeoportalit. Kostot janë të ulëta dhe ASIG mundëson rritjen e aksesueshmërisë së bashku me tutorialet e qarta shpjeguese.

3.3 Organizimi i fushatave sensibilizuese & Ngritja e kapaciteteve të përdoruesve:

Organizimi i fushatave sensibilizuese (workshops, takime, etj.) për aktorët rreth rëndësisë së informacionit gjeohapësinor dhe sektorit të IG, duke i azhurnuar me ndryshimet e fundit të teknologjisë IG dhe zhvillimit të përdorimit, për të nxitur shkallën e angazhimit të aktorëve dhe/ose bashkëpunimin midis tyre në iniciativat e reja, si dhe promovimi përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit (multimedia, rrjetet sociale), duke përdorur shembuj ilustrues dhe video interesante mbi përfitimet dhe mënyrën e përdorimit të IG në fusha të ndryshme. Ngritja e kapaciteteve të përdoruesve për t’u shpjeguar si mënyrën e marrjes së informacionit, ashtu dhe mënyrën për përdorimin të tij për çështje të ndryshme (njësoj si manualët e përdorimit dhe të përfitimeve që kemi për një pajisje apo aktivitet). Krijimi i fushatave synon të nxisë rritjen e ndërgjegjësimit dhe shkallë më të lartë angazhimi mes aktorëve, duke sjellë përfitim të lartë për sektorin. Kjo masë sjell përfitim shumë të lartë për të shtuar aksesimin kundrejt gjeoportalit dhe njohjen me mënyrat e shumta të përdorimit të këtij informacioni. Kosto është e ulët, kjo masë mund të angazhohen studentë dhe të tjerë të apasionuar pas videove, marketingut, dizajnit për të bërë përgatitje të materialeve dhe shpërndarje të tyre. ASIG imponon përfshirjen e linkut të faqes së tij në portalet e strukturave me të cilat bashkëpunon. Kjo masë do sjellë përfitime të



konsiderueshme për të mundësuar orientimin sesi mund të aksesohet IG dhe njëkohësisht duke dhënë shembuj ilustrues sesi mund të bëhet aplikimi i këtij informacioni në përmbushje të nevojave të ndryshme, duke sjellë ndërjegjësim dhe interes më të madh kundrejt sektorit.

3.4 Ndërtimi i GIS Kombëtar i cili integron të gjithë GIS tematikë të autoriteteve publike dhe realizon kërkesën ligjore aktuale për ndërtimin e GIS kombëtar, nëpërmjet identifikimit dhe draftimit të procedurave, teknologjisë, dhe udhëzimeve për ndërveprueshmërinë, integrimin dhe vënien në dispozicion nga Gjeoportali Kombëtar i llojeve të të dhënave gjeohapësinore të përzgjedhura nga ASIG në bashkëpunim të ngushtë me institucionet respektive partnere. Kjo do të mundëson të përgatitjen e një programi kombëtar (dhe të planit të tij të zbatimit), për zhvillimin e mëtejshëm të NSDI (infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor), nëpërmjet bashkëpunimit me aktorët kryesorë dhe qasjen e duhur (agile approach). Ndër rezultatet kryesore do të jetë bashkëpunimi ndërsektorial për realizimin e një kornize kombëtare për ofrimin e zgjidhjeve teknike për të mundësuar ndërveprimin e të dhënave dhe sistemeve. Ky është parakusht për të siguruar qasje të hapur dhe të lehtë në të dhënat themelore për Shqipërinë - për të mbështetur një numër rastesh të ndryshme përdorimi në shoqëri.

Kjo masë do të sjellë përfitime të konsiderueshme për të mundësuar zbatimin e duhur të kërkesës së ligjit për të pasur një GIS Kombëtar, duke integruar të gjithë të tjerët (GIS) tematikë. Është me përfitim të madh për të shmangur mbivendosjet dhe për të siguruar integrimin e duhur midis sektorit IG, për këtë arsye është i nevojshëm bashkëpunimi ndërmjet ASIG dhe institucioneve që janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e grupeve të zgjedhura të të dhënave (psh. adresat, parcelat kadastrale, ndërtesat, përdorimi i tokës, infrastruktura urbane). Përmes kësaj mase ASIG do të jetë në gjendje të specifikojë platformën teknike të Infrastrukturës së të Dhënave Gjeohapësinore (SDI) në mënyrë që të mundësojë shkëmbimin, harmonizimin dhe ndërveprimin e grupeve të të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore (psh. detajet teknike), në përputhje me Direktivën INSPIRE. Kjo do të shërbejë si një shembull për: i) krijimin e modeleve të të dhënave,

procedurave dhe sistemeve që sigurojnë të dhënat më të mira në dispozicion për një zonë, të përshkruara sipas një standardi kombëtar dhe konform standardeve INSPIRE; ii) vendosjen e marrëdhënieve institucionale dhe praktikave të biznesit midis ASIG dhe ofruesve të të dhënave NSDI, që inkurajojnë mirëmbajtjen dhe përdorimin e të dhënave gjeohapësinore.

2.3 POLITIKAT E PËRDORIMIT TË INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR

Përdorimi dhe përdoruesit e Informacionit Gjeohapësinor, si çdo produkt apo shërbim, përbëjnë praktikisht “tregun” e tij. Një produkt që nuk ka treg, nuk ka kuptim ta prodhosh. Përdorimi i Informacionit Gjeohapësinor për të përmbushur nevojat e përdoruesve, është rezultati apo “outcome” i sistemit të informacionit gjeohapësinor dhe manaxhimi i këtij rezultati për të patur përdorimin e Informacionit Gjeohapësinor në kohë, kosto dhe cilësinë e kërkuar nga përdoruesit, është thelbësor për përdorimin e tij nga të gjithë përdoruesit. Vendimmarrja e duhur që bazohet mbi përdorimin e Informacionit Gjeohapësinor, është impakti që ka informacioni gjeohapësinor, sa më sipër synimi është përdorimi i informacionit gjeohapësinor për të kuptuar sesi ka qenë realiteti i djeshëm, si është sot, cilat janë projeksionet e së ardhmes me qëllim realizimin e një vendimmarrje më të mirë, kundrejt të gjithë vendimmarrësve, në të gjitha nivelet e qeverisjes qendrore dhe lokale. Pra, në mënyrë të përmbledhur, qëllimi kryesor është: të kuptosh të djeshmen, të sotmen dhe të ardhmen në funksion të vendimmarrjes së duhur.

Drejtimet e politikave që lidhen me synimin strategjik II për përdorimin e IG, janë në përputhje edhe me kornizën strategjike gjithëpërfshirëse (IGIF) të UN-GGIM, konkretisht me: Drejtimin Strategjik 4 “Të Dhënat”, Drejtimin Strategjik 7 “Partneritete” dhe Drejtimin Strategjik 9 “Komunikim dhe angazhim”.

Drejtimet kryesore të politikës për të bërë të mundur realizimin e synimit strategjik për përdorimin e plotë dhe të vazhdueshëm të Informacionit Gjeohapësinor nga institucionet shtetërore, sipërmarrjet private, organizatat komunitare dhe publiku i gjerë, për të njohur realitetin ekzistues në të gjithë elementët e tij, për të kuptuar ndryshimin, sjelljen dhe ligjësinë e ndryshimit gjatë kohës dhe për të projektuar të ardhmen në funksion të vendimmarrjes së duhur

për një qeverisje dhe të ardhme më të mirë, orientohen sipas “klientëve” pra shihen në raport me përdoruesit përkatës, të kategorizuar në 3 grupe kryesore: institucionet shtetërore (autoritetet publike), sipërmarrja private, komunitetet dhe publiku i gjerë, si më poshtë:

-Politikat për përgjegjësinë dhe detyrimin e Institucioneve publike (qendrore, rajonale apo vendore), për përdorimin e Informacionit Gjeohapësinor në mënyrë të vazhdueshme në njohjen, analizën dhe planifikimin për të orientuar vendimmarrjen e duhur.

-Politikat për ndërtimin e partneritetit dhe bashkëpunimit me sipërmarrjen private, prodhues, përdorues apo përfitues nga përdorimi i informacionit gjeohapësinor, për të rritur përdorimin, volumin dhe cilësinë e informacionit gjeohapësinor dhe për të optimizuar burimet, teknologjinë dhe ndarë përvojën dhe dijen në sektorin e Informacionit Gjeohapësinor.

-Politikat për promovimin dhe ndërgjegjësimin e komuniteteve dhe publikut të gjerë, për mundësitë, rëndësinë dhe përfitimet që vijnë nga përdorimi i informacionit gjeohapësinor, si dhe mundësitë që ofrohen nëpërmjet dhënies së këtij informacioni gjeohapësinor nga institucionet shtetërore, në mënyrë të hapur të shpejtë dhe pa kosto në përdorimin e tij.



2.3.1 Politika nr. 4 “Përgjegjësia & detyrimi për përdorimin nga institucionet publike”

Qeverisja qendrore apo vendore është përgjegjëse për vendimmarrjen e saj përkundrejt qytetarëve, edhe për shkak se kjo vendimarrje në qeverisje ka një impakt dhe peshë shumë më të madhe se vendimmarrja në organizatat private apo ato joqeveritare. Ndaj detyrimi për të patur një

vendimarrje që bazohet në njohje të plotë dhe të thellë të situatës, analizës së faktorëve dhe shqyrtimit të të gjitha opsioneve për të vlerësuar se cila është zgjidhja më e mirë, është një detyrim ligjor dhe institucional.

Por situata ekzistuese nuk përputhet me atë që kërkohet në raport me përdorimin e informacionit gjeohapësinor nga institucionet publike. Ajo që vihet re nga analiza e kësaj situatë është se në shumë raste vendimmarrja nuk është e bazuar në një njohje të plotë dhe në të gjithë faktorët e realitetit. Kështu kemi leje HEC-esh që jepen pa ditur pozicionimin e saktë në territor dhe si kjo lidhet me zonat e mbrojtuar mjedisore, duke u ndodhur më pas në situata problematike duke hyrë në beteja ligjore për anulimin e këtyre lejeve, apo projektohen rrugë transporti pa ditur statusin e pronave që preken duke hyrë në konflikte sociale të panevojshme për secilën palë të përfshirë. Në këtë pikë, mospërdorimi i informacionit gjeohapësinor për vendimmarrjen në territor, e ka origjinën në faktin që vendimet që marrim sot, i japin efektet në të ardhmen. Kjo vlen si për përfitimet ashtu dhe për dëmin që mund të vijë si pasojë e një vendimarrje në një moment të caktuar. Pra mosvlerësimi i përfitimeve dhe vlerës së jashtëzakonshme që buron nga përdorimi i informacionit të saktë dhe të plotë apo nga analiza e tij, nuk është e prekshme dhe e kapitalizueshme sot apo në të ardhmen e afërt, ashtu siç dëmi që mund të vijë nuk do shfaqet po ashtu shpejt dhe, në shumicën e rasteve, ai që ka marrë vendimin nuk është aty kur pasojat e vendimmarrjes do të shfaqen. Askush nuk i kthehet të mendojë që, pasojat e një përmbajtjeje apo tërmeti, vijnë kryesisht për shkak se vendimmarrja nuk është bërë bazuar në informacion të saktë dhe analizë të thellë të sjelljes së mjedisit ndër vite.

Ka problematika me faktin që të gjithë duan ta prodhojnë vetë informacionin gjeohapësinor që ju duhet dhe vetëm për vete, duke tentuar të krijojnë sisteme të mbyllura, ndërkohë që mund ta gjejnë dhe përdorin këtë informacion nga institucione, agjenci apo dhe nga sipërmarrjet, në cilësi shumë më të mirë dhe me kosto minimale. Kjo qasje e fut përdorimin e informacionit gjeohapësinor në një cikël negativ, pasi prodhimi vetë, nga kufizimi në burime, ekspertizë, teknologji, etj, përfundon në një informacion me cilësi të ulët, jo në kohën e duhur dhe që nuk ndihmon në njohjen apo kuptimin e



situatës duke zhvleftësuar nevojën për të në të ardhmen.

Pavarësisht se në përgjithësi institucionet publike kanë detyrime ligjore të përcaktuara në raport me përdorimin dhe ndarjen e informacionit gjeohapësinor, ky detyrim ligjor i pashoqëruar me detyrimin teknik dhe interesin e vetë institucionit, shpesh anashkalohet lehtësisht duke patur argument, pikërisht qasjen e gabuar *“çdo gjë duhet ta prodhojmë vetë”*, dhe duke u justifikuar me mospasjen në dispozicion të burimeve, teknologjisë, kapaciteteve, strukturave, etj.

Një arsye tjetër kryesore për mospasjen e interesit për përdorimin e informacionit gjeohapësinor, është fakti që njohja dhe pasqyrimi i saktë i realitetit, analiza e thellë e ndryshimeve dhe sjelljes së tij, krijon problematika me performancën e ulët, cilësinë e dobët apo keqpërdorimin e burimeve dhe kohës në dispozicion. Përdorimi i ortofotos në një shumicë rastesh krijon edhe ‘probleme’ për shkak të ballafaqimit me saktësinë e IG të tilla si psh. me cilësinë e regjistrimit të pronave, apo cilësinë e projekteve të ndryshme të infrastrukturës apo me lejet apo miratimet e ndryshme në territor, ndaj si rezultat, ka dhe një shtysë negative për mospërdorimin e informacionit gjeohapësinor, për të lejuar kështu që të vazhdohet ende me ‘vlerësimin e performancës’ mbi bazën e opinioneve apo shifrave që nuk mund të perceptohen dhe të bëjnë sens në territor.

Ekziston një niveliulët i kapaciteteve drejtuese dhe manaxheriale që kanë strukturat përgjegjëse për vendimmarrje kryesisht si dhe njohje e pakët e IG dhe rëndësisë së tij, kjo e shoqëruar dhe me lëvizjetë shpeshta të stafit drejtues. Niveli i ulët në planifikim dhe kontroll, apo në standarde dhe procedura, e bën jo të nevojshëm pasjen e një IG të saktë dhe të detajuar, madje në një sërë rastesh Drejtuesit e shikojnë këtë aspekt si njëpunë shtesë dhe ngarkesë të tepërt për t’u realizuar. Kjo ka sjellë që kapacitetet dhe njohja e rëndësisë dhe vlerës së informacionit gjeohapësinor, të jenë të kufizuara në nivelin e specialistëve dhe kryesisht atyre të sektorit të informacionit, që përgjithësisht nuk janë përdorues (usera) pasi nuk kanë shumë vendimmarrje për të bërë.

Çështjet kryesore që duhet të adresohen nëpërmjet politikës për përdorimin e informacionit gjeohapësinor nga institucionet publike, janë:

-Ndërgjegjësimi i përdoruesve për rëndësinë dhe vlerën që ka përdorimi i IG për vendimmarrjen sot, si në përfitimet ashtu dhe në pasojat që kjo sjell në të ardhmen.

-Ngritja e kapaciteteve të nivelit drejtues dhe manaxherial, për përcaktimin e drejtimeve dhe objektivave, për planifikimin, kontrollin, etj, që në thelb dhe si rezultat përfundimtar kanë vendimmarrjen e duhur. Shpjegimi i rëndësisë dhe pamundësisë për të marrë vendimet e duhura, pa patur IG të plotë në kohën e duhur dhe në cilësinë e nevojshme.

-Lidhja e IG me vlerësimin e performancës së institucioneve, nëpërmjet vendosjes së KPI dhe Benchmarkeve të performancës në territor, duke kuptuar potencialin dhe ndihmesën e madhe që të jep IG për të njohur, kuptuar dhe përmirësuar performancën.

-Përcaktimi dhe zbatimi i një kuadri masash ligjore, institucionale dhe teknike që e bëjnë të detyrueshëm dhe të zbatueshëm përdorimin e informacionit gjeohapësinor në standardin, formën dhe kohën e duhur.

Deklarata e Politikës nr.4 “Përgjegjësia dhe detyrimi për përdorimin nga institucionet publike”:

“Përdorimi i detyrueshëm nga Institucionet publike (qendrore, rajonale apo vendore) i informacionit gjeohapësinor në mënyrë të vazhdueshme, për të bërë të mundur, njohjen, analizën dhe planifikimin gjeohapësinor, për të orientuar vendimmarrjen e duhur të drejtuesve dhe për të përcaktuar performancën dhe cilësinë e shërbimeve që ofrohen nga këto institucione për çështje të vendimmarrjes në territor.”

Qeverisja dhe institucionet publike të saj, kanë detyrimin dhe përgjegjësinë për vendimmarrjen më të mirë të mundshme në funksion të zhvillimit të vendit dhe mirëqënies së qytetarëve, duke ushtruar vullnetin që populli i ka deleguar për të marrë vendime. Për rrjedhojë, përdorimi i çdo lloji informacioni në përgjithësi dhe atij IG në veçanti, është detyrim dhe përgjegjësi e çdo institucioni dhe vendimmarrësi në to.

Politika e qeverisjes në përmbushje të kësaj, synon që institucionet publike (qendrore, rajonale apo vendore), të kuptojnë rëndësinë dhe vlerën e përdorimit të IG, që mundëson njohjen, analizën, dhe planifikimin gjeohapësinor, për të patur kështu



vendimarrjen e duhur dhe shërbimin që duam ndaj publikut.

Politika e qeverisjes për përdorimin e IG nga institucionet publike, synon gjithashtu ndërgjegjësimin dhe ngritjen e kapaciteteve drejtuese dhe manaxheriale në përcaktimin dhe monitorimin e objektivave dhe strategjive, në organizimin institucional dhe vlerësimin e performancës, në planifikim, zbatim dhe kontroll të planeve, të cilat në thellim të tyre kanë nevojën për IG, duke krijuar kështu shtysën e nevojshme që vetë drejtuesit dhe manaxherët e institucioneve të ndiejnë domosdoshmërinë dhe të kërkojnë pasjen dhe përdorimin e IG për mbarëvajtjen e institucioneve dhe punëve të tyre.

Kjo duhet të shoqërohet me vendosjen e matësve të performancës për çdo institucion dhe përtërhyerja e tyre në territor, duke materializuar performancën e institucioneve nga koncepte abstrakte të shifrave dhe statistikave, në koncepte hapësinore duke dhënëqartësisht se si reflektohen ato në territor.

Nëpërmjet kësaj politike synohet gjithashtu përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit rregullator, institucional dhe atij teknik, për të mundësuar një kornizë të plotë parandaluese, detyruese dhe të zbatueshme për institucionet publike, në bazë të së cilës, do të vlerësohet zbatueshmëria dhe përgjegjësia e çdo institucioni në raport me zbatimin e duhur të kërkesave për përdorimin e IG.

Masat për jetësimin e politikës nr. 4:

4.1 Fushatë sensibilizuese për përdorimin e informacionit gjeohapësinor duke përdorur metodën e së kundërtës: *“Si do ishte bota, jeta jonë dhe aktiviteti i institucioneve/autoriteteve publike, pa informacion gjeohapësinor?”*. Identifikimi i potencialit dhe përfitimeve në mënyrë të matshme dhe konkrete (në natyrë, vlerë dhe kohë) nga njëra anë dhe dëmit (në natyrë, vlerë dhe kohë) që mund të kemi nga krahut tjetër. Hartimi i një strategjie promovimi dhe përdorimi i institucioneve të specializuara për konceptimin dhe zbatimin e fushatës, duke i dhënë një rol aktiv studentëve dhe fakultetit/dega Gjeodezi si një grup interesi i fuqishëm për promovimin e IG dhe nevojës për të. *Kjo masë e jetëson politikën sepse mundëson përmbushjen me sukses të procesit të marrjes së vendimit të duhur, pasi është kuptuar rëndësia e përdorimit të IG, është njohur dhe planifikuar vendimi.*

4.2 Modeli i suksesit për t'u ndjekur (institucione/projekte pilot): Është e rëndësishme që ASIG në bashkëpunim me institucione të tjera (ato autoritete publike përgjegjëse për temat e informacionit gjeohapësinor) që kanë nevojën, dëshirën dhe anagazhimin për përdorimin e informacionit gjeohapësinor, të ndërtojnë modele suksesi nga përdorimi i këtij informacioni duke patur, institucione pilot në të gjithë elementët e tyre apo projekte pilot në disa institucione. *Kjo masë është me impakt të rëndësishëm jo vetëm për institucionet publike të cilët do të ndjekin modelin e suksesit, por edhe për vetë institucionet pilot të cilët do të mundin të përfitojnë aftësi në marrjen e vendimeve të duhura bazuar në përdorimin e IG. Duke patur një model suksesi, institucionet do të kenë një bazë të sigurtë nga ku mund të nisin zhvillimin e tyre në këtë aspekt, si dhe mund të përmirësohen mbi atë model.*

4.3 Përtërhyerja e KPI dhe matësve të performancës: për të gjithë institucionet në territor, duke ndjekur më pas realizueshmërinë dhe arritjen e këtyre treguesve të materializuar në territor, duke e bërë më të prekshme dhe reale performancën e treguar thjesht me shifra dhe statistika. Kjo mund të fillohet me KPI e vendosura nga Njësia e Jetësimin të Prioriteteve pranë Kabinetit të Kryeministrit, të cilat duhet të kthehen në KPI të vendosura në territor si dhe matje e realizueshmërisë së tyre përsëri e vizualizuar nëpërmjet IG. *Realizimi i masës ka impakt pozitiv në ecurinë e zhvillimit të cilësisë së shërbimeve që ofrohen nga institucionet për çështje të vendimarrjes në territor, sepse tregon performancën, duke konsideruar më pas mundësinë për korrigjim dhe përmirësim.*

4.4 Hartimi i një pakete detyruese: të plotë për institucionet publike, që do përfshijë jo vetëm përcaktimin dhe detyrimin ligjor për përdorimin e informacionit gjeohapësinor, por edhe përcaktimet dhe detyrimin institucional dhe teknik për përdorimin e informacionit gjeohapësinor, psh. mospranimin e produkteve që nuk janë sipas standardit të përcaktuar. Pjesë e kësaj mase është edhe **detyrimi për të përdorur Hartën Bazë** (nëpërmjet projektit JICA), që duhet të mbështetet në vijim edhe me ndryshimet e nevojshme ligjore (Harta bazë përmban të dhëna gjeohapësinore thelbësore dhe përdoret për të mbështetur punime të ndryshme hartografike. Të dhënat e një harte bazë, janë të dhëna minimale që duhet të ketë çdo hartë që krijohet nga institucione shtetërore/



private/apo dhe përdorues të thjeshtë, sipas tematikave të ndryshme). Harta Bazë duhet të jetë e detyrueshme të përdoret nga të gjitha autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore sipas temave të caktuara.

Masa e jetës politikën nëpërmjet përvaktimit të detyrimit ligjor të përdorimit të informacionit gjeohapësinor gjatë punës së institucioneve, duke konsideruar edhe mundësinë e përgjegjësisë në rast mospërmbyshje të detyrimit. Kjo masë ka impakt pozitiv sepse përvakton qartë, duke mos lënë hapësira për interpretime dhe neglizhencë nga ana e institucioneve, përgjegjësitë e secilit në raport me përdorimin e IG dhe përzgjedhjes së produkteve të përshtatshme. Lidhur me krijimin dhe detyrimin për përdorim të Hartës Bazë vektoriale, të dhënat e saj kanë potencial të madh për shkak se është një produkt që mund të ofrojë më shumë mundësi në fushën e përdorimit të të dhënave gjeografike. Ndaj Harta Vektor është produkt i preferuar dhe i rekomanduar për agjencitë qeveritare, sepse të dhënat e saj bëjnë të mundur kryerjen e të gjitha analizave të mundshme, duke qenë një mjet i shkëlqyer në planifikimin shtetëror, nga vendimmarrësit në qeverisjen qendrore deri në atë të nivelit vendor. Referuar shembujve në përdorim, rezulton se Harta Vektor i ofron vendimmarrësit një pasqyrë mbi strukturat dhe objektet e rëndësishme në rajon, përbën bazën e vendimeve nga ku do të ndërtohet një objekt, në rrjetet kombëtare të transportit rrugor apo në rrjetet e linjave elektrike etj., shërben në analizat e përmbytyjeve, të taksimit të pasurive të paluajtshme dhe planet e emergjencës, etj. Shumë kompani private dhe industri shkencore janë gjithashtu përdoruesit e të dhënave të Hartës Vektor, për këtë arsye ato mund të jenë një treg i mundshëm për të ardhurat komerciale.

2.3.2 Politika nr. 5 “Partneritet & Përfitim reciprok me sipërmarrjet private”

Përdorimi i informacionit gjeohapësinor ka një rëndësi shumë të madhe për të gjitha kategoritë e sipërmarrjes private, për të orientuar vendimmarrjen e tyre të përditshme, afatshkurtër apo strategjike. Informacioni gjeohapësinor i shërben si sipërmarrjes në bujqësi me informacionin mbi tokën, klimën, reshjet, hidrografinë, etj., zhvillimeve turistike dhe ato të infrastrukturës me topografinë, nëntokën, rrjetet e infrastrukturës publike, apo kompanive të shërbimeve të ndryshme duke filluar nga shpërndarja e popullsisë, tek rrjetet e shpërndarjes së produkteve dhe shërbimeve e deri tek sistemi i adresave për bankat dhe kompanitë postare, etj.

Vendimmarrja e orientuar saktë dhe bazuar në njohjen, kuptimin dhe projeksionet e realitetit të biznesit, ka një ndikim të drejtë dhe thelbësor për zhvillimin e biznesit në veçanti dhe zhvillimin ekonomik të vendit në përgjithësi, duke e bërë detyrimin për përmirësimin e përdorimit të IG nga biznesi dhe partneritetin me të në këtë drejtim, një detyrim dhe përgjegjësi të qeverisjes.

Nëse për institucionet publike, lidhja shkaktuese mbi bazën e përdorimit të informacionit gjeohapësinor ka një cikël më të gjatë, në rastin e biznesit ky cikël është më i shkurtër dhe matja e tij është më e lehtë duke parë efektin direkt në performancën, të ardhurat dhe kostot e biznesit. Madje në teorinë e marketingut një nga katër “P”-të themelore është “Place”, pra vendodhja apo pozicionimi në hapësirë i “Product, Price dhe Promotion”.

Situata aktuale në raport me përdorimin e informacionit gjeohapësinor nga sipërmarrja tregon mangësi dhe në këtë drejtim, duke pasur një përdorim të ulët dhe sipërfaqësor në njohjen e realitetit dhe tregut. Po ashtu analizat e ndryshmeve të tregut apo aktivitetit të biznesit në territor, bëhen në mënyrë të përcipte dhe janë kryesisht opinione dhe përgjithësim, sesa studime të mirëfillta tregu. Gjithashtu projeksionet dhe planifikimi për të ardhmen, bëhet në mënyrë të përgjithshme në rastin më të mirë dhe fiktiv në rastin më të keq, sidomos kur planet e biznesit janë për banka apo institucione të tjera financiare.

Siç u citua më lart, në aspektin ekonomik IG ka rëndësi jetike dhe ndihmon aktivitetin e bizneseve dhe sipërmarrjeve në zhvillimin sipas kërkesës së rezultuar nga informacioni. Kohët e fundit ka një ndërveprim në rritje midis sipërmarrjes private, kryesisht asaj që është në sektorin e prodhimit të informacionit gjeohapësinor apo asaj që e ka lëndë të parë informacionin gjeohapësinor (si projektuesit e infrastrukturës apo arkitektët) që janë përdorues direkt të informacionit gjeohapësinor, me informacionin e gjeneruar nga institucionet shtetërore dhe kryesisht gjeoportali i ASIG. Por kjo marrëdhënie, deri më sot, funksionon vetëm në njërin drejtim pra në marrjen e informacionit, ndërkohë që kjo marrëdhënie duhet të funksionojë në të dyja drejtimet, pra sipërmarrja private dhe institucionet/autoritetet publike duhet të japin dhe marrin të dhëna dhe informacion gjeohapësinor me njëri-tjetrin, duke rritur performancën në mënyrë të



vazhdueshme në këtë drejtim, referuar informacionit gjeohapësinor dhe përdorimit të tij. Kështu projektuesit e infrastrukturës mund të përdorin ortofoton nga gjeoportali, por, nga ana tjetër, çdo imazheri që ata mbledhin në terren, mund të ngarkohet në gjeoportali bazuar në disa standarde të përcaktuara, duke përditësuar kështu elementë të caktuar të ortofotos.

-Çështjet kryesore që duhet të adresojë politika qeverisëse në raport me përdorimin e informacionit gjeohapësinor nga ana e sipërmarrjes private, janë:

-Çështja e parë ka të bëjë me respektimin e standardeve shtetërore për shërbimet dhe produktin e IG nga biznesi që ka si aktivitet të vetin, gjenerimin dhe shitjen e shërbimeve në sektorin e IG, përfshirë kompanitë e shërbimeve gjeodezike, ato të shërbimeve GIS, ato të rregjistrimit të pronave, etj. Vlerësohet që shpeshherë ky biznes nuk i respekton standardet, ku në shumë raste kjo ndodh edhe për produktet dhe shërbimet që blihen prej tyre nga institucionet shtetërore, që kanë detyrimin dhe përgjegjësinë për t'i pasur sipas standardeve shtetërore. Mungesa e standardizimit sjell që bizneset në pjesën më të madhe të fokusohen në përmbushjen e nevojave të tyre momentale, të brendshme, pa e vrarë mendjen për ndërveprimin me aktorë të tjerë dhe duke neglizhuar implikimet afatgjata. Kjo vjen kryesisht si pasojë e mungesës së forcës kontrolluese të respektimit të standardeve nga këto biznese, certifikimin e teknologjisë dhe profesionistëve të fushës dhe masave shtrënguese në mungesë të respektimit dhe zbatueshmërisë së standardeve të miratuara.

-Çështja e dytë që duhet të adresojë politika për përdorimin e IG nga më shumë se 95% e biznesit në Shqipëri që i përkasin kompanive, start-up dhe SME, të cilat nuk kanë as informacionin se “ku” dhe “si” mund të gjendet IG, as njohurinë mbi vlerën dhe nevojën që kanë për të mbi vendimmarrjen e përditshme, operacionale apo strategjike të biznesit të tyre, dhe as mundësitë financiare për të investuar, dhe as kapacitete për ta ngritur dhe mbajtur të përditësuar. Në një studim të fundit të BERZH për sektorin e turizimit në katër qytete të Shqipërisë, konstatohet si mangësi themelore: mungesa e të dhënave, informacionit dhe hartave për turistët, vendet/rrejetet turistike, apo të hoteleve, bujtinave, shpërndarja e tyre në territor, ndryshimi sipas sezoneve dhe viteve, etj., duke qenë dhe një nga faktorët e rëndësishëm për

nivelin e ulët të zhvillimit të turizimit në vendin tonë që ka një potencial të jashtëzakonshëm që nuk shfrytëzohet në këtë sektor.

-Çështja e tretë ka të bëjë me përdorimin dhe ndërveprimin me kompanitë e mëdha publike apo private që ofrojnë shërbime publike në masë të gjerë (*si kompanitë e transportit, energjisë, telekomunikacionit, shëndetësisë, edukimit, sigurisë, shërbimeve administrative si posta, pensione, sigurime, etj.*), që kanë detyrimin për pasjen dhe vënien në dispozicion të informacionit për rrjetet e infrastrukturës dhe shërbimit, por që përsëri kanë si problematikë mënyrën dhe standardin e prodhimit të IG dhe shërbimeve GIS. Për më tepër, ata kanë politikat e tyre për mos ndarjen e informacionit me të tjerët, pavarësisht se një pjesë prej tyre kanë detyrimin t'i dorëzojnë dhe publikojnë rrjetet tek Entet rregullatore përkatëse, nga njëra anë dhe ndërkohë kjo politikë i ka kufizuar të përdorin dhe ndajnë (*share*) IG si me ASIG apo institucione të tjera që ofrojnë shërbime GIS.

-Çështja e fundit kryesore që duhet adresuar ka të bëjë me mungesën e përdorimit në funksion të marrjes së vlerës dhe përfitimeve të shtuara dhe minimizimit të kostove në mënyrë të ndërsjelltë midis kompanive që kanë nevoja dhe kërkesa të mëdha për IG (*si bankat, kompanitë e distribucionit, transportit, planifikimi urban*), që nuk shikojnë marrëdhënie partneriteti me institucionet shtetërore si ASIG, ASHK-Agencia Shtetërore e Kadastrës (bashkim i ZRPP & ALUIZNI), INSTAT, etj. me qëllim për të bërë partneritete apo për të ndarë përfitimet dhe kostot për IG. Shembull ilustrues pozitiv psh. këtu është marrëdhënia noteri-ZRPP për aksesin online të informacionit mbi pronën, që përmirëson shërbimin dhe ul kostot.

Deklarata e Politikës nr.5“Partneritet &Përfitim reciprok me sipërmarrjet private”:

“Bashkëpunim dhe partneritet i ngushtë me të gjitha sipërmarrjet private kundrejt maksimizimit të përfitimit dhe uljes së kostove, duke filluar që nga SME-të me ofrimin e shërbimeve publike dhe deri tek koordinimi dhe ndërveprimi nëpërmjet enteve publike rregullatore të kompanive që ofrojnë shërbime publike, duke realizuar kontroll/mbikqyrje të vazhdueshme për të siguruar kryerjen e plotë të aktivitetit të tyre konform standardeve dhe ecjes në të njëjtën linjë.”



Përdorimi i informacionit gjeohapësinor ka një ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin ekonomik të sipërmarrjeve të biznesit, megjithatë ende ka sfida të cilat lidhen me orientimin dhe nxitjet e këtyre subjekteve për t'i bazuar vendimmarrjet e tyre në këtë informacion për të marrë një vlerë të shtuar. Kjo politikë synon të rrisë kontrollin kundrejt të gjitha sipërmarrjeve private që operojnë në sektorin e IG, duke realizuar futjen në linjë të tyre. Angazhimi më i madh i institucioneve përkatëse në mbikqyrjen e sipërmarrjeve të IG, do nxisë kryerjen e shërbimeve dhe ofrimin e produkteve konform standardeve. Gjithashtu rritja e kontroleve dhe marrja e masave shtrënguese/ndëshkuese kundrejt të gjitha sipërmarrjeve që nuk respektojnë standardet, do rrisë ndërgjegjësimin dhe kujdesin e këtyre të fundit për të prodhuar dhe për të 'folur' të gjitha së bashku në të njëjtën gjuhë.

Një fokus i veçantë i politikës do jetë kundrejt start-ups dhe SME-ve, duke ofruar shërbime dhe produkte IG të gatshme dhe pa pagesë, me qëllim që këto të fundit të kuptojnë vlerën e lartë të përdorimit të këtij informacioni dhe mbi bazën e tij të përmirësojnë vendimmarrjen e tyre, duke kuptuar tregun në të gjitha dimensionet e tij, me analiza të plota dhe reale, me synim kalimin nga vendimmarrja e dobët dhe mungesa e orientimit në treg, drejt kapjes së potencialeve të reja, zhvillimit dhe përfitueshmërisë.

Në kuadër të kompanive të mëdha që ofrojnë shërbime publike, synohet koordinimi dhe ndërveprimi nëpërmjet enteve publike rregullatore të tyre. Nëpërmjet kontrollit më të madh nga ana e enteve përgjegjëse si dhe nëpërmjet zgjerimit të bashkëpunimit me ASIG apo institucionet e tjera që ofrojnë shërbime IG/GIS, synohet vënia në dispozicion e informacionit për rrjetet e infrastrukturës dhe shërbimit si dhe shpërndarja e tij kundrejt të gjitha palëve të ndikuara.

Si synim final i politikës është rritja e partneritetit me biznesin për të maksimizuar përfitimet dhe ulur kostot në funksion të një informacioni të plotë, standard dhe të integruar. Biznesi tashmë, duke qenë i informuar për mënyrën e përdorimit dhe vlerës së shtuar të IG në nivelet e ndryshme manaxheriale, e kupton domosdoshmërinë për të pasur bashkëpunim të ngushtë dhe të vazhdueshëm me institucione të tilla si ASIG, ASHK-Agjencia Shtetërore e Kadastrës

(bashkim i ZRPP & ALUIZNI), INSTAT, etj. ASIG ka pasur disa raste të frytshme bashkëpunimi me sipërmarrjet private dhe synimi i politikës është që t'i kthejë partneritete të tilla në një trend me përfitim të ndërsjellë për të gjitha palët e përfshira.

Masat për jetësimin e politikës nr. 5:

5.1 Shtrirja e fushatës sensibilizuese, edhe për biznesin (njëkohësisht me fushatën për institucionet dhe për publikun), pasi duhet të jetë e njëjta fushatë promovimi (dhe jo 3 të tilla të ndara). *Kjo masë rrit ndërgjegjësimin për impaktin e lartë të IG në shtimin e vlerës dhe përfitueshmërisë afatgjatë ekonomike kundrejt sipërmarrjeve private, duke i shtyrë që të mendojnë për përfitimet e mundshme dhe realizimin e bashkëpunimeve efektive. Përfitimi është shumë i lartë, ndërkohë që kostot mund të ulen duke gjetur mundësi të leverdisshme promovimi.*

5.2 Dimensioni i sigurimit të cilësisë dhe kontrollit nga ASIG në sektorin e GIS: Futja në 'kuadrat' e kompanive të prodhimit të IG dhe detyrimin që edhe kur e bëjnë sipas kërkesës së klientit, ta kthejnë sipas standardit shtetëror (që është ai evropian) dhe në përputhje me atë ndërkombëtar. Garantimi i standardit dhe cilësisë së shërbimit dhe produkteve të kompanive të GIS, duke certifikuar, kërkesën dhe produktet shtetërore, teknologjinë, profesionistët e fushës, etj. *Kjo masë ndihmon që të gjitha sipërmarrjet private të kthejnë aktivitetet dhe të komunikojnë në të njëjtën gjuhë, ndërkohë që kryerja e kontroleve dhe marrja e masave shtrënguese/penalizuese mundëson një shkallë më të lartë përgjegjëshmërie dhe performance kundrejt standardeve. Masa bëhet e realizueshme kundrejt përcaktimeve ligjore, duke rritur rolin monitorues/mbikqyrës të ASIG dhe institucioneve të tjera përgjegjëse.*

5.3 Dimensioni social/publik i ASIG: Vlerësimi i nevojave bazë, mbledhja e të dhënave dhe prodhimi i hartave dhe shërbimeve bazë, aplikacione, për start-ups, SME dhe biznese të tjera të kësaj kategorie, me tema të tilla si: shtrirja e biznesit, popullsia, adresat, etj. *Kjo masë do sjellë përfitim shumë të lartë për zhvillimin ekonomik të këtyre bizneseve, duke i orientuar drejt kuptimit të panoramës së gjerë të mjedisit ku ato kryejnë aktivitetin dhe njëkohësisht do rrisë promovimin e gjeoportalit dhe përdorimeve të tij. Kosto konsiderohet e ulët, sidomos nëse sigurohet mbështetja e gjerë shqiptare për të nxitur zhvillimin e kësaj kategorie të biznesit me ndihmën e ASIG.*

5.4 Dimensioni rregullator i ASIG: Marrëveshje me entet rregullatore dhe me



kompanitë e shërbimeve për ngritjen e kapaciteteve nga ASIG dhe vënien në dispozicion të hartave bazë, hedhjen, publikimin dhe ndarjen e të dhënave, shtrëngimin/detyrimin nga entet nëse kompanitë nuk i përgjigjen marrëveshjes, si garanti i saj. *Kjo masë mundëson performancë më të mirë të kompanive që ofrojnë shërbime publike, duke nxitur zgjidhjet e ndërvepruara ndërmjet tyre. Realizueshmëria mundësohet ndërmjet një anagazhimi më të lartë të enteve kundrejt kompanive, duke rritur mbikqyrjen dhe detyrimin ndaj tyre, ndërkohë që ASIG mundëson krijimin e hartave bazë.*

5.5 Dimensioni komercial i ASIG: Realizimi i kontratave të bashkëpunimit me përfitim reciprok dhe mundësia që ASIG të shesë informacion dhe analiza, hartat e lundrimit, hartat e trafikut, etj. apo për të hyrë në marrëdhënie partneriteti për prodhim të përbashkët duke ndarë kostot, në fotografime ajrore, mbledhje të dhënash, etj. *Kjo masë sjell rritje të përfitueshmërisë kundrejt bizneseve, të cilat tashmë kuptojnë në mënyrë të plotë pozicionin e tyre në treg, duke parë alternativat drejt zhvillimit, ndërkohë që ASIG kompensohet për vlerën e shtuar në vendimmarrje. Përfitimi është gjithëpërfshirës, ndërkohë që realizueshmëria mundësohet ndërmjet kryerjes së takimeve, workshops të vazhdueshme, promovimit etj. Rritja e shërbimeve të tarifuaru vjen vetëm pasi të jetë realizuar ndërgjegjësimi i mjaftueshëm i subjekteve.*

2.3.3 Politika Nr. 6 “Promovimi & ndërgjegjësimi për përdorimin e IG nga publiku”

Përdorimi i informacionit gjeohapësinor është i rëndësishëm në çdo aspekt të jetës së përditshme për komunitetet e ndryshme, publikun e gjerë dhe çdo individ. Në çdo moment të jetës ne shfrytëzojmë informacionin gjeohapësinor për orientim (si në transport/navigim), për të kuptuar fenomenet dhe marrë vendime, nga ato më të thjeshtat deri në ato më të rëndësishme për jetën tonë. Informacioni gjeohapësinor na ndikon tek parashikimi i motit në një vend të caktuar duke na bërë të marrim vendime të ndryshme lidhur me aktivitetin apo sjelljen tonë, tek investimet në ‘real estate’ për zonat, pozicionin, vlerat e pronave, kriminaliteti në zonë e deri tek vendimmarrja për të filluar një jetë të re në një vend tjetër bazuar në informacionet që marrim për zhvillimin ekonomik, punësimin, kostot e jetesës, etj.

Duke qenë se qeverisja ka përgjegjësinë dhe si qëllim fundor mirëqenien e qytetarëve të saj, atëherë sensibilizimi, mundësimi dhe edukimi për

përdorimin e informacionit gjeohapësinor nga ana e publikut të gjerë është një përgjegjësi e saj, për të garantuar një vendimmarrje më të mirë të qytetarëve bazuar në informacion gjeohapësinor të saktë, të shpejtë dhe të aksesueshëm pa pagesë dhe pa barriera burokratike. Por, situata aktuale sot është që ka një masë të madhe të përdorimit të informacionit gjeohapësinor për transport dhe orientim bazuar në platformat e hapura ndërkombëtare si google earth, map, etj, por përdorimi i informacionit që gjenerohet nga ana e institucioneve apo gjeoportali nga ana e publikut të gjerë mbetet në një shkallë të ulët, kryesisht për shkak të vështirësive që hasen në aksesimin e këtij informacioni.

Çështjet kryesore që duhet të adresojë politika për përdorimin e informacionit gjeohapësinor nga ana e publikut janë:

-Aktualisht, vihet re që, informacioni zyrtar gjeohapësinor ka një përdorim të ulët nga publiku, duke pasur si shkak kryesor padijen për mundësinë dhe vlerën që ka përdorimi i IG, si dhe informacionin se ku mund të gjendet. Kjo kombinohet edhe me mundësitë e kufizuara të institucioneve për të ofruar IG në sasi, cilësi dhe formate të thjeshta mobile, për t’u aksesuar lehtë, shpejt dhe sipas nevojës nga përdoruesi, si dhe me faktin që një sërë informacionesh janë ose jo të mundura për t’u marrë lehtësisht dhe pa pengesa burokratike, por edhe sepse mungon dhe informacioni dhe njohuritë se “ku” dhe “si” mund të merren këto informacione.

-Gjithashtu në përdorimin e ulët nga publiku ndikon edhe fakti që plotësimi i nevojës bazike (basic need), behet nga platformat e hapura si google, bing, open street map, etj, të cilët pavarësisht se nuk kanë të dhëna zyrtare, janë platforma që përditësohen kryesisht nga përdoruesit (*crowdsourcing*) dhe informacioni dhe opsionet që ofrohen janë të mjaftueshme dhe komode për të plotësuar nevojën bazike për orientim. Por, nga ana tjetër, këto platforma nuk kanë informacion zyrtar të saktë dhe të qëndrueshëm dhe nuk ofrojnë analiza dhe trende të realitetit në kohë.

-Në këtë çështje një faktor pengues është edhe ndërveprimi dhe bashkëpunimi midis platformave të hapura globale dhe institucioneve që prodhojnë IG zyrtar. Institucionet nuk e konsiderojnë bashkëpunimin me këto platforma, pasi në rastin



më të mirë shohin si diçka jashtë tyre dhe pa interes apo nevojë për bashkëpunim, apo në rastin më të keq si konkurent që po iu merr tregun dhe po i nxjerr si të panevojshëm përkundrejt një sërë shërbimesh shtetërore, ndërkohë që mund të jenë fare mirë një ofrues shërbimi fundor për institucionet, me akses dhe mundësi teknologjike që nuk mund t'i përballojnë institucionet, kjo edhe në vende të zhvilluara dhe shumë më të mëdha se Shqipëria. *(Shembull tipik, Ministria e Mbrojtjes nuk lejonte që ASIG, për fotografimin ajrorë, të jepte imazh mbi objekte të rëndësishme të veçantë ushtarake duke kërkuar që të kishte zhurmues në këto zona, ndërkohë që google i jep të qarta dhe të përditësuara çdo 6 muaj për të gjithë botën! Apo shembulli mbi ortofotot ajrore të IGJIU që konsiderohen ende sekret shtetëror.)*

-Çështje tjetër që duhet adresuar është fakti që informacioni është konceptuar gjithmonë me rrjedhje dhe përdorim në një kah, nga shteti tek publiku në funksion të informimit dhe mirëqenies së tyre, ndërkohë në mënyrë të vazhdueshme shfaqet nevoja dhe domosdoshmëria që komunikimi duhet të jetë në të dy kahet, duke përfshirë edhe informacionin që rrjedh nga publiku tek qeverisja në funksion të kuptimit të problematikave dhe mirëqeverisjes. Platforma për bashkëqeverisjen është një model suksesi dhe shumë i mirë që ilustron komunikimin në dy kahje, por aktualisht nuk kemi një përthyerje të saktë në territor të ankesave, tipologjisë, trendit të tyre sipas zonave, vendndodhjes, etj., që do i jepte një dimension të ri dhe materializim në territor të situatës dhe problematikës së pasqyruar nga vetë qytetarët.

Deklarata e Politikës nr.6 “Promovimi & ndërgjegjësimi i përdorimit të IG nga publiku i gjerë”:

“Njohja, ndërgjegjësimi dhe ofrimi i mundësive për IG të plotë, të saktë, të thjeshtë dhe të hapur për t’u aksesuar nga publiku i gjerë, duke kombinuar përvojën dhe bazën e të dhënave të institucioneve me teknologjinë dhe shërbimet që ofrohen nga platformat globale, duke hapur një komunikim dhe dialog të dyanshëm ‘publik - qeverisje’, për të përçuar realitetin e publikut tek qeverisja dhe realitetin institucional tek publiku.”

Politika për promovimin dhe ndërgjegjësimin e përdorimit të informacionit gjeohapësinor nga komuniteti dhe publiku, orienton drejtimet për një

jetë më cilësore të qytetarëve në funksion të së ardhmes së tyre. Nëpërmjet kësaj politike që qeverisja kërkon të ndjekë për përdorimin e IG nga publiku i gjerë, synohet njohja e publikut me mundësitë që i ofrohen për aksesimin lehtë, shpejt dhe sipas nevojës e IG, njëkohësisht edhe duke i ndërgjegjësuar mbi potencialet e përdorimit dhe vlerën e IG. Në këtë kuadër institucionet do të mundësojnë ofrimin e IG edhe në format mobile, etj., për të shmangur pengesat dhe lehtësuar aksesimin.

Politika e qeverisjes për përdorimin e IG nga publiku i gjerë, synon të mundësojë thjeshtë dhe në kohë reale, aksesimin e informacionit gjeohapësinor nëpërmjet instrumenteve dhe mekanizmave të ndryshëm, nga ato në nivel kombëtar dhe deri në bashkëveprimin me platformat globale. Synohet përdorimi i platformave që ofrojnë të dhëna të sakta, zyrtare dhe analiza e trendeve të realitetit në kohë, duke rritur edhe ndërveprimin midis platformave të hapura ndërkombëtare dhe institucioneve shqiptare që prodhojnë IG zyrtar.

Gjithashtu synohet ndërveprimi për të kuptuar realitetin e qytetarëve dhe problematikën që vjen nga terreni tek qeverisja dhe reflektimin përkatës edhe në drejtim të përcimit të IG nga qeverisja tek publiku i gjerë.

Masat për jetësimin e politikës nr. 6:

6.1 Përfshirja e publikut në promocionin për IG: Përfshirja e target grupit të publikut të gjerë në strategjinë e promocionit të IG, duke hartuar aktivitete konkrete për informimin, ndërgjegjësimin dhe anagazhimin e publikut në përdorimin e IG, kjo në mënyrë të integruar me dy kategoritë e tjera (të institucioneve publike dhe sipërmarrjes private). *Impakti i masës është pozitiv sepse, duke angazhuar publikun në promocionin për IG, ndërgjegjëson ata vetë si një kategori e rëndësishme e përdoruesve, si dhe përdoruesit e tjerë për të kuptuar rëndësinë dhe vlerën e përdorimit të IG. Rrjedhimisht niveli i përdorimit cilësor ndërlidhur edhe me shtimin e mundësive të aksesimit ofruar nga institucionet, do të rritet për të sjellë vendimmarrjet e duhura.*

6.2 Vlerësimi i informacionit bazë për qytetarin: dhe aplikacione të thjeshta mobile që mundësojnë akses të informacionit të nevojshëm apo me interes për publikun (nga rezultatet zgjedhore tek harta e krimit apo aksidenteve rrugore, etj.). *Impakti i masës është pozitiv për publikun sepse do t’i mundësojë atyre*



pasjen e një aplikacioni të saktë dhe zyrtar që do të plotësojë nevojat bazike lidhur me përdorimin e IG në përditshmëri.

6.3 Ndërveprimi dhe shfrytëzimi i platformave globale të hapura: për të shfrytëzuar teknologjinë dhe opsionet që ato ofrojnë, duke furnizuar me të dhëna zyrtare të nevojshme për përdorim nga publiku i gjerë dhe që nuk çenojnë sigurinë kombëtare. Gjithashtu nga ky bashkëpunim, mund të ofrojë dhe ASIG shërbime të google në portalin e vet. *Kjo masë ka impakt pozitiv sepse ndër të tjera rrit bashkëpunimin mes platformave të hapura globale dhe institucioneve që prodhojnë IG.*

6.4 Përdorimi për bashkëqeverisjen:

Përgatitja e një moduli lidhës me platformën e bashkëqeverisjes për të nxjerrë hartat e çështjeve të ngritura nga qytetarët, sipas kategorive, vendndodhjes dhe shpërndarjes në territor. *Nëpërmjet kësaj mase bëhet e mundur që të rritet 'bashkëpunimi' publik-qeverisje në kuadër të përdorimit të IG, duke u nisur nga nevojat e identifikuara nga informacioni që kalon nga publiku tek qeverisja, në funksion të mirëqeverisjes.*

2.4 POLITIKAT E SISTEMIT FUNKSIONAL TË INFORMACIONIT GJEOPHAPËSINOR

Për realizimin e shërbimeve cilësore të Informacionit Gjeohapësinor si dhe të gjithë proceseve të punës që lidhen me ofrimin e këtyre shërbimeve, nevojitet ngritja e një sistemi shtetëror të informacionit gjeohapësinor, të integruar, efektiv dhe eficient. Kjo do të garantonte përmbushjen e Synimit Strategjik III **“Funksionaliteti i Sistemit të Informacionit Gjeohapësinor Shtetëror”**. Drejtimet e politikave që lidhen me këtë synim strategjik III, janë në përputhje edhe me kornizën strategjike gjithëpërfshirëse (IGIF) të UN-GGIM, konkretisht me: Drejtimin Strategjik 1 “Qeverisje dhe Institucione”, Drejtimin Strategjik 5 “Inovacion”, Drejtimin Strategjik 6 “Standardet” dhe Drejtimin Strategjik 8 “Kapacitete dhe edukim”, pasi i referohen zhvillimit të strukturave institucionale funksionale, stimulojnë mundësitë për inovacion dhe përdorimin e teknologjive më të fundit me kosto efektive, rrisin ndërgjegjësimin dhe nivelin e kuptueshmërisë ndaj informacionit gjeohapësinor.

Në kontekstin e sektorit të Informacionit Gjeohapësinor, sistemi nënkupton jo vetëm institucionet shtetërore dhe mënyrat e organizimit të tyre, por së pari funksionet dhe aktivitetin që ato realizojnë sipas detyrave dhe përcaktimeve ligjore, në përputhje me standardet e përcaktuara, për të prodhuar rezultatet e kërkuara. Komponentë thelbësore të këtij sistemi janë gjithashtu burimet njerëzore që përmes ekspertizës, kapacitetit të tyre teknik dhe profesional realizojnë proceset e punës, si dhe infrastruktura dhe teknologjia e nevojshme për të bërë të mundur funksionalitetet e sistemit.

Sa më sipër, drejtimet kryesore ku do të orientohen politikat për funksionalitetin e sistemit të informacionit gjeohapësinor, janë:

Politikat e qeverisjes për organizimin institucional të sektorit, që përfshin funksionet e nevojshme dhe arkitekturën e duhur për realizimin e aktivitetit për gjenerimin e informacionit gjeohapësinor, si dhe organizimin strukturor të institucioneve publike (si autoritete publike përgjegjëse për tematikat e informacionit gjeohapësinor), rolin dhe funksionet e tyre, marrëdhëniet dhe ndërveprimin institucional, organizimi i brendshëm, rrjedhën e punës, detyrat dhe përgjegjësitë për çdo strukturë.

Politikat e qeverisjes për dijen institucionale dhe kapacitetet njerëzore, që përfshin standardet për çdo temë të informacionit gjeohapësinor, metodologjitë dhe procedurat standard të punës, stafet profesionale dhe të specializuara, së bashku me ekspertizën (know-how) dhe përvojën që zotërojnë, si dhe sistemin e shpërbërimit, motivimit dhe angazhimit të burimeve.

Politikat e qeverisjes për infrastrukturën dhe teknologjinë e sektorit të IG, që përfshin të gjithë teknologjinë (hardware dhe software) në dispozicion të aktorëve; rrjetet dinamike të komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave në përputhje me rregullat dhe protokollet e përcaktuara; pajisjet dhe mjetet që garantojnë ndërlidhjen/ndërveprueshmërinë mes aktorëve të ndryshëm.



2.4.1 Politika Nr. 7 “Organizim institucional funksional”

Organizimi i kuadrit institucional në mënyrë funksionale dhe të integruar, është një nga kërkesat kryesore për krijimin e një sistemi të Informacionit Gjeohapësinor, në përputhje me realizimin e synimit afatgjatë për **“Funksionalitet të Sistemit të Informacionit Gjeohapësinor Shtetëror”**. Përmbushja e plotë e funksioneve nga secili autoritet publik që ka përgjegjësi në lidhje me IG dhe ndërveprimi mes tyre në logjikën e një sistemi të integruar dhe të harmonizuar, do të mundësojë realizimin e aktivitetit në përputhje me parametrat e dëshiruara dhe nevojat e përdoruesve. Sektori i IG, për shkak të karakterit horizontal, përfshin një numër të madh institucioneve që kanë rol dhe kryjnë funksione të ndryshme në raport me zhvillimin e sektorit. Nga analiza institucionale rezultojnë në total mbi 50 institucione që ndërveprojnë me IG. Nga këto, 24 institucione janë aktorë kryesorë dhe kanë rol themelor për sa i përket prodhimit dhe përdorimit të IG sipas 35 temave të përcaktuara në ligj dhe në zbatim të Direktivës INSPIRE. Rëndësia e IG për institucionet publike konfirmohet edhe nga anketimi i fundit i kryer nga ASIG në lidhje me përdorimin e Gjeoportalit Kombëtar⁴, ku në bazë të deklarimeve të përdoruesve të regjistruar (132 nga 700 të tillë)rezulton se, institucionet publike përbëjnë kategorinë kryesore të përdoruesve, në shifrat rreth 58%, ndërkohë që subjektet private përbëjnë rreth 42%. Megjithatë, pavarësisht këtyre

shifrave, sikurse kemi analizuar në seksionet e mësipërme të këtij dokumenti, IG nuk zë peshën e duhur në aktivitetin e institucioneve publike (qofshin ato nërolin e gjeneruesve të IG ose të përdoruesve të tij) dhe një nga arsyet për këtë lidhet edhe me mënyrën si këto institucione janë organizuar dhe funksionojnë.

Nga analiza e kryer, arkitektura e shpërndarjes së funksioneve ndërmjet institucioneve kryesore të sektorit, karakterizohet kryesisht nga shpërndarja joefektive dhe e copëzuar e funksioneve, ku mungon lidhja në logjikë rrjeti dhe ajo hierarkike mes institucioneve dhe ASIG. Ndërkohë që vërehet tendenca për ngritjen e “ishujve” të izoluar, të formave nga më të ndryshmet dhe në të gjithë nivelet, që kanë si veçori kryesore mungesën e theksuar të burimeve njerëzore të kualifikuara. Kjo tendencë ka shkaktuar mbivendosje të funksioneve në institucione të ndryshme nga njëra anë dhe boshllëk funksional për elementë të caktuar, si p.sh. kontrollin e cilësisë (QA/QC) të informacionit gjeohapësinor, të cilin asnjë institucion nuk e konsideron si një funksion apo përgjegjësi të tij.

Tipari i dytë që vërehet nga analiza institucionale e sektorit, është mungesa e ndërveprimit mes institucioneve dhe funksioneve të ndryshme që ato realizojnë në raport me njëri-tjetrin dhe me ASIG, ku tendencë kryesore edhe në aspektin e kulturës organizative është parcelizimi, duke i lënë pak ose aspak vend mentalitetit të bashkëndarjes, edhe pse ekzistojnë shembuj pozitivë si Gjeoportali, i cili duhet amplifikuar/evidentuar si një përvojë e suksesshme (best practice) që tregon se, duke ndarë diçka me të tjerët mund të arrihen përfitime të shtuara. Duke qenë se sektori IG është një sektor horizontal, që ndërpritet me të gjithë sektorët e tjerë të organizuar sipas fushave të përgjegjësisë, rezulton se sektori i IG formësohet pikërisht nga organet/strukturat që kanë përgjegjësi për IG brenda autoriteteve përgjegjëse të ndryshme, të cilat ndërveprojnë dhe komunikojnë me njëri-tjetrin si një tërësi nën koordinimin e ASIG. Aktualisht, një pjesë e institucioneve nuk e shikojnë njëri-tjetrin si partnerë dhe pjesë të të njëjtit sistem, por si konkurrentë apo dublues funksionesh, çka i shtyn në të kundërt të bashkëpunimit, madje shpesh autoritetet përgjegjëse refuzojnë të shkëmbejnë informacion të përditësuar me njëri-tjetrin.

Nga pikëpamja e organizimit të brendshëm të autoriteteve përgjegjëse, vihet re nënvlerësimi i

⁴Shiko edhe të dhënat statistikore të publikuara në Raportin “Veprimtaria e ASIG 2014-2018”:

http://www.asig.gov.al/images/DokumentaPDF/Veprimtaria_e_ASIG_2014_2018.pdf



funksioneve të IG që reflektohet në faktin se një pjesë e institucioneve nuk kanë struktura (drejtori/sektorë/njësi) të dedikuara për IG dhe i kryejnë proceset e grumbullimit, përpunimit dhe përditësimit të informacionit vetëm me një specialist të pozicionuar në një strukturë që ka tërësisht tjetër fokus, ndërkohë që në disa raste ky specialist duhet të kryejë edhe detyra të tjera. Kjo arsyetohet me volumin e pakët të përdorimit të IG, që nuk justifikon caktimin e individëve apo ngritjen e strukturave të dedikuara.

Sa më sipër, çështjet kryesore që duhet të adresohen, janë:

-Arkitekturë e paequilibruar dhe jo e integruar e shpërndarjes së funksioneve në institucionet e sektorit IG, duke mospërcaktuar qartë funksionet, rolet dhe përgjegjësitë e tyre;

-Bashkëpunim i ulët dhe komunikim jo eficient mes institucioneve si dhe mungesa e një rrjeti institucional për sistemin kombëtar të GIS, që do të garantonte ndërveprimin e duhur mes institucioneve;

-Organizim i brendshëm joefektiv dhe mungesa e strukturave të dedikuara për IG që do të reflektonin rolin, funksionet dhe peshën që ato kanë për institucionin dhe qeverisjen.

Deklarata e Politikës nr.7 “Organizim institucional funksional”:

“Një sistem i integruar dhe funksional që ndërlidh të gjitha funksionet e GIS nëpër institucione publike, në një sektor horizontal, pa mbivendosje apo mangësi të funksioneve, të organizuar në një strukturë të balancuar sipas peshës së secilit institucion në IG, e reflektuar kjo edhe në organizimin e brendshëm institucional.”

Nëpërmjet zbatimit të kësaj politike synohet shpërndarja dhe mbulimi i funksioneve në sektorin IG në mënyrë optimale, profilizimi, integrimi dhe organizimi funksional i institucioneve pjesë e sistemit të IG, duke garantuar ekuilibrin e tij (as i centralizuar dhe as i copëzuar), ku çdo institucion ka funksione të diferencueshme dhe përplotësuese në raport me të tjerët dhe është i koordinuar me fushat/drejtimet e ndryshme të IG, të integruara në një njësi qëndrore përgjegjëse për funksionimin e sistemit të IG.

Kjo politikë i shërben gjithashtu ndërlidhjes/ndërthurjes së institucioneve dhe funksioneve GIS mes tyre, në një strukturë të integruar dhe

hierarkike të organizuar sipas logjikës funksionale (përkundër asaj administrative), që mundëson qartësi dhe saktësi në organizimin e përgjegjësive si dhe rrjedhshmëri e koordinim në realizimin e proceseve të punës në tërësi, veçanërisht atyre që lidhen me vendimmarrjen, komunikimin, shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit, monitorimin dhe raportimin. Kjo politikë është në përputhje me Drejtimin Strategjik 1 “Qeverisje dhe Institucione” të kornizës strategjike gjithëpërfshirëse (IGIF) të UN-GGIM.

Në mënyrë që të garantohet realizimi i funksioneve institucionale në sektorin e IG, politika parashikon gjithashtu ndërhyrjen në mënyrën si këto institucione janë organizuar së brendshmi, për të garantuar ngritjen dhe vënien në funksionim të strukturave përgjegjëse për IG, që përbëjnë premisë thelbësore (*sine qua non*) që këto funksione të realizohen, shoqëruar me përgjegjësitë e detajuara dhe proceset e punës që këto struktura duhet të realizojnë në përmbushje të këtyre funksioneve.

Masat për jetësimin e politikës nr. 7:

7.1 Rishikimi i arkitekturës institucionale të sektorit IG & Riprojektimi i profilit dhe funksioneve të ASIG. Për të garantuar fuqizimin dhe profilizimin e autoriteteve publike në lidhje me IG, orientimin e tyre drejt qëllimit dhe synimeve të sektorit, integrimin, ndërveprueshmërinë dhe eficiencën e duhur, nevojitet të riprojektohet arkitektura institucionale e të gjithë sektorit përmes rishikimit të rolit dhe përgjegjësive të autoriteteve publike në lidhje me temat e IG si dhe riorganizimit të funksioneve dhe nivelit të pjesëmarrjes në zhvillimin e sektorit. Kjo kërkon që autoritetet publike t’i japin më shumë peshë IG, duke mos e trajtuar thjesht për përdorim të brendshëm në kuadër të realizimit të përgjegjësive të tyre, por të fokusohen në ndërveprueshmërinë e tij me temat e tjera dhe vlerën e shtuar që paraqet për një numër më të gjerë përdoruesish. Kjo masë shoqërohet me riprojektimin e profilit dhe funksioneve të ASIG, në përputhje me rolin e tij si institucion qëndror dhe bosht i sektorit të IG, që harton dhe monitoron politikat në lidhje me IG, mundëson/gjeneron IG bazik (6 temat për të cilat ASIG është autoritet përgjegjës, si KRGJSH, harta bazë në tokë/nëntokë/det/hapësirë, emërtimet gjeografike, DTM, ortoimazheria, etj.) në shërbim të autoriteteve publike që mbulojnë temat e IG dhe përdoruesve të tjerë, që orienton, vendos



standarde, koordinon/integron dhe monitoron veprimtarinë e aktorëve si dhe garanton qasjen e thjeshtë ndaj IG dhe përdorimin e tij në funksion të mirëqeverisjes dhe zhvillimit të vendit.

Realizimi i kësaj mase ndihmon jetësimin e politikës përmes organizimit efektiv dhe eficient të sektorit, profilizimit dhe diferencimit të autoriteteve publike përgjegjëse për IG dhe ndërveprimin funksional të tyre, në mënyrë që çdo autoritet të ketë kontributin e tij specifik që integrohet me atë të të tjerëve për realizimin e synimeve dhe qëllimeve të sektorit. Kjo masë mundëson ripozicionimin dhe fuqizimin e ASIG-ut në sektor, duke u shndërruar në institucionin kyç të sektorit që garanton realizimin e produkteve dhe nyjen që ndërlidh aktorët e ndryshëm (prodhues, përdorues, institucione edukimi, etj.). Për të mundësuar realizimin e kësaj mase, është i nevojshëm edhe rishikimi i kuadrit përkatës ligjor (ligji 72/2012, etj. dhe aktet nënligjore) me qëllim përkthimin në akte të zbatueshme ligjore të arkitekturës së re të sektorit dhe riorganizimit të funksioneve, shoqëruar me masa shtrënguese dhe përgjegjësi institucionale në rast të mospërbushje së tyre. Është thelbësore që të garantohet realizimi i politikës përmes sanksionimit ligjor të ndryshimeve në lidhje me organizimin e sektorit, rolin dhe shpërndarjen e funksioneve të autoriteteve publike përgjegjëse, duke krijuar qartësi, siguri ligjore dhe përballur autoritetet përgjegjëse me pasojat përkatëse në rast të mospërbushjes së detyrimeve ligjore prej tyre.

7.2 Riorganizimi i brendshëm i ASIG sipas rolit në sektorin IG: Me qëllim që struktura institucionale të përshtatet për të kryer funksionet e reja dhe alokimine buxhetit të nevojshëm për të mundësuar realizimin e misionit dhe objektivave institucionale, është i nevojshëm riorganizimi i brendshëm i ASIG, i shoqëruar edhe me forcimin e rolit të tij koordinues dhe monitorues në sektorin IG, duke vlerësuar edhe rolin potencial si prodhues i informacionit gjeohapësinor (në profilin e një autoriteti hartografik si në praktikën ndërkombëtare). Kjo konkretizohet përmes projektimit dhe zbatimit të mekanizmave dhe proceseve standarde dhe të unifikuara të komunikimit, raportimit dhe monitorimit të veprimtarisë së autoriteteve publike përgjegjëse në lidhje me IG dhe përbushjes së detyrimeve të tyre në raport me afatet dhe cilësinë e produktit të realizuar. *Kjo masë i shërben jetësimin të politikës përmes garantimit që të gjitha funksionet e reja të ASIG, janë të projektuara/reflektuara në organizimin e brendshëm dhe ekzistojnë strukturat përkatëse përgjegjëse për realizimin e tyre. Vendosija e detyrimeve dhe standardeve të unifikuara në*

lidhje me komunikimin, raportimin dhe monitorimin, për të gjithë autoritetet publike, do të mundësojë skanimin e vazhdueshëm dhe tërësor të sektorit për të parë nëse të gjithë komponentët e tij po lëvizin në të njëjtin drejtim, me të njëjtën shpejtësi, dhe nëse autoritetet publike përgjegjëse për IG po përplotësojnë apo mbështesin njëri-tjetrin në përputhje me organizimin funksional të sektorit.

7.3 Riorganizimi apo ngritja e strukturave të dedikuara për IG në autoritetet publike përgjegjëse për temat e IG, duke krijuar lidhje funksionale me ASIG bazuar në natyrën e veçantë të funksionit që realizohet dhe përgjegjësinë e përbashkët që këto autoritete ndajnë në përbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor mbi IG (kjo lidhje funksionale nuk prek varësinë administrative që vijon të mbetet e njëjtë). Kjo kërkon rishikimin e organizimeve të brendshme të autoriteteve publike përgjegjëse për IG dhe orientimin e tyre për të garantuar ekzistencën dhe funksionimin e strukturave përgjegjëse për IG, pozicionimin e duhur të tyre në organogramën e institucionit dhe ndërveprimin eficient brenda dhe jashtë institucionit, për përbushjen e funksioneve dhe detyrimeve në kuadër të sektorit IG. *Zbatimi i kësaj mase do të mundësojë integrimin e sektorit dhe rrjetëzimin funksional të strukturave përgjegjëse për IG, duke garantuar ndërveprim eficient, koordinim, monitorim dhe përgjegjshmëri më të lartë. Kjo masë synon të garantojë që autoritetet përgjegjëse për IG zotërojnë struktura të dedikuara dhe të specializuara, që do të mundësojnë realizimin e funksioneve në kuadër të arkitekturës së re institucionale, duke shërbyer njëkohësisht si pika qendrore për koordinimin dhe bashkëpunimin mes institucioneve, si dhe duke mundësuar kuptueshmëri të ndërsjellë dhe komunikim eficient.*

7.4. Plan angazhimi për aktorët institucionalë të sektorit, duke shpjeguar rolin dhe peshën e tyre në sektorin IG, përfshirë shtjellimin e funksioneve dhe integrimin mes tyre në shërbim të arritjes së objektivave të sektorit. Plani i angazhimit do të konkretizojë mekanizmat dhe mënyrat për përfshirjen, ndërveprimin dhe koordinimin e aktorëve si dhe mënyrën e komunikimit mes tyre, duke mundësuar qasje proaktive, orientimin dhe sinergjinë e nevojshme mes institucioneve. Krijimi i këtyre mekanizmave dhe instrumenteve garantojnë qasjen dhe kulturën institucionale të bashkëndarjes së sfidave dhe përfitimeve, ndërveprimin eficient, angazhimin dhe bashkëpunimin mes autoriteteve, shkëmbimin dhe



rrjedhjen e informacionit në kohë reale si dhe komunikimin efektiv që i përgjigjet adresimit të nevojave dhe problematikave të sektorit. *Qëllimi i kësaj mase është ndërgjegjësimi i institucioneve mbi peshën e tyre specifike në lidhje me IG, përcaktimi i formës përmes të cilës kontributi i tyre integrohet me atë të institucioneve të tjerë, konsiderimi dhe përfshirja e të gjithë institucioneve në proceset që lidhen me zhvillimin e sektorit, si dhe komunikimi e sqarimi në lidhje me funksionet dhe përgjegjësitë që duhet të përmbushin. Nëpërmjet kësaj mase synohet që të lehtësohet integrimi dhe ndërveprimi funksional mes autoriteteve publike, duke nxitur dhe formësuar kulturën e bashkëpunimit dhe bashkëndarjes, ndërgjegjësimin mbi rolin e IG dhe kuptimin që, përmes frymës së dubur institucionale, secili institucion mund të përmbushë më mirë misionin e tij dhe të kontribuojë në përmirësimin e aspekteve të tjera (përtej institucionale) të lidhur me zhvillimin e vendit.*

2.4.2 Politika nr. 8 “Dija Institucionale dhe Kapacitete Njerëzore në Sektorin e IG”

Kjo politikë i referohet Dijes institucionale dhe kapaciteteve njerëzore të sektorit të IG, duke përfshirë stafet profesionale dhe të specializuara, së bashku me ekspertizën (know-how) dhe përvojën që ata zotërojnë, standardet për çdo temë, metodologjitë dhe procedurat e punës, si dhe sistemin e shpërbërimit, motivimit, si dhe angazhimit të burimeve me aktivitetin dhe organizatën. Dija institucionale dhe kapacitetet njerëzore të sektorit janë një element i rëndësishëm i sistemit të IG, pa të cilat nuk mund të kemi një sistem IG funksional dhe të aftë për të realizuar misionin, vizionin dhe qëllimin e qeverisjes, pasi përfaqëson sintezën e eksperiencës së mëparshme, praktikave më të mira botërore dhe kërkesat që burojnë nga direktiva INSPIRE, e përkthyer në standarde, metodologji, specifikime, si dhe kapacitete njerëzore të afta për ta mbartur dhe aplikuar këtë dije institucionale. Kjo politikë është në përputhje me Drejtimin Strategjik 6 “Standardet” dhe Drejtimin Strategjik 8 “Kapacitete dhe edukim” të kornizës strategjike gjithëpërfshirëse (IGIF) të UN-GGIM.

Aktualisht nga 34 standarde tematike të INSPIRE, rezultojnë 24 të hartuara dhe 10 të miratuara (ku së fundmi janë miratuar nga Këshilli i Ministrave në datë 20.03.2019 standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri mbi temën “Gjeologjia” dhe temën “Rrjetete transportit”, ndërsa në datë 19.06.2019 janë miratuar për temën “Modeli digjital

i terrenit” dhe temën “Ortoimazheria”. Gjithashtu në datë 03.07.2019 janë miratuar “Rregullat Uniforme të Infrastrukturës së Informacionit Gjeohapësinor”). Ndërkohë që, problematika këtu nuk ka të bëjë me përcaktimin dhe vendosjen e standardeve por me aplikueshmërinë e tyre, pasi një pjesë e institucioneve (autoriteteve publike përgjegjëse) nuk i respektojnë ato. ASIG ka hartuar dhe merr pjesë në hartimin e specifikimeve për teknologjinë apo sistemet GIS, por kjo më shumë nga ana profesionale. Gjithashtu, standardet përkthehen siç i kanë institucionet e tjera, pa vlerësuar aplikueshmërinë e tyre në mjedisin shqiptar apo eksperiencat më të mira shqiptare. Kjo vlen sidomos për procesin e zbatimit të standardeve, pasi nuk mund të zbatohet e njëjta metodologji pune.

Lidhur me kapacitetet njerëzore, evidentohen problematika si me numrin e burimeve njerëzore ashtu edhe me njohuritë dhe aftësitë e tyre në GIS. Kështu, burimet njerëzore janë kryesisht në nivel specialisti dhe nuk janë burime të dedikuara për GIS, por njëkohësisht kryejnë edhe detyra tjera. Disa institucione nuk kanë fare specialistë GIS dhe detyrat funksionale për këtë pjesë mbulohen nga specialistët e tjerë të institucionit. Vetëm një pjesë e vogël e institucioneve kanë ekip të dedikuar për GIS. Sa më sipër, qenia e vetëm një punonjësi për këtë qëllim, krijon izolim, pasi specialisti përkatës nuk ka me kë të konsultohet dhe të ndajë mendimet për çështjet e punës së tij, duke i shkaktuar vështirësi në punë dhe mungesë oportunitetesh për zhvillim profesional dhe në karrierë.

Procesi i trajnimit të stafit kryhet në fillim të nisjes së punës së tyre si specialistë (trajnime prezantuese) dhe më pas nuk implementohet asnjë plan për përditësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe aftësive. Bazuar në këtë problematikë, tashmë ASIG ka iniciuar një cikël workshops për ngritjen e kapaciteteve të stafit GIS, duke synuar forcimin e zotësive në fushën e IG për përmbushjen e detyrimeve institucionale përkatës.

Edhe sipas anketimit të fundit nga ASIG në lidhje me përdorimin e Gjeoportalit Kombëtar, rezulton se një pjesë e përdoruesve të regjistruar (nga 700 të tillë në total) kanë paraqitur si nevojë të situatës ekzistuese ngritjen e kapaciteteve dhe kanë propozuar zhvillimin e trajnimeve të ndryshme (për të gjithë stafet e institucioneve të angazhuara në



prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit gjeohapësinor, përfshirë institucionet private, ku fokus të veçantë duhet të ketë stafi përgjegjës për garantimin e funksionalitet të portalit GIS), si dhe përdorimin e metodave të kohës në lidhje përvetësimin e njohurive respektive (psh. përmes tutorialeve që mund të publikohen edhe tek faja e gjeoportalit apo shërbimit telefonik, apo me target fitimin e dijeve praktike nga studentët përmes tutorialeve trajnuese që mund të përgatiten dhe publikohen në dritaren virtuale/gjeoportali, dhe vënia në zbatim e konceptit “vizituesi” përmes “chat online”).

Problematika e mësipërme vjen si pasojë e disa shkaqeve, që janë:

- mungesa e kapaciteteve njerëzore të kualifikuara me njohuritë bashkëkohore teknologjike, duke e bërë kështu të pamundur procesin e përpunimit të të dhënave sipas përditësimeve të fundit;

- vlen të identifikohet si faktor impakti i kurrikulave të pa përditësuara me kërkesat e reja të tregut të punës, mbingarkesa me informacion por e pashoqëruar me dije praktike, cilësia e mësimdhënies me metoda të vjetra dhe mungesa e praktikave të punës për të integruar të rinjtë me tregun e punës;

- pamundësinë për të siguruar burime të mjaftueshme në numër për të përballuar volumnin e punës, pasi numri i studentëve të specializuar në fushën e IG është i ulët;

- përveç faktit se trajnimet GIS janë kryer shumë vite më parë (përgjithësisht në momentin e implementimit fillestar të teknologjisë nga ofruesi i saj), aktualisht nuk ekziston asnjë program konkret gjithëpërfshirës për kryerjen e trajnimeve (qoftë edhe në të ardhmen), duke e lënë situatën në të njëjtën gjendje, dhe kjo përbën një problematikë të vërejtur pothuajse në të gjitha institucionet përgjegjëse për temat e ndryshme të IG;

- lidhur me motivimin dhe shpërblimin e këtyre specialistëve ka përsëri një balancë negative, ku punonjësit e ASIG krahasuar me punonjësit e institucioneve të tjera, që janë në varësi të KM, kanë një nivel page më të ulët. Ndërkohë që, rruga e karrierës nuk ekziston duke iu referuar horizontalitetit të sektorit të IG.

Sa më sipër, çështjet kryesore që duhet të adresohen nëpërmjet kësaj politike, në mënyrë të përmbledhur janë si vijon:

- Përfundimi i procesit të hartimit të standardeve dhe zbatimi i tyre, si dhe hartimi i metodologjive model dhe përcjellja e tyre tek institucionet zbatuese, duke mundësuar në këtë mënyrë kalimin nga dije individuale në dije institucionale.

- Rritja e numrit dhe peshës së specialistëve GIS nëpër institucione, duke mundësuar rritjen e ndërveprimit mes tyre, në funksion të shkëmbimit të eksperiencës profesionale (*i.e. rrjeti i profesionistëve GIS*).

- Ngritja e cilësisë së profesionistëve përgjatë të gjithë ciklit të edukim–zhvillimit, duke nisur nga fakultetet dhe deri tek edukimi dhe trajnimi në vazhdim.

- Implementimi i instrumenteve për rritjen e nivelit të motivimit të stafit GIS (duke ndërhyrë në elementë të tillë, si shpërblimi, ofrimi i mundësive për zhvillim në karrierë në sektorin IG dhe vetërealizim, etj.).

Deklarata e Politikës nr.8 “Dije Institucionale & Kapacitete Njerëzore në Sektorin e IG”:

“Institucione që kanë sintetizuar dijen individuale në dije institucionale, që aplikohet dhe jetësohet nga burime njerëzore optimale në numër dhe cilësi, si dhe që zotërojnë motivimin e duhur për të realizuar funksionet dhe misionin e tyre.”

Përmes kësaj politike synohet të përfundohet procesi i hartimit të standardeve në lidhje me temat IG (një proces që deri tani ka rezultuar përgjithësisht i suksesshëm), por duke i kontekstualizuar me kërkesat dhe veçoritë e sektorit në Shqipëri, me qëllim garantimin e përshtatshmërisë dhe aplikueshmërisë së tyre, si dhe vënia në dispozicion e metodologjive të unifikuara/standardizuara për realizimin e punës, në funksion të fuqizimit dhe konsolidimit të dijeve dhe praktikave institucionale. Organizimi më i mirë i punës përmes metodologjive dhe manualeve, fuqizimi i kapaciteteve institucionale si dhe fuqizimi i rolit koordinues dhe monitorues të ASIG, do t'i shërbejë gjithashtu zbatimit me përpikmëri të standardeve nga autoritetet përgjegjëse, një proces ku deri më sot janë vërejtur dobësi të shumta.

Zbatimi i standardeve si dhe realizimi i aktivitetit në përputhje me metodologjitë e hartuara, kërkon së pari ekzistencën e burimeve njerëzore të mjaftueshme dhe të specializuara, për këtë arsye kjo politikë synon vendosjen e lidhjeve



mes institucioneve të formimit profesional/ akademik dhe aktorëve të sektorit, për të bashkërenduar nevojat e sektorit me produktin e këtyre institucioneve. Përderisa sektori është në evoluim të vijueshëm, politika gjithashtu adreson edhe çështjet e formimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm dhe rritjes cilësore të profesionistëve të fushës.

Për të garantuar eficiencën e burimeve njerëzore si dhe ruajtjen e tyre në afatgjatë, politika vendos gjithashtu bazat për ngritjen e mekanizmave të shpërbërimit, motivimit dhe ngritjes në karrierë të profesionistëve në sektorin IG.

Masat për jetësimin e politikës nr. 8:

8.1 Përfundimi i procesit të hartimit dhe miratimit të standardeve në lidhje me temat e IG duke pasur në fokus aplikueshmërinë apo zbatueshmërinë e tyre konkrete në Shqipëri përmes kombinimit të përvojave ndërkombëtare (veçanërisht kërkesave që burojnë nga INSPIRE) me përvojat e suksesshme të institucioneve shqiptare, shoqëruar me përgatitjen e manualeve/metodologjive të operimit për autoritetet përgjegjëse të IG që mundësojnë standardizimin dhe monitorimin e punës për zbatimin e këtyre standardeve. Unifikimi i proceseve të punës (standardizimi i tyre) mundëson optimizimin, thjeshtëzimin, sqarimin, integrimin dhe eficiencën e punës që duhet të kryhet për mbledhjen, përpunimin, përditësimin, shkëmbimin dhe aksesimin e grupeve të të dhënave në përpunime me standardet e temave të IG, si dhe i shërben forcimit të kapaciteteve, akumulimit të dijes (*know-how*) dhe formalizimit të praktikave në nivel institucional. *Kjo masë siguron ekzistencën e standardeve të zbatueshme mbi temat e ndryshme të IG, që marrin parasysh kapacitetet, kushtet/mundësitë teknologjike dhe përvojat pozitive të autoriteteve shqiptare si dhe orientojnë e thjeshtësojnë punën duke integruar dhe optimizuar proceset për realizimin e saj nëpërmjet hartimit të manualeve/metodologjive që detajojnë dhe shpjegojnë hapat që duhen ndjekur.*

8.2 Krijimi i marrëveshjeve me institucionet edukative (*fakultetet, institucionet dhe qendrat e formimit profesional*) për punësimin e studentëve ekselentë, nëpërmjet ofrimit të praktikave të punës dhe aktiviteteve të përbashkëta me ASIG, që garantojnë tërheqjen dhe punësimin e talenteve premtues në fushën e GIS. Në funksion të rritjes së kërkesës dhe përthithjes së kandidatëve më mirë nga ana e ASIG dhe e institucioneve të sektorit IG, do të realizohen

marrëveshje partneriteti me fakultetet dhe institucionet e tjera edukative për zgjerimin e kuotave në degët dhe programet e lidhur me IG dhe për të përshtatur kurrikulat, programet mësimore dhe metodologjitë e mësimdhënies, duke i orientuar drejt kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimet e fundit të teknologjisë së aplikuar. Programi i praktikave të punës do të shërbejë si instrument për të promovuar profesionin e GIS – si punësim i sigurt, për të pajisur profesionistët e rinj me dije praktike dhe bashkëkohore, si dhe do të krijojë mundësi për të rekrutuar talentet dhe studentët ekselentë. Po ashtu, ASIG do të kontribuojë në edukimin dhe fitimin e dijeve praktike nga studentët përmes tutorialeve trajnuese që mund të përgatiten dhe publikohen në dritaren virtuale (gjeoportali). Procesi për modernizimin e kurrikulës mësimore do të realizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet e arsimit të lartë, ndërsa në bashkëpunim me DAP do të zbatohet platforma për realizimin e praktikave mësimore dhe punësimin e studentëve ekselentë dhe profesionistëve nga rrjetet e brendshme. *Kjo masë siguron rritjen e ofertës në treg të profesionistëve të nevojshëm për t'u punësuar në sektorin e IG, dhe përmes ndërhyrjes në kurrikulën mësimore jepet ndikim në rritjen e kapaciteteve profesionale, si dhe në përshtatjen më të mirë me nevojat e sektorit. Gjithashtu, kjo masë garanton tërheqjen dhe përzgjedhjen e kandidatëve më mirë dhe në përshtatje më të plotë me profilin e pozicioneve të punës.*

8.3 Pilotimi i rrjetit të profesionistëve në fushën e IG do të garantojë konsultim eficient midis stafit, shkëmbimin e përvojave, transferimin e dijes, bashkëpunimin e bashkëndarjen e burimeve në realizimin e projekteve dhe nismave në fushën e IG. Po ashtu, në kuadër të këtij rrjeti mund të ngrihen forume dhe grupe tematike që angazhohen me çështje specifike. Aktiviteti i ngritjes së rrjeteve/grupeve teknike brenda sektorit të IG, do të shoqërohet me përgatitjen e rregulloreve përkatëse, të cilat mund të parashikojnë ngritjen e grupeve tematike, institucionin drejtues për çdo grup/forum, temat e diskutimit, aktivitetet, frekuencën e mbledhjeve, etj. Në kuadër të ngritjes dhe implementimit të rrjetit të profesionistëve IG do të krijohet lidhja dyfishe, që nënkupton lidhje me ASIG nga ana funksionale në fushën e IG dhe me institucionin nga ana administrative. Kjo do të garantojë implementim të njëjtë të standardeve dhe



metodologji të punës përgjatë të gjithë ciklit të prodhimit të IG, që nga kapja e të dhënave deri tek shpërndarja e informacionit, duke rritur në këtë mënyrë performancën e sektorit. *Kjo masë ndikon në zbatimin e standardizuar dhe në mënyrë uniforme të praktikave dhe proceseve në sektorin e IG, rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të sektorit (do i jepet zgjidhje çështjeve më shpejt dhe më saktë nga ana teknike), mundëson zhvillimin profesional të stafit, rrit motivimin në punë për faktin që punonjësit i përkasin një rrjeti më të madh, ofron mundësi për zhvillim në karrierë dhe krijon "ID-në" e profesionit GIS. Gjithashtu, rrjetëzimi i burimeve njerëzore është një mënyrë e mirë për marketimin e institucioneve pjesë e sektorit të IG dhe rritjen e koordinimit/ bashkëpunimit midis tyre.*

8.4 Programe për trajnim–zhvillimin e stafit, ngritjen në karrierë dhe motivimin në punë: Marrëveshjet e praktikave të punës me institucionet e edukimit/arsimit përkatës janë hapi i parë i procesit për të garantuar burime njerëzore që janë potenciale për të ardhmen dhe kanë dëshirën e duhur për të nisur karrierën e punës si pjesë e sektorit të IG, tek të cilët duhet të investohet në mënyrë të vazhdueshme përmes hartimit të **programeve dhe moduleve për zhvillimin e kapaciteteve profesionale të IG**, të cilat do të shtrihen për të gjithë nivelet hierarkike të punonjësve dhe gjatë gjithë ciklit të punës (jo vetëm për punonjësit e rinj), për të gjithë stafet e institucioneve të angazhuara në prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit gjeohapësinor, përfshirë institucionet private, duke shfrytëzuar oportunitetet që ofron teknologjia në përmirësimin e teknikave të zhvillimit të njohurive (psh. përmes tutorialeve që mund të publikohen edhe tek faqja e gjeoportalit, mundësitë e trajnimit online, telekonferenca, forume online ndërinstitutionale, etj.), në përpunje me nevojat e evidentuara, orientimin e sektorit dhe investimet e kryera dhe të planifikuara në teknologji në sektorin e IG. Fokus të veçantë do t'i kushtohet stafit përgjegjës për garantimin e funksionalitet të portalit GIS, për ta vënë në zbatim idenë "*vizituesi*" përmes "*chat online*" apo shërbimit telefonik.

Kjo masë 8.4. do të realizohet në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) dhe programi duhet të përfshijë edhe përpjekjet aktuale të ndërmarra nga ASIG.

Ngritja e rrjetit të profesionistëve IG/GIS nga ASIG, shtron rrugën për hartimin e një linje të qartë për ngjitjen në karrierë, përmes hartimit të

Programit për Zhvillimin në Karrierë, i cili duhet të ndërlihet me programin e trajnimeve.

Gjatë implementimit të masave për zbatimin e Politikës nr.7, duhet të rishikohet statusi i punonjësve të ASIG dhe sektorit IG, duke rishikuar sistemin e shpërblyerjes në përpunje me funksionet dhe përgjegjësitë e ri-dimensionuara. Zhvillimi i kapaciteteve do të shoqërohet me ngritjen e mekanizmave për vlerësimin e performancës së institucioneve (lidhur me IG) dhe me instrumente për ndjekjen e performancës në punë të punonjësve, ecurinë në karrierë dhe shpërblyerjen, gjë e cila do të realizohet në bashkëpunim me DAP.

Instrumentet e sipërpërmenduar ndikojnë në rritjen e nivelit të motivimit të stafit. Kjo masëgaranton mirë-kualifikimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit, në përpunje me kërkesat e pozicioneve të punës, me qëllim rritjen e performancës dhe produktivitetit në punë, qëndrueshmërinë e stafit në terma afatgjatë, si dhe rrit përkushtimin dhe angazhimin ndaj punës dhe institucionit.

2.4.3 Politika Nr. 9 "Infrastrukturë & teknologji funksionale dhe e rrjetëzuar"

Elementi tjetër thelbësor që formëson sektorin e IG dhe që zë një kosto të madhe në ngritjen e sistemit është Infrastruktura dhe Teknologjia e duhur për të mbështetur aktivitetin dhe realizimin e produkteve dhe proceseve në kohën më të mirë dhe të shpejtë, si dhe për të mbështetur strukturat në realizimin e funksioneve të tyre, që përfshin të gjithë teknologjinë (hardware dhe software) në dispozicion të aktorëve; rrjetet dinamike të komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave në përpunje me rregullat dhe protokollet e përcaktuara; pajisjet dhe mjetet që garantojnë ndërlihdjen/ndërveprueshmërinë mes aktorëve të ndryshëm. Kjo politikë është në përpunje me Drejtimin Strategjik 5 "Inovacion" të kornizës strategjike gjithëpërfshirëse (IGIF) të UN-GGIM, duke konsideruar që teknologjia dhe proceset janë në evoluim të vazhdueshëm duke krijuar kështu mundësi të jashtëzakonshme për inovacion dhe krijimtari, që do të mundësonte qeverisje më të mirë nëpërmjet vendimarrjeve të duhura dhe natyrisht shërbime më të mira për qytetarët.

Sikurse është evidentuar në seksionin përkatës mbi sektorin e IG, infrastruktura kombëtare për të dhënat gjeohapësinore jo vetëm ka rol thelbësor,



por ajo shërben për të përkufizuar sektorin duke qenë një nga elementët e tij. Është pikërisht infrastruktura (hardware dhe software) që mundëson marrjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave, shkëmbimin e tyre dhe vënien në dispozicion të përdoruesve të ndryshëm përmes aksesit të lehtë nëpërmjet rrjeteve elektronike dhe internetit. Infrastruktura kombëtare për të dhënat gjeohapësinore ka gjithashtu një rol vendimtar përsa i përket produktivitetit dhe eficiencës në kryerjen e proceseve që i shërbejnë mundësimit të shërbimeve cilësore kundrejt përdoruesve apo “klientëve” të IG.

Për këtë qëllim, sistemet e avancuara në llogaritje dhe mbledhje të dhënash, teknologjitë e specializuara të bazës së të dhënave, sistemet e fuqishme për ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave, etj., paraqesin rëndësi të jashtëzakonshme. Në sektorin e IG, një nga sistemet më të domosdoshme është GIS (Geographical Information Systems) që bën kontrollin/imazherinë/hartografimin, bazat e të dhënave gjeohapësinore me të dhëna tabulare të gjeoreferuara. Mbi bazën e GIS ngrihen edhe aplikacione gjeografike interaktive si Sistemet Mbështetëse të Vendimmarrjeve (GIS based Decision Support System) që përbëjnë mjete bashkëkohore të vendimmarrjes dhe administrimit të sektorëve të ndryshëm. Nga pyetësi i realizuar për Gjeoportalin Kombëtar rezulton se aktorët përdorin një sërë shërbimesh, të cilat nuk ofrohen nga platformat që përdoren aktualisht, 25% AutoCAD dhe rreth 50% shërbime nga platforma të tjera si SAGA Gis, OLIVER GIS MASS, Google Earth, WEB GIS, etj.

Bazuar në informacionin e mbledhur dhe analizat e kryera, përgjatë viteve janë kryer investime të shpeshta në teknologji dhe infrastrukturë por shpesh ato kanë rezultuar të padobishme, sepse ose nuk përmbushin të gjitha kërkesat në lidhjet me funksionalitetet që duhet të kenë bazuar në nevojat e institucioneve, ose nuk përputhen me sistemet ekzistuese duke pamundësuar komunikimin dhe ndërveprimin mes platformave, çka automatikisht i bën të padobishme. Një tjetër problematikë është se investimet nuk janë në raport të drejtë, pasi pavarësisht investimeve në teknologji nuk janë kryer investime në kualifikimin dhe trajnimin e stafit që do ta përdorë këtë teknologji, duke e bërë

teknologjinë të papërdorshme ose duke pamundësuar shfrytëzimin e saj në kapacitet të plotë. Nga pyetësi mbi Gjeoportalin Kombëtar rezulton se ka nevoja të konsiderueshme për trajnim për platformën GIS, trajnime online për studentët, për specialistë të institucioneve zyrtare, etj.

Po ashtu, sikurse theksohet më lart, shpesh vërehet ecja në mënyrë joparalele dhe zhbalancimi në investimet në teknologji, ku disa institucione kanë teknologji të fundit, ndërsa të tjerë nuk zotërojnë pajisjet bazike për kryerjen e punës së tyre. Një aspekt i rëndësishëm është dhe mirëmbajtja e sistemeve të informacionit (për pjesën fizike dhe logjike), ku të gjithë aktorët duhet të integrojnë bazat e tyre të të dhënave. Nga pyetësi mbi përdorimin e Gjeoportalit Kombëtar, rezulton se të dhënat janë të pa përditësuara, ku ndër to rreth 30% të dhënat për parcelat kadastrale, rreth 20% ortofotot, 10% hartat, dhe pjesa tjetër për sistemin e adresave, emërtimet gjeografike, etj.

Si rrjedhojë e këtyre problematikave, ka institucione që vijojnë të bëjnë përpunim manual të të dhënave, duke bërë që informacioni të dorëzohet në formë shkresore (me letra), çka shkakton çorientimin e sistemit që është projektuar të përpunojë dhe të shkëmbejë të dhënat e dixhitalizuara. Disa institucione kanë mungesë të pajisjeve të infrastrukturës IT ose përdorin software të konceptuar në mënyrën jo të duhur. Kështu p.sh. ASHK (ish-ZRPP) përdor sisteme të cilat lejojnë mbivendosjen e objekteve, ndërkohë që sipas rregullave gjeometrike nuk mund të vendosësh një objekt sipër një tjetri. Në vazhdim të kësaj, institucionet bashkëpunojnë duke përdorur sisteme të ndryshme, duke shkaktuar mospërputhje të të dhënave.

Ndër të tjera i është kushtuar vëmendje e ulët teknologjive të së ardhmes dhe nuk është marrë parasysh oportuniteti dhe potenciali që rrjedh nga fakti se shkalla e dixhitalizimit, përdorimi i internetit dhe teknologjisë në shoqërinë shqiptare, falë edhe moshës mesatare relativisht të re, praktikisht është e lartë në vendin tonë.

Së fundmi janë miratuar nga Këshilli i Ministrave në datë 19.06.2019 “Rregullat për shkëmbimin e grupeve dhe të shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore ndërmjet autoriteteve publike”, duke evidentuar edhe rolin e Gjeoportalit Kombëtar në këtë drejtim.



Bazuar në një sërë dokumentesh dhe raportesh vlerësimi mbi gjendjen e sektorit IG, në informacionin e mbledhur në kuadër të realizimit të këtij dokumenti politikash dhe në konsultimet me aktorët kryesore të sektorit, rezultojnë një sërë çështjesh të lidhura me infrastrukturën kombëtare për të dhënat hapësinore, të cilat paraqiten në mënyrë të përmbledhur më poshtë:

Mungesa e një sistemi të integruar, ku secili institucion tenton të ngrejë sistemin e tij;

Investime të pafrytshme në teknologji dhe infrastrukturë që nuk përputhen me sistemet ekzistuese apo duke mos konsideruar volumin, ngarkesën, cilësinë dhe sigurinë, duke pamundësuar komunikimin dhe ndërveprimin mes platformave;

Rol i paqartë i aktorëve të sektorit, situatë e cila sjell mungesë bashkëpunimi në shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse;

Mungesë e infrastrukturës së nevojshme teknologjike për të dhënat hapësinore;

Mungesë ekspertizë mbi standardet në përgjithësi (të direktivës INSPIRE në veçanti).

Duke vlerësuar çështjet dhe konkluzionet e situatës ekzistuese të shtjelluara më lart, politika e duhur qeverisëse dhe një sërë masash për jetësimin e saj, mund të ndërmerren së bashku për të garantuar teknologji funksionale dhe shfrytëzimin e saj optimal.

Deklarata e Politikës nr.9“Infrastrukturë & teknologji funksionale dhe e rrjetëzuar”:

“Infrastrukturë dhe teknologji funksionale dhe e rrjetëzuar, që i përshtatet qëllimit të përdorimit (fit for purpose), që garanton integrimin dhe komunikimin mes platformave dhe shkëmbimin e standardizuar të të dhënave, që shfrytëzohet dhe mirëmbahet në mënyrë optimale.”

Nëpërmjet kësaj politike synohet të ngrihet një sistem i integruar, ku çdo institucion do të ngrejë sistemin e tij. Gjithashtu, do të planifikohen dhe realizohen investime të duhura në teknologji (objektiv është stimulimi i përdorimit të teknologjive të fundit me kosto efektive⁵) dhe infrastrukturë, që të përputhen me sistemet

ekzistuese, duke konsideruar volumin, ngarkesën, cilësinë dhe sigurinë, për të mundësuar komunikimin dhe ndërveprimin mes platformave.

Kjo politikë do t'i shërbejë qartësimi të rolit të aktorëve të sektorit, për të mundësuar bashkëpunimin në shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse.

Nëpërmjet kësaj politike do të synohet plotësimi me infrastrukturën e nevojshme teknologjike për të dhënat gjeohapësinore dhe do të përmirësohet ekspertiza mbi standardet në përgjithësi (si dhe ato të direktivës INSPIRE në veçanti), për të siguruar përshtatshmërinë e teknologjisë funksionale, të integruar dhe që arrin të shfrytëzohet në kapacitet të plotë, në mënyrë efikase dhe eficiente, por edhe që mirëmbahet në mënyrë optimale, duke mundësuar një vendimmarrje të mirë dhe në kohë reale.

Masat për jetësimin e politikës nr. 9:

9.1 Përdorimi i teknologjisë dhe infrastrukturës, e cila mund të gjendet pa pagesë nga platformat ndërkombëtare, bashkë me informacionin që ato ofrojnë, duke e lidhur me teknologjinë open source, pra të orientuar drejt teknologjisë së të ardhmes, bazuar në një vlerësim të kapaciteteve dhe nevojave ekzistuese të institucioneve përgjegjëse për tema të ndryshme të IG. Kjo masë shërben për pajisjen me burimet e nevojshme hardware dhe software, nëpërmjet të cilave do të bëhet i mundur përdorimi në mënyrë optimale dhe në kohë reale i informacionit gjeohapësinor.

9.2 Integrimi i infrastrukturës së të gjithë institucioneve në sistemin dixhital/elektronik të mbledhjes, përpunimit, përditësimit dhe shkëmbimit të të dhënave dhe konvertimin e shërbimeve nga manuale në dixhitale, duke i dhënë fund praktikave ekzistuese inefficente dhe shkëmbimit të informacionit në formë shkresore. Zbatimi i kësaj mase përbën domosdoshmëri për disponueshmërinë e informacionit gjeohapësinor në kohë reale dhe në standardet e kërkuara, nëpërmjet unifikimit të informacionit gjeohapësinor.

9.3 Plan mirëmbajtje që sistemet të mos degradojnë, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve me sektorin privat, në mënyrë që të parandalohet përkeqësimi i sistemeve dhe të mundësohen kapacitetet e duhura infrastrukturore (si psh. google, amazon apo dhe platforma të tjera), duke konsideruar dhe rregullimet ligjore të

⁵UN-GGIM/IGIF/Strategic pathway 5 “Innovation”-
The objective is to stimulate the use of the latest cost-effective technologies, process improvements and innovations so that governments, no matter what their current situation is, may leapfrog to state-of-the-art geospatial information management systems and practices.

nevojshme për të shmangur keqpërdorimin e informacionit për qëllime të ndryshme. Kjo masë garanton rikuperimin e të dhënave në rast dëmtimi apo ndërhyrjesh të pautorizuara. Do sigurojë një planifikim të mirëmbajtjes të integruar për të gjitha sistemet.

9.4 Kontrolli i teknologjisë që do ndërtohet nga ASIG, duke i përcaktuar tek standardet DST në procedurat e tenderimit, nëpërmjet një procedure miratimi nga ASIG për sistemet e karakterit të informacionit gjeohapësinor, duke mundësuar në këtë mënyrë kontrollin. Kjo masë garanton që sistemi të ketë infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme, në përputhje me kapacitetet dhe funksionet që duhet të realizojë. Për ta bërë efektive, është e nevojshme që të vendoset në dokumentet standard të tenderit (DST) citimi i faktit nëse është marrë miratimi nga ASIG apo jo, duke përcaktuar në të kundërt që nuk mund të ngarkohen në sistemin e prokurimit publik dokumentet përkatëse (siç ndodh me sistemet kompjuterike të AKSHI-t).

2.5 DREJTIMIT E POLITIKAVE PËR MIRËADMINISTRIMIN E SEKTORIT IG

Grupi i fundit i politikave për sektorin e IG kanë të bëjnë me administrimin, që nënkupton zhvillimin e tij, pra garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm në mënyrë të vazhdueshme të sektorit, rregullimi i marrëdhënieve, të drejtave e detyrimeve midis aktorëve (që nga publiku që përfaqësohet nga legjislacioni që shteti vendos deri tek marrëdhëniet mes aktorëve me marrëveshje, kontrata apo leje/licencime), qëndrueshmëria financiare e sektorit, që nënkupton mundësinë për të siguruar burimet e mjaftueshme financiare të nevojshme për të përballuar aktivitetin e tij, prodhimin e IG, funksionalitetin e sistemit dhe rritjen në mënyrë të vazhdueshme. Drejtimit e politikave që lidhen me realizimin e synimit strategjik IV mbi administrimin e mirë të sektorit IG, janë në përputhje edhe me kornizën strategjike gjithëpërfshirëse (IGIF) të UN-GGIM, konkretisht me: Drejtimin Strategjik 2 “Ligjor dhe Politik” dhe Drejtimin Strategjik 3 “Financiar”.

Sa më sipër, për të bërë të mundur realizimin e **Synimit Strategjik për “Mirëadministrimin e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor”, me qëllim** garantimin e një sektori dinamik në rritje dhe zhvillim të vazhdueshëm, me të drejta dhe detyrime të përcaktuara në mënyrën e duhur, i

qëndrueshëm nga ana financiare, ku interesat e aktorëve të ndryshëm janë të harmonizuar dhe maksimalizuar përkundrejt interesit të gjerë publik, drejtimit kryesor të politikës qeverisëse janë:

-Politikat për garantimin e qëndrueshmërisë financiare të sektorit, duke synuar ekulibrin financiar midis nevojës për të patur shërbime dhe produktin e duhur të IG dhe investimit për rritjen dhe zgjerimin e tij, politikave për akses të lirë në IG dhe buxheteve dhe të ardhurave të mjaftueshme për të plotësuar nevojat.

-Politikat për të drejtat dhe detyrimet e aktorëve të sektorit, duke respektuar të drejtën e copyright, por edhe zbatimin e detyrimit për publikim e transparencë. Duke zbatuar të drejtën për informim por ndërkohë duke respektuar detyrimin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacioneve sensitive. Duke konsideruar të drejtën për akses përkundrejt detyrimit për sigurinë e informacionit (përfshirë rastet e moscënimit të sigurisë kombëtare, etj.). Pra, në tërësi duke respektuar të drejtën për të marrë/mundësuar, përkundrejt detyrimit për të dhënë/garantuar diçka në këmbim.

-Politikat për Zhvillimin e sektorit të IG, që nënkupton rritjen cilësore të shërbimeve dhe produkteve të IG, zgjerimin e këtyre shërbimeve si në numër, kategori përdoruesish dhe në shtrirje gjeografike, si dhe në qasje dhe orientim drejt së ardhmes të sektorit bazuar në potencialet e së tashmes dhe eksperiencën e së shkuarës.



2.5.1 Politika nr. 10 “Financimi qëndrueshëm i sektorit”

Garantimi i financimit të qëndrueshëm është një nga drejtimit kryesor të politikës së qeverisjes për çdo sektor në përgjithësi dhe si e tillë dhe për sektorin e IG në veçanti. Orientimi që politika i



bën qëndrueshmërisë financiare të sektorit është thelbësore për të garantuar burimet e duhura financiare për trajtimin e problematikave dhe mbushjen e boshllëqeve për aktivitetin normal të sektorit sot dhe rritjes së tij në përputhje me politikat e zhvillimit në të ardhmen, duke qenë që ka një rol të drejtperdrejtë në politikat fiskale dhe buxhetore për financimin e sektorit.

Kjo politikë është në përputhje me Drejtimin Strategjik 3 “Financiar” të kornizës strategjike gjithëpërfshirëse (IGIF) të UN-GGIM, për zhvillimin e partneritetit financiar, identifikimin e nevojave për investime dhe burimet e financimit, me qëllim ofrimin e menaxhimit të integruar të informacionit gjeohapësinor.

Pavarësisht se informacioni gjeohapësinor mund të aplikohet në shumë fusha, duke sjellë progres, vendimmarrje të plotë, planifikim më efektiv, efencë në kosto etj., ende nuk vlerësohet në mënyrë të saktë vlera e shtuar që sektori jep në ekonomi dhe ç’pjesë të kësaj vlere e merr mbrapsht nga buxheti i shtetit. Në totalin e investimeve të parashikuara për ASIG në periudhën 2018-2021 nga analiza e PBA rezulton se buxheti i shtetit mbulon 88.9% të financimeve (701 milionë lekë shpenzime kapitale), ndërkohë që 87.5 milionë lekë ose 11.1% u takojnë donatorëve. Financimet janë shtrirë jo vetëm për ASIG që është institucioni qëndror i sektorit, por edhe për aktorët e tjerë, kryesisht në projektet e tyre për krijimin e GIS në varësi të sektorëve që mbulojnë.

Pavarësisht sasisë së financimit, problemi kryesor qëndron në mënyrën sesi menaxhohen këto fonde ose sesi bëhet shpërndarja e tyre. Financimi në sektor paraqitet i copëzuar sipas strukturave apo nevojave të ndryshme, duke mos u realizuar me efencën e duhur. Investimet nuk mbulojnë të gjithë sektorin por pjesa më e madhe e investimeve shkojnë në infrastrukturë dhe teknologji, ndërkohë që mungojnë investimet në kapacitete njerëzore apo në forcim institucionesh. Shumë struktura refuzojnë të bashkëfinancojnë apo të shpërndajnë riskun me njëra-tjetrën dhe shpeshherë nuk rishihen opsione me të vlefshme për realizimin e detyrave, për të optimizuar kostot dhe për të realizuar mundësi më të gjerë përfshirjeje kundrejt të gjithë aktorëve.

Tërheqja përkundrejt donatorëve vazhdon të mbetet e ulët, kjo për shkak të mungesës së njohurive, njohjes së paktë të procedurave nga

institucionet që bëjnë kërkesat për thithje fondesh etj., edhe pse potenciali që mund të vijë prej tyre kundrejt zhvillimit të sektorit, është i konsiderueshëm. Krahas aksesit shumë të dobët në fondet globale, problemi tjetër lidhet me gjetjen e mundësive të pakta për të ulur kostot duke shfrytëzuar platformat globale apo ato opensource, duke mos parë mundësi bashkëpunimi apo partneriteti. Shpeshherë këto burime neglizhohen dhe nuk u merret rëndësia e duhur, pavarësisht impaktit të lartë të tyre në optimizimin e kostove.

Sa më sipër, çështjet kryesore që duhet të adresohen nga politika për financimin e sektorit, janë:

-Financim i ulët në raport me peshën dhe rëndësinë e IG, duke u fokusuar kryesisht vetëm në një burim financimi dhe nga donatorët, përjashtuar bashkëfinancimin ndërmjet aktorëve.

-Mospatjen e të ardhurave për shkak të politikës për aksesin pa pagesë ndaj IG nga grupet e interesit dhe mos shfytëzimi i partneriteteve me biznesin, por shikohet thjesht si një shërbim shtetëror.

-Copëzim i financimit nëpër projekte, aktorë të ndryshëm, në nivel vendor, qendor, biznes, etj, duke mos lejuar patjen e zgjidhjeve që u shërbejnë të gjithëve dhe optimizimin e vlerës së përdorimit të financimit dhe përhapjes së zgjidhjes.

Akses i dobët në fondet globale dhe nga BE/donatorë të ndryshëm apo mundësisë për të ulur kostot duke shfrytëzuar platformat globale apo ato opensource.

Deklarata e Politikës nr.10 “Financim i qëndrueshëm i sektorit”:

“Garantimi i qëndrueshmërisë financiare të sektorit, duke siguruar ekuilibrin midis aksesit dhe ofrimit të shërbimeve “pa pagesë” ndaj publikut dhe përdoruesve të tjerë, përkundrejt kontributit në inpute dhe ndarjes së kostove midis aktorëve të ndryshëm dhe optimizimit të shpenzimeve dhe përfitimit të dyanshëm me sektorin privat për shërbime që shkojnë përtej vënies në dispozicion të informacionit, duke kapitalizuar dhe thithur burime financiare përkundrejt interesit të donatorëve dhe aktorëve global në sektor.”

Kryerja e projekteve të ndryshme të cilat synojnë lulëzimin dhe forcimin e sektorit të IG kërkon sigurimin e një niveli të mjaftueshëm financimi. Politika për qëndrueshmërinë financiare fokusohet në disa drejtime, duke synuar një



mbulim të plotë dhe të gjerë. Stabiliteti financiar mundësohet nëpërmjet rritjes së kontributit të buxhetit në sektor, duke qenë se investimi në IG ka një nga normat më të larta të kthimit kundrejt vlerës fillestare të investimit të realizuar, për shkak të impaktit të shtuar që sjell në çdo sektor. Përfitimi i gjithanshëm që vjen nga përdorimi i informacionit gjeohapësinor, sjell detyrimin ndaj buxhetit të shtetit që të realizojë investime në sektor së bashku me nxitjen kundrejt donatorëve apo tërheqjen e investimeve të huaja për të shtuar nivelin e financimit, në raport të drejtë me vlerën e informacionit gjeohapësinor në zhvillimin e përgjithshëm të vendit.

Politika synon optimizimin e kostove dhe të ardhurave duke u fokusuar në realizimin e kontratave bashkëpunuese me subjektet private. Tashmë drejtimi politik do shtrihet jo vetëm në ofrimin e lirë dhe pa pagesë të informacionit për publikun, por prioritet do jetë krijimi i marrëdhënieve të ngushta me sipërmarrjen me qëllim shfrytëzimin e efikasitetit të tyre në ofrimin e shërbimeve specifike. Gjetja e burimeve të leverdishme ekonomikisht nëpërmjet kontraktimit të subjekteve private do i japë zgjidhje ngërçit të krijuar.

Drejtimi tjetër politik lidhet me marrjen e vlerës në mënyrë të shumëfishtë nëpërmjet projekteve dhe zgjidhjeve të përbashkëta dhe me bazë *opensource*. Fokusi do jetë në gjetjen e zgjidhjeve që aplikohen lehtësisht kundrejt një grupi të madh institucionesh dhe në mënyrë sa më shpejtë, si përsëritje aplikimi i teknologjive që bëjnë *share* të dhënash duke dhënë zgjidhje për të tërën.

Së fundmi, duhet të shtrohet rruga për thithjen e fondeve IPA apo kundrejt donatorëve të tjerë vendas dhe të huaj, pasi sektori ka nevojë të lartë për këto investime për të marrë jetë dhe për t'u zgjeruar në drejtime të reja. Gjithashtu me shumë përfitim shihet edhe përdorimi dhe bashkëpunimi me platformat globale të tilla si google, bing, etj.

Masat për jetësimin e politikës nr. 10

10.1 Rritje e financimit të IG bazuar në vlerën/impaktin e tij: Hartimi i një plani financimi të sektorit dhe marrja e financimit nga buxheti mbi bazën e kontributit që informacioni gjeohapësinor jep në buxhet dhe ekonomi, duke kryer vlerësime/studime/analiza sesa vlerë e shtuar merret nga rritja me x% e financimeve jo vetëm kundrejt ASIG si institucion i vetëm, por kundrejt

sektorit të IG, nëpërmjet përfshirjes së tij si prioritet në programin buxhetor. *Kjo masë ka një ndikim shumë të lartë pasi sektori ka nevojë për financime në kuadër të ngritjes dhe kualifikimit të kapaciteteve, por kjo sjell ndryshime në mënyrën e shpërndarjes së buxhetit aktual. Kryerja e analizave do i japë ngjyrë rëndësisë së IG në mënyrë të argumentuar, duke rritur vëmendjen e strukturave qeveritare dhe jo vetëm për të shtuar financimet kundrejt të gjithë sektorit. Gjithashtu plani i financimit do ketë ndikim të konsiderueshëm në reduktimin e financimit të copëzuar, duke përcaktuar sesa janë realisht nevojat për burime financiare kundrejt secilit prej institucioneve përbërëse të informacionit gjeohapësinor. Realizueshmëria konsiderohet mesatare, kjo për shkak të analizave mbështetëse dhe vështirësisë për të tërhequr vëmendjen e institucioneve shtetërore kundrejt IG.*

10.2 Mundësi bashkëfinancimindërmjet NjVV, ASIG dhe përdoruesve të tjerë për të gjetur zgjidhje të përbashkëta, bazuar në mundësitë e shumta teknologjike si dhe në burimet *opensource*. *Kjo masë sjell një përfitim të lartë në reduktimin e kostove dhe njëkohësisht në aplikimin e zgjidhjeve të njëjta për shumë struktura, në mënyrë të menjëhershme dhe të plotë. Realizueshmëria mundësohet nga lobimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm, për t'i ndërgjegjësuar në lidhje me përfitimet e shtuara nga shtrirja e financimit.*

10.3 Optimizimi me biznesinnëpërmjet përfshirjes së sistemeve të manaxhimit privat dhe të cilat lidhen me zhvillimin e mëtejshëm të KRGJSH, duke siguruar certifikim të përshtatshmërisë së sistemeve/rjeteve gjeodezike të tyre me Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare. *Kjo masë do të sjellë përfitime të mëdha sepse të gjithë aktorët privatë do të angazhohen dhe kontribuojnë në qëndrueshmërinë financiare të sektorit duke vetë-menaxhuar sistemet e tyre ose rrjetet gjeodezike të cilat ndërthuren me zhvillimin e mëtejshëm të Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare, ndërkohë që ASIG do të sigurojë certifikimin e përshtatshmërisë së tyre me KRGJ Shqiptare.*

10.4 Tërheqja e fondeve IPA dhe të donatorëve për të gjithë sektorin e IG, duke bashkëpunuar me institucionet që kanë të gjithë *know-how* për të kryer alikimet për fonde, duke i dhënë strukturës së financës së ASIG një fokus të veçantë, për të parë ku janë këto fonde dhe sesi mund të aplikohet për të bërë thithje të tyre. *Kjo masë ka impakt shumë të lartë dhe sjell potenciale të shumta për sektorin, pasi evidentohet drejtimet e reja të zhvillimit dhe mundësitë e zgjerimit. Realizueshmëria mundësohet nga bashkëpunimi me FSHZH apo struktura të tjera për*



hartimin e projekteve, deri në kapërcimin e problemeve për aplikimin për fonde dhe thithjen e tyre.

10.5 Shitja e produkteve specifike- Mundësi për tregtueshmërinë e produkteve specifike kundrejt bizneseve apo përdoruesve të tjerë (duke filluar me hartat e navigimit) apo me klering, e cila ose do të minimizojë kostot ose do krijojë të ardhura shtesë. Kryerja e analizave të mirëfillta, komplekse dhe të detajuara, të cilat i përshtaten nevojave specifike të përdoruesve, si psh. shërbimet për njohjen, kuptimin dhe kryerjen e projekteve për realitetin ekzistues mund të kryhen kundrejt një tarife të përcaktuar në përputhje me kostot për realizimin e saj. *Shitja e produkteve specifike do ofrojë të ardhura për sektorin. Realizueshmëria konsiderohet mesatare, pasi nevojitet ndërgjegjësimi i subjekteve për të kuptuar vlerën e shtuar të produktit, për të cilin më pas do ishin të gatshëm të paguanin.*

2.5.2 Politika nr. 11 “Mirërregullimi i të drejtave dhe detyrimeve”

Pjesë e rëndësishme e administrimit të mirë të sektorit është edhe rregullimi i duhur i të drejtave dhe detyrimeve. Në mënyrë që të kemi një sektor funksional duhet që aktet ligjore rregulluese të veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për informacionin gjeohapësinor, të jenë të qarta, të plota dhe të orientojnë drejt bashkëpunimit dhe përdorimit cilësor të informacionit. Kjo politikë është në përputhje me Drejtësinë Strategjike 2 “Ligjor dhe Politik” të kornizës strategjike gjithëpërfshirëse (IGIF) të UN-GGIM, që synon një kornizë të fortë ligjore dhe politike që është thelbësore për të krijuar legjislacionin dhe politikën e duhur të informacionit gjeohapësinor kombëtar.

Aktualisht kemi mbi 200 akte ligjore dhe nënligjore të sektorit të informacionit gjeohapësinor, nga të cilat 28 lidhen drejtpërdrejt me veprimtarinë e ASIG. Lidhur me këtë, sektori paraqitet me disa probleme, të cilat i adresojnë kryesisht si shkak i copëzimit të kuadrit ligjor, duke mos përcaktuar rregulla të sakta të bashkëpunimit lidhur me të drejtat e informimit, privatësisë, sigurisë, etj. Problematikat kanë të bëjnë me rregullat që nuk janë të qarta dhe nuk zbatohen, sepse institucionet pretendojnë se nuk kanë buxhetin dhe kapacitetet njerëzore të aftësuara.

Nga vlerësimi i situatës ekzistuese lidhur me rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve në sektorin e IG, problematika e parë që identifikohet lidhet

me vlerën ligjore të informacionit gjeohapësinor. Vlera ligjore e informacionit gjeohapësinor që jepet në portale është shumë e ulët, pasi shpeshherë informacioni gjeohapësinor që merret nuk shërben si provë e materializuar dhe zyrtare, por duhet një burim tjetër informacioni që ta konfirmojë vlefshmërinë e tij. Për shembull bizneset marrin hartën sizmiologjike nga ASIG, por në momentin që bëjnë projektin për ndërtimet, duhet të shkojnë ta marrin zyrtarisht në letër me shkrim dhe vulë nga IGJEUM, pasi informacioni i publikuar nga gjeoportali nuk konsiderohet i vlefshëm. Të dhënat që merren nga gjeoportali nuk kanë vulë dixhitale, e cila jepet vetëm për dokumentet në format PDF, çka do e bënte dhënien e informacionit gjeohapësinor praktikisht të pamundur, pasi duhet ta dixhitalizosh nga fillimi për të mundësuar kryerjen e analizave të ndryshme nga përdoruesit. Kjo është një problematikë e cila shtrihet më gjerësisht se sa thjesht përpjekja e institucioneve, pasi vetë procedurat burokratike dhe mentaliteti në vend krijojnë pengesa që kjo të ndodhë. Për shembull, vetë gjykatat kërkojnë dokumentacionin tradicional të marrë direkt nga institucioni. Në këtë mënyrë është e nevojshme që t’i jepet status ligjor informacionit gjeohapësinor dhe jo thjesht status informativ.

Problematika e dytë që hasim është se e drejta e “copyright” shkelet në mënyrë flagrante. Kjo sjell problematikë, sepse përveç faktit që shvlerëson dhe zhbalancon nga pikpamja e qëndrueshmërisë financiare, informacioni transformohet duke kaluar nga një burim në tjetrin dhe humbet cilësinë e tij. Problemi i “copyright” qëndron edhe nga pikpamja e infrastrukturës, ku institucione që përdorin softe si autocad, në 95% të rasteve nuk janë të pajisur me licencë, në mënyrë që të provojnë se informacioni prodhohet në standardet e duhura dhe me teknologji të caktuara.

Problematika e tretë që haset ka të bëjë me të drejtat dhe detyrimet mes institucioneve, të cilat në një sërë rastesh kanë ambiguitet mes tyre apo dhe mbivendosje të hapur. Referuar marrëdhënieve që lindin midis aktorëve të sektorit, nga analiza e kuadrit rregullator rezulton mungesë ndërveprimi efektiv mes ASIG dhe institucioneve të tjerë, për shkak të mospërcaktimit të saktë të përgjegjësisë të secilit dhe mosrespektimit të rregullave të shkëmbimit të të dhënave. Kjo situatë paqartësie në



rastin më të mirë sjell konfuzion dhe në rastin më të keq mund të çojë në konflikt mes institucioneve.

Problematika e katërt kryesore që haset, ka të bëjë me të drejtat dhe detyrimet e informacionit të klasifikuar dhe sensitiv. Në këtë rast, ka një sërë të dhënash që mbahen të klasifikuara dhe që sipas ligjit duhet të ishin deklasifikuar në mënyrë që të publikohen (si rasti i ortofotove dhe IGJIU-së). Aktualisht, në funksion të ruajtjes së të drejtës private, në të dhënat që ASIG ka për parcelat kadastrale përcaktojnë numrin e pasurisë, sipërfaqen, duke mos bërë publike informacionin se kujt i përket ajo pronë.

Çështjet kryesore që duhet të adresojë politika në raport me të drejtat dhe detyrimet e IG janë:

-Vlera ligjore e informacionit gjeohapësinor;

-Të drejtat dhe detyrimet mbi pronësinë (*copyright*);

-Marrëdhëniet ndërinstitucionale (të drejtat dhe detyrimet mes tyre);

-Publikimi apo jo i të dhënave sensitive.

Deklarata e politikës nr. 11 “Mirërregullimi i të drejtave dhe detyrimeve”

“Përcaktimi i qartë i të drejtave dhe detyrimeve të institucioneve duke garantuar ofrimin e IG të plotë e të vlefshëm ligjërisht, duke respektuar të drejtën për publikim e transparencë, por edhe zbatimin e detyrimit të pronësisë intelektuale. Duke zbatuar të drejtën për informim por ndërkohë duke respektuar detyrimin për mbrojtjen e të dhënave personale e sensitive. Duke konsideruar të drejtën për akses përkundrejt detyrimit për sigurinë e informacionit.”

Politika për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve përmbush një nga elementët për të pasur një sektor të administruar mirë dhe në funksion të marrëdhënieve ndërvepruese midis aktorëve të sektorit të informacionit gjeohapësinor.

Politika e rregullimit të të drejtave dhe detyrimeve synon dhënien e vlerës ligjore në përdorim të informacionit gjeohapësinor duke rritur shpejtësinë, komunikimin dhe vlerën e përdorimit të IG në këtë drejtim – duke aplikuar kështu edhe “derregullimin” si reformë e qeverisjes në vitet e fundit dhe aplikimit të suksesshëm të e-Albania/e-shërbime, në këtë mënyrë duke i dhënë vlerë IG në rastet kur gjenerohet apo lëvrohet nga një institucion zyrtar si ASIG etj.

Gjithashtu synohet plotësimi, përmirësimi dhe implementimi i duhur i të drejtave dhe detyrimeve mbi pronësinë (*copyright*), për të pasur prodhim IG nga burime të sigurta, që nuk transformohet nga shkëmbimi, për të pasur institucione të pajisur me licencat përkatëse për programet që përdorin gjatë punës së tyre, bazuar në normat e vendosura për shfrytëzim dhe mundësinë e marrjes së benefiteve nga përdorimi.

Politika synon të rregullojë marrëdhëniet ndërinstitucionale, të drejtat dhe detyrimet mes tyre, për të shmangur paqartësinë e përgjegjësiave dhe mbivendosjen që krijohet për këtë shkak. Duke realizuar këtë, ndërveprimi midis ASIG dhe institucioneve të tjerë do të jetë më efektiv, dëshira e bashkëpunimit do të jetë në rritje dhe e vazhdueshme.

Synimi i fundit që kërkon të arrijë kjo politikë është qartësimi i konfliktit të publikimit apo jo të të dhënave sensitive, me qëllim që përdoruesit të kenë të drejtën për akses përkundrejt informacionit të sigurtë.

Masat për jetësimin e politikës nr. 11:

11.1 Analizimi dhe rishikimi i kuadrit rregullator në drejtim të ‘derregullimit’, që do të mundësojë dhënien vlerë ligjore apo status ligjor informacionit gjeohapësinor, përveç statusit informativ. Informacioni gjeohapësinor duhet t’i bashkëngjitet nismës së qeverisë shqiptare për vulën dixhitale për të marrë vlerë ligjore dhe për të shërbyer si provë vlefshmërie, që vërteton që të dhënat e marra nga gjeoportali janë të dhëna zyrtare. *Kjo masë e jetëson politikën sepse rregullon marrëdhëniet juridike që lindin në përdorimin zyrtar të informacionit gjeohapësinor, tashmë me vlerë ligjore, jo thjesht informativ. Impakti pozitiv qëndron edhe në pasjen të qartë dhe të detyrueshme përmbushjen e rregullave të përcaktuara nga statusi ligjor i IG, duke shmangur keqinterpretimet dhe konfliktet e mundshme. Nëpërmjet kësaj, përdorimi i IG merr vlerën maksimale.*

11.2 Të drejtat e pronësisë intelektuale (*“copyright”*), për të garantuar shkëmbimin e IG bazuar në respektimin e të drejtave të pronësisë, nëpërmjet bërjes publike të sa më shumë fushatave sensibilizimi për portalin dhe faktit që mund të aksesohet pa pagesë, duke shmangur kështu mundësitë për mashtrime, si dhe nëpërmjet forcimit të masave dhe sanksioneve për përdorimin abuziv. *Kjo masë e jetëson politikën nëpërmjet dhënies vlerë të përdorimit të informacionit gjeohapësinor bazuar në respektimin e të drejtës intelektuale, për të pasur*



informacione autentike dhe me burime të sigurta. Impakti i masës është pozitiv në cilësinë e IG së ofruar, i cili do të përmbushë të gjithë standardet e kërkuara duke përfshirë edhe të drejtën e krijuesit.

11.3 Bashkëpunimi i ASIG me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për hartimin e një udhëzuesi për shkëmbimin e të dhënave. *Pasja e një udhëzuesi bën të mundur që rregullat të jenë të shkruara dhe të detyrueshme për zbatim, duke përcaktuar mënyrat dhe procedurën që ndiqet për shkëmbimin e të dhënave sensitive. Kjo masë jetëson politikën sepse është “shembull” i bashkëpunimit midis institucioneve në kuadër të rregullimit të të drejtave dhe detyrimeve mes tyre në lidhje me mbrojtjen e të dhënave të shkëmbyera.*

2.5.3 Politika nr. 12 “Mbi zhvillimin e sektorit të IG”

Zhvillimi i sektorit të IG është ndër politikat kryesore për të siguruar përmbushjen e synimit për të pasur një sektor të mirëadministruar me rritje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. Për të realizuar këtë do të duhet të bëhet planifikim i duhur i zhvillimit, nëpërmjet perfeksionimit të teknologjisë dhe formësimit të dokumenteve strategjike dhe projekteve të zhvillimit të sektorit. Duke qenë se sektori i IG konsiderohet i rëndësishëm dhe për faktin se gjeneron inpute për sektorët e tjerë, duhet të përcaktojë drejtimitet dhe objektivat e zhvillimit të sektorit, duke formësuar plane, projekte dhe programe të ndryshme. Referuar kësaj, veç disa strategjive dhe dokumenteve politike të fushave specifike (16 strategji, 2 dokumente politikash, 5 plane veprimi, 4 programe) që ndërthuren me shkëmbimin e informacionit gjeohapësinor, është vërejtur mungesa e një Dokumenti Strategjik të integruar për të gjithë Sektorin si dhe nuk është hartuar ende një Program Kombëtar Sektorial, të cilët do të bënin të mundur adresimin e politikave konkrete për zhvillimin.

Nga analiza e dokumenteve politiko-strategjike dhe tërësisë së teknologjive të përdorura në funksion të zhvillimit të sektorit, vihet re vëmendje e pakët ndaj qasjes për bërjen e sektorit të IG avangardë. Kjo ka ardhur jo vetëm për shkak të pasojave financiare, por edhe nga pasja e politikave të paqarta për zhvillimin e sektorit.

Nga vlerësimi i situatës ekzistuese në raport me zhvillimin dhe rritjen e sektorit, vihet re një rritje e ulët të përdoruesve të shoqëruar me rritje të pakët të kategorive dhe cilësisë së informacionit

gjeohapësinor, duke na futur në ciklin negativ: ‘nuk kemi përdorues pasi nuk kemi IG e duhur’, përkundëjt ‘nuk kemi IG e duhur, cilësor, në kohë reale pasi nuk kemi përdorues për ta vënë në përdorim’.

Gjithashtu ajo që vihet re, në kohën e rrjeteve globale dhe mundësive të panumërta që ofron interneti dhe teknologjia, është kufizimi në mendësi brenda kufijve fizik të vendit dhe brenda kufijve të dijes lokale. Nëse për tregun e mallrave fizik, kufijtë dhe madhësia e tregut është thelbësore, në Informacion dhe IG, këto nuk ekzistojnë dhe me një “click” mund të shesësh e blesh në çdo cep të botës, apo të ofrosh shërbime për gjithë botën nga një zyrë. Problemi qëndron në mendësinë se nuk duhet të dalim nga kufijtë, ndërkohë që dija nuk duhet të ketë kufij. Kjo është mendësia e kufizimit të potencialit të rritjes dhe zhvillimit të sektorit.

Nga ana tjetër, pavarësisht rritjes së vogël, kemi rritje të zbalancuar vetëm në teknologjinë e sistemit dhe jo në harmoni me të gjithë elementet e tjerë të sistemit, apo kaotike dhe të pakoordinuar. Kjo krijon deformim, duke mos marrë dot vlerën e shtuar të gjithë organizmit, shpenzime jo efikase, copëzim i sektorit dhe rritja është e pa harmonizuar. Në total, nuk kemi rritje të sektorit, e kemi të izoluar, nuk e ndajmë me të tjerët, kemi rritje vetëm në një drejtim dhe kjo sjell një vlerë pothuajse zero të rritjes, duke na bërë të vegjetojmë në prapambetjen e situatës ekzistuese.

Së fundmi ajo që vihet re dhe që përbën thelbin e problematikës në raport me zhvillimin e sektorit, është se përgjithësisht nëpër institucione nuk ka një vizion dhe vullnet për rritjen por ka një orientim drejt përmirësimit apo zgjidhjes së problemit aktual. Vazhdohet me mentalitetin e të shkuarës, me logjikën e hartave dhe shkallës, ndërkohë që bota ka kaluar tek imazheria dhe pixeli. Vazhdohet me mendësinë e interpretimit të hartave dhe pasqyrës së realitetit aktual, ndërkohë që bota po kalon drejt inteligjencës artificiale dhe kuptimit në kohë reale të sjelljes dhe ndryshimit të sjelljes së realitetit në kohë. Kërkohet të planifikohet zgjidhja e problemeve të së shkuarës në të tashmen, ndërkohë që bota ka kaluar tek shfrytëzimi i potencialeve të së tashmes për të projektuar të ardhmen.

Çështjet kryesore që duhet të adresohen nëpërmjet politikës mbi zhvillimin e sektorit të IG janë:



-Rritja e përdoruesve dhe shërbimeve në mënyrë harmonike progresive, duke e kthyer ciklin *'nuk kemi përdorues pasi nuk kemi IG e dubur'*, përkundrajt *'nuk kemi IG e dubur, cilësor, në kohë reale pasi nuk kemi përdorues për ta vënë në përdorim'* në një cikël pozitiv;

-Mendësia lokale dhe dija lokale (duhettë mos i përcaktohen kufij dijes dhe informacionit);

-Balancimi, koordinimi dhe harmonizimi i rritjes për t'i marrë vlerën e shtuar;

-Koncepti i rritjes i fokusuar drejt të ardhmes dhe jo drejt problemeve të së shkuarës apo të tashmes.

Deklarata e Politikës nr.12 “Mbi zhvillimin e sektorit të IG”:

“Identifikimi i drejtimeve të zhvillimit të vendit në sektorin e IG, bazuar në politika dhe strategji që do bëjnë një kapërcim thelbësor në qasjen ndaj IG, duke ndjekur trendet globale të informacionit dhe teknologjisë, si dhe ngritjen dhe fuqizimin e ASIG për ta shndërruar në lider për ofrimin e shërbimeve brenda vendit dhe në rajon.”

Zhvillimi i sektorit nuk ka të bëjë me zgjidhjen e problematikave aktuale në sektor por me kalimin në hapin tjetër, në të ardhmen. Ai lidhet me rritjen harmonike dhe jo me përmirësimin e situatës pa u rritur dhe pa i marrë në konsideratë variablat e ndryshuar të së ardhmes.

Nëpërmjet kësaj politike synohet rritja e përdoruesve dhe shërbimeve cilësore në mënyrë të vazhdueshme dhe harmonike, duke ekzistuar në funksion të njëra-tjetrës, për të realizuar procesin “përdorues të shumtë sepse kemi IG e duhur” dhe e anasjellta.

Zhvillimi i sektorit synon që të ketë dije dhe informacion pa kufij, që të mund të shtrihen jashtë vendit dhe përtej kufijve të dijes lokale. Megjithëse ekziston një shtrirje e përcaktuar territoriale për IG e një vendi, karakteri i tij është i tillë që krijon treg ndërkombëtar ndaj zhvillimi është i pakufizuar dhe domosdoshmërisht pjesë e rrjeteve globale.

Politika mbi zhvillimin e sektorit synon rritje ku të gjithë elementët e sistemit janë të balancuar dhe jo vetëm në teknologji, janë të harmonizuar me njëri-tjetrin për të shmangur moskoordinimin, me qëllim rritjen në të gjithë drejtimet për të përfutur vlerën e shtuar në kohë të shpejtë dhe në të gjithë sistemin.

Së fundmi synohet ekzistenca e kuptimit të rritjes, për të formësuar kështu vizionin dhe vullnetin e mirë bazuar në ndryshimet dhe përmirësimet e situatës aktuale, për të arritur nivelin e dëshiruar për të ardhmen. Duhet që mendësia të jetë e orientuar në përdorimin e trendeve të fundit në mënyrë që zhvillimi të jetë në përputhje me realizimin e synimit për ta shndërruar ASIG në liderin e rajonit.

Masat për jetësimin e politikës nr. 12:

12.1 Hartimi dhe zbatimi i zhvillimit strategjik sektorial (planeve strategjike, programeve dhe projekteve të zhvillimit të sektorit) që i jep zgjidhje çështjes së mungesës së planifikimit strategjik të integruar për të gjithë sektorin. *Realizimi i masës do të ketë impakt pozitiv në pasjen të qartë të drejtimeve strategjike për secilin aktor të sektorit si dhe detyron pëmbushjen e masave të përcaktuara në programet përkatëse, deri më tani të papërcaktuara në dokumente. Kjo masë e jetëson politikën e zhvillimit nëpërmjet përcaktimit të mënyrave, kohës dhe instrumenteve për pëmbushjen e detyrave specifike të programeve dhe projekteve.*

12.2 Fuqizimi dhe ofrimi i të gjitha shërbimeve në imazheri për forcimin e kapaciteteve (tokë, det, ajër, kamera 360°, sonarë, etj.). *Kjo masë e jetëson politikën sepse bën të mundur që të realizohet synimi për të qenë avangardë dhe për të parë përtej kontekstit lokal duke ofruar imazheri për të gjithë rajonin.*

12.3 Krijimi dhe funksionimi i gjeoportalit rajonal për të ofruar shërbime në rajonin e Ballkanit Perëndimor për një sërë temash, të cilat nuk kanë kufij të ndarë ndërmjet vendeve (si ato mjedisore, për turizmin, mbi transportin, etj.). *Kjo masë është mundësi e mirë zhvillimi duke qenë se ASIG deri më sot ka dëshmuar faktin e të qenurit lider në rajon dhe mund të jetë bashkëpunues efektiv në kuadër të zhvillimit të informacionit gjeohapësinor në tërësi. Masa e jetëson politikën duke e shtrirë zhvillimin e sektorit jo vetëm në vendin tonë, por edhe në rajon, duke qenë se edhe në thelb informacioni gjeohapësinor nuk mund të jetë i kufizuar vetëm brenda një kufiri të caktuar, por ndërvepron dhe merr nga elementët e IG të vendeve fqinje.*

12.4 Implementimi i inteligjencës artificiale brenda një periudhe 10 vjeçare mund të bëhet në shërbime kryesore, kryesisht në transport për identifikimin e trafikut në kohë reale në qytetet kryesore të Shqipërisë, gjë e cila mund të implementohet më vonë edhe për vendet e rajonit. *Shkëputja drejt inteligjencës artificiale e jetëson politikën për zhvillimin, sepse është një hap i madh i cili mundëson*

njoburi/knowledge në kohë reale. Megjithatë kostot për teknologjitë e realizimit të inteligjencës artificiale mund të jenë të mëdha, impakti që do të ketë në ecurinë e zhvillimit do të jetë pozitiv, sepse perfeksionin procesin e përpunimit dhe ofrimit të të dhënave


3. ZBATIMI I POLITIKAVE

3.1 PROGRAMI I MASAVE PËR JETËSIMIN E POLITIKAVE

Pema/Sistemi i Politikave

Sistemi i politikave të lartpërmendura dhe të detajuara nëpërmjet masave përkatëse, referuar

sektorit të informacionit gjeohapësinor, mund të konceptohet si një sistem pemë i politikave, duke u zbërthyer në këto elementë: Disponueshmëria e Informacionit Gjeohapësinor, Përdorimi i Informacionit Gjeohapësinor, Funksionaliteti i Sistemit IG, Administrimi i Sektorit IG




Politikat mbi informacionin gjeohapësinor janë të lidhura në sistem dhe nuk janë lineare dhe as një listë dëshirash, por japin e marrin në mënyrë të ndërsjelltë me njëra-tjetrën, ndaj nuk duhen parë të shkëputura por vetëm në mënyrë të integruar. Lidhja e tyre është si ciklike ashtu dhe hierarkike, duke formësuar një sferë të politikave.

Dymbëdhjetë politikat grupohen sipas 4 Synimeve afatgjata, përkatësisht:

- Politikat për të garantuar pasjen e informacionit gjeohapësinor (Politikat Nr.1, Nr.2, Nr.3), që lidhen me Synimin afatgjatë I “Disponueshmëria e informacionit gjeohapësinor”;
- Politikat për sigurimin e përdorimit optimal të informacionit gjeohapësinor (Politikat Nr.4, Nr.5, Nr.6), që lidhen me Synimin afatgjatë II “Përdorimi i informacionit gjeohapësinor”;
- Politikat për sistemin e informacionit gjeohapësinor (Politikat Nr.7, Nr.8, Nr.9), që lidhen me Synimin afatgjatë III “Funksionaliteti i Sistemit të Informacionit Gjeohapësinor Shtetëror”;
- Politikat për qeverisjen e sektorit (Politikat Nr.10, Nr.11, Nr.12), që lidhen me Synimin afatgjatë IV “Mirë Administrimi i Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor”.

Për secilin nga 12 drejtimet politike, detajohen vetëm masat kryesore të cilat i adresohen situatës aktuale në Shqipëri dhe i përshtaten realitetit natyror, social, ekonomik dhe politik të vendit, ku në total janë 50 masa:



3.1.2 Prioritetet e Politikave

Prioritetet sipas renditjes që ka rezultuar për të 12 drejtimet politike gjatë procesit të vlerësimit të tyre, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

POLITIKAT PRIORITARE	RENDITJA (ku 1 vlerësohet si më prioritar)
Politika 4 <i>"Përgjegjësia & detyrimi për përdorimin nga institucionet publike"</i>	1
Politika 6 <i>"Promovimi & ndërgjegjësimi për përdorimin e IG nga publiku"</i>	2
Politika 2 <i>"Gjenerimi i IG të duhur"</i>	3
Politika 9 <i>"Infrastrukturë & teknologji funksionale dhe e rrjetëzuar"</i>	4
Politika 8 <i>"Dije Institucionale & Kapacitete Njerëzore në Sektorin e IG"</i>	5
Politika 12 <i>"Mbi zhvillimin e sektorit të IG"</i>	6
Politika 3 <i>"Aksesimi i lirë & pa pengesë i IG"</i>	7
Politika 7 <i>"Organizim Institucional Funkcional"</i>	8
Politika 10 <i>"Financim i qëndrueshëm i sektorit IG"</i>	9
Politika 1 <i>"Përcaktimi i kërkesës dhe zgjidhjes së duhur për IG"</i>	10
Politika 5 <i>"Partneritet & Përfitim reciprok me sipërmarrjet private"</i>	11
Politika 11 <i>"Mirërregullimi i të drejtave dhe detyrimeve"</i>	12

3.1.3 Programi i Integruar i Masave

Sekuencimi logjik i masave brenda çdo politike apo midis politikave të ndryshme, realizohet duke konsideruar marrëdhënien e varësisë që mund të kenë me njëra-tjetrën (nëse mund të fillojnë njëkohësisht, apo nëse një masë duhet të fillojë me përfundimin e tjetrës, nëse janë të lidhura duke filluar dhe përfunduar njëkohësisht, apo edhe nëse janë të lidhura që vetëm të përfundojnë njëkohësisht pavarësisht se kur kanë nisur, si dhe të tjera kombinime të ndryshme).

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e

llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 954 880 (nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 954 880 (nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekësh, do të përballohet nga buxheti i vitit 2020, i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në programin buxhetor “Planifikimi urban”.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare”.

7. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Himarë.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Himarë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Himarë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të shtetit, Bashkia Himarë.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Himarë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit, Bashkia Himarë, për pasurinë e shpronësuar.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Himarë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Himarë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



**Lista e pronarëve të pasurisë pronë private që preken nga realizimi i projektit
"Rikualifikim urban Sheshi Borsh, Himarë".**

Nr	Emër Mbiemër	Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Rrethi	Sip. e ndërtimit (m2)	Sip. e truallit (m2)	Çmimi i ndërtimit (l/m2)	Çmimi i truallit (l/m2)	Vlera e ndërtimit (lekë)	Vlera e truallit (lekë)	Vlera Totale (lekë)	Shënime
1	Bashkëpronarët Bisha, Leka, Shimani, Beluli, Dibra, Huta, Vokopola, Lleshi, Xhaferaj	ZK. 1253	56/33/2	Sarandë, Borsh	—			2,560	—	954,880.00	954,880.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Sarandë me shkresën nr. 13021 prot., datë 15.01.2018. Pasuri e llojit "Truall".
VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT											954,880.00	

Shënime

1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM nr.514, datë 30.7.2014
2. Pasuritë e prekura nga projekti, konfirmohen nga ZVRPP, Vlorë, me shkresën nr.13 prot., datë 15.1.2019

**VENDIM****Nr. 405, datë 20.5.2020****PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË
ZHVILLIMIT TË SHËRBIMEVE TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR
NË SHQIPËRI 2020-2025**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor në Shqipëri 2020-2025, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, institucionet e saj të varësisë si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****STRATEGJIA E ZHVILLIMIT
TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR PARËSOR NË SHQIPËRI
2020-2025****PJESA E PARË: KONTEKSTI
STRATEGJIK****1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit**

Kujdesi Shëndetësor Parësor konsiderohet shërbim themelor në përpjekjet e Sistemit Shëndetësor Shqiptar për kontrollin e sëmundjeve dhe mbrojtjen e shëndetit të të gjithë qytetarëve.

Strategjia e Kujdesit Shëndetësor Parësor (KSHP) në Shqipëri ndërtohet për herë të parë, por është hartuar mbi një traditë të mirëkonsoliduar tashmë. Në të pohohet se pjesa dërrmuese e kontakteve që popullsia ka me sistemin shëndetësor realizohen në nivelin e Qendrave Shëndetësore dhe shumë probleme shëndetësore trajtohen nga mjekët e përgjithshëm ose edhe infermierët në strukturat e kujdesit shëndetësor parësor. Pavarësisht kësaj, ndryshimet demografike

dhe epidemiologjike, pritshmëritë gjithnjë në rritje ndaj kujdesit shëndetësor, së bashku me rreziqet e larta të shtimit të pabarazive, kërkojnë më shumë mbështetje, përshtatje dhe reforma në kujdesin shëndetësor parësor.

Kjo strategji do të përcaktojë rrugën e përgatitjes së sistemit të kujdesit shëndetësor parësor që do të adresojë në mënyrë më të mirë dhe efikase nevojat shëndetësore e të gjitha komuniteteve dhe kategorive të popullatave. Akses më i mirë i komuniteteve vulnerabël në shërbimet e kujdesit shëndetësor do të arrihet nëpërmjet një integrimi më të mirë horizontal të profesionistëve të ndryshëm të specializuar, që punojnë në nivel komuniteti, si dhe integrimi vertikal (vijueshmëria e kujdesit midis KSHP dhe spitalit/specialiteteve të tjera të fushës). Sipas saj, do të krijohen modele të reja shërbimesh për të mbuluar nevojat më urgjente që janë identifikuar në nivel komuniteti, të tilla si parandalimi dhe kontrolli i sëmundjeve jo të trasmetueshme (SJT), shërbimi i kujdesit në familje për të moshuarit, modelet e kujdesit përmes teknologjisë digjitale, veçanërisht në zonat e thella, etj.

Gjithashtu, strategjia KSHP ka për qëllim të përmirësojë reputacionin, vetëvlerësimin dhe motivimin e punonjësve të Kujdesit Shëndetësor Parësor. Së fundmi, strategjia do të shërbejë për të arritur vizionin politik të një sistemi Shëndetësor Kombëtar të orientuar ndaj mbulimit universal.

Strategjia paraqet një vizion të ri të KSHP duke përcaktuar prioritetet, objektivat dhe ndërhyrjet të qarta. Nuk detajon çdo aktivitet duke mundësuar ndryshimin gradual që nuk do të cenojë përfitimet e arritura tashmë nga sistemi dhe strukturat që janë funksionale.

2. Kuadri ligjor dhe institucional

2.1 Korniza e përgjithshme ligjore, mbi bazën e të cilës organizohet dhe realizohet strategjia.

Në bazë të ligjit nr. 10107, datë 30.03.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, KSHP në Shqipëri sigurohen përmes një rrjeti profesionistësh dhe institucioneve shëndetësore, bazuar në principet e Mjekësisë së Familjes, ndërkohe që Ministria aprovon rregullat për organizimin dhe funksionimin e këtyre shërbimeve. Ministria vendos mbi shpërdarjen e institucioneve të KSHP, mbi përbërjen e stafit, si dhe menaxhimin e llogaridhënien në çdo qendër shëndetësore.



Ligji nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për Shëndetin Publik”, përcakton funksionet dhe shërbimet e shëndetit publik si dhe rolin e shtetit në shpërndarjen e përgjegjësi në mes të institucioneve. Një pjesë e shërbimeve të shëndetit publik ofrohen nëpërmjet institucioneve të KSHP.

Kjo strategji i jep përgjigje disa sfidave në kontekstin e ri të krijuar pas vendimit nr. 419, datë 4.7.2018, Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, ka krijuar një bazë të re organizative dhe menaxheriale për KSHP. Operatori Kombëtar i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe degët rajonale të tij janë një realitet i ri në shëndetësi me përgjegjësi për organizimin dhe ofrimin e shërbimeve të KSHP, shëndetit publik, dhe ato spitalore.

Strategjia merr parasysh rregullat e financimit të shërbimeve dhe institucioneve të KSHP bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 737, datë 5.11.2014, “Mbi financimin e shërbimeve publike të kujdesit shëndetësor në KSHP nga skema e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor”.

Gjithashtu, kjo strategji, përcakton edhe nevojën për adaptim të Paketës së shërbimeve shëndetësore, në KSHP publik që financohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor miratuar me vendim nr. 101 datë 4.2.2015.

Ndikim në mbështetjen e KSHP, sidomos lidhur me mirëmbajtjen e infrastrukturës së qendrave shëndetësore, ka edhe ligji nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (ndyshuar me ligj nr.9208, datë 18.3.2004).

Strategjia e zhvillimit të KSHP ndërtohet gjithashtu në përputhje me dokumentat e tjerë të programit të Qeverisë së Shqipërisë, në veçanti me Strategjinë Kombëtare për Shëndetin 2016-2020, Plani i kontrollit të SJT 2016-2020, Plani i veprimit të Promocionit Shëndetësor 2017-2021, etj

Strategjia e Zhvillimit të KSHP 2020-2025 hartohet në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015-2020 (Komponenti: ‘Investimi tek Kapitali Social’, dhe Synimi ‘Një sistem i kujdesit shëndetësor më i fortë dhe më i aksesueshëm’) sipas vizionit “Shqipëria – një demokraci në forcim, në rrugën drejt integritetit të saj në Bashkimin Europian, me një ekonomi

konkurruese, të stabilizuar dhe të qëndrueshme, që garanton të drejtat themelore dhe liritë e njeriut”.

Kjo strategji është gjithashtu në linjë me standartet dhe dokumentet ndërkombëtare duke u bazuar në principet e mbulimit universal me kujdes shëndetësor sipas Kornizës Europiane të Organizatës Botërore të Shëndetësisë ‘Mbi ofrimin e integruar të shërbimeve shëndetësore’ 2016.

Ajo është një përgjigje e duhur lidhur me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-SDK) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara:

Synimi 3. Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat.

2.2 Sfida të qeverisjes, organizimit dhe kapaciteteve të sistemit të KSHP

Qeverisja dhe organizimi i kujdesit shëndetësor në Shqipëri kanë për qëllim garantimin e llogaridhënies publike të institucioneve, inkurajimin në të njëjtën kohë të motivimit të profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe efikasitetin më të madh në ofrimin e shërbimit.

Vendi po i nënshtrohet reformave të rëndësishme strukturore: bashkimi i institucioneve të politikëbërjes shëndetësore dhe sociale në nivel kombëtar, një reformë institucionale që ka çuar në krijimin e institucioneve të reja, të tilla si Operatori Kombëtar i Kujdesit Shëndetësor me 4 drejtoritë e tij rajonale të cilat po marrin përsipër një seri funksionesh të planifikimit dhe administrimit të kujdesit shëndetësor në fushën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor dhe dytësor. Këto zhvillime kanë pasuar një reformë të gjerë territoriale me integrimin e komuniteteve të vogla në bashki më të mëdha si dhe me një proces decentralizimi që synon të ofrojë më shumë fuqi dhe përgjegjësi në nivelin e qeverisjes vendore.

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, ka pasur rritje të numrit të vizitave në shërbimet e KSHP duke u nxitur dhe nga nevojat shëndetësore në rritje, aksesin më i mirë në shërbime dhe ndryshimeve në sjelljen ndaj shëndetit. Sidoqoftë, edhe pse në vitin 2017 u realizuan 7,942,742 vizita në institucionet e KSHP me një mesatare prej 2.7 vizitash për banor në vit, treguesi mbetet i ulët në krahasim me vendet e tjera Europiane.

Në 413 qendrat shëndetësore në Shqipëri punojnë 1,538 mjekë të përgjithshëm, (numri i mjekëve specialistë është 287) dhe 6,864 infermierë e laborantë. Ndërkohë janë 1656 pozicione të



planifikuara për mjekë dhe 7017 për infermierë. Mjekët e KSHP kryejnë mesatarisht 11.3 vizita në ditë, me diferenca të mëdha mes zonave urbane dhe zonave rurale.

Shpërndarja gjeografike e popullatës ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme ndërkohë që organizimi territorial i KSHP nuk ka ndryshuar shumë gjatë 30 viteve të fundit. Qendrat shëndetësore dhe pikat ambulatorë janë të shpërndara në mënyrë të pabarabartë në mbarë vendin, ku qytetet e mëdha kanë qendra shëndetësore që mbulojnë një popullatë dhjetëfish më të madhe në krahasim me qendrat në zonat rurale. Në Tiranë apo qytete të tjera të mëdha, kapaciteti i qendrave shëndetësore është më i madh në kuptimin e personelit mjekësor dhe disa shërbimeve të veçanta, të tilla si: konsultori i fëmijës dhe gruas. Nevojitet një rishpërndarje territoriale e qendrave shëndetësore dhe, në mënyrë që të krijohen modele shërbimesh të reja gjithëpërfshirëse e të integruara të mjekësisë së familjes dhe mbështetjes sociale, në zona me nevoja më të mëdha dhe kapacitetet e duhura, do të pilotohet një nivel i ri i qendrës së kujdesit shëndetësor; Qendra e Mjekësisë Familjare.

Përmirësimi i qëndrueshëm i infrastrukturës së institucioneve të KSHP mbetet një sfidë për Shqipërinë. Sipas ligjit për Qeverisjen Vendore, Bashkitë janë përgjegjëse për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e godinave të KSHP, së bashku me aktivitete të tjera të edukimit dhe promocionit në nivel vendor, por kjo funksionon vetëm në shume pak zona administrative. Në të vërtetë, shumica e QSH-ve dhe truallit janë në pronësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ministria ka nisur një program investimesh në qendrat shëndetësore në mbarë vendin, por për të pasur rezultate të qëndrueshme, duhet mirëmbajtur infrastruktura e re dhe duhen përmirësuar vazhdimisht standardet në këtë fushë. Për këtë, ashtu siç është përmendur edhe më sipër në këtë dokument, nevojitet një angazhim i ri i bashkive lidhur me KSHP, harmonizimi i rolit të të gjithë aktorëve, si dhe sigurimi i burimeve të mjaftueshme në nivel të qeverisjes vendore dhe të institucioneve të KSHP, etj.

Studimet tregojnë se vështirësitë financiare për shkak të kujdesit shëndetësor kanë më shumë gjasa të ndodhin kur shpenzimet publike për shëndetin

janë të ulëta në raport me Prodhimin e brendshëm bruto (PBB) dhe pagesat direkte nga xhepi përbëjnë një përqindje relativisht të lartë të shpenzimeve totale për shëndetin (Xu et al. 2003; Xu et al., 2007; WHO, 2010). Shpenzimet publike për shëndetësinë në Shqipëri përbëjnë 2.9% të PBB-së, krahasuar me mesataren prej 3.7% për vendet me të ardhura të mesme e të larta në Rajonin Europian të OBSH-së.

Përmirësimi i cilësisë në shërbimet shëndetësore është një proces i vazhdueshëm. Gjatë vitit 2018 ka pasur disa zhvillime të rëndësishme lidhur me cilësinë në SHKP në Shqipëri. Kështu, ka filluar procesi i akreditimit të Qëndrave Shëndetësore dhe janë miratuar disa shtesa në Ligjin e Kujdesit Shëndetësor, të cilat parashikojnë aplikimin e auditit klinik. Për realizimin e kësaj kërkesë ligjore është e domosdoshme rishikimi dhe miratimi i udhërrefyesve e protokolleve klinike të bazuar në fakte dhe të zbatueshem në kushtet e vendit tonë.

2.3 Sfida të lidhura me tranzicionin epidemiologjik dhe menaxhimin e përshtatshëm të sëmundjeve jo të trasmetueshme

KSHP në Shqipëri kanë qenë tradicionalisht të organizuara për të përballuar sfidat e shëndetit të nënës dhe fëmijës, dhe sot duhet të përshtaten me nevojat specifike të lidhura me shtimin e barrës së SJT.

Sëmundjet jo të trasmetueshme përbëjnë barrën më të madhe për sistemin shëndetësor shqiptar dhe gjithë shoqërinë shqiptare. Ato janë shkaku më i rëndësishëm i vdekjeve të parakohshme dhe i humbjes së viteve të jetës së shëndetshme në vendin tonë. Ky grup sëmundjesh ka pësuar një rritje sinjifikante gjatë dy dekadave të kaluara, një trend që pritet të vazhdojë dhe në të ardhmen si pasojë e rritjes së jetëgjatësisë dhe moshimit të popullatës shqiptare. Një pjesë e rëndësishme e këtyre sëmundjeve mund të menaxhohen dhe kontrollohen pranë KSHP, në mënyrë më kosto efektive dhe pa qenë e nevojshme shtrimi apo trajtimi në spital. Numrin më të madh të rasteve të regjistruara pranë KSHP e përbëjnë dy grupe sëmundjesh; sëmundjet e qarkullimit të gjakut, apo kardiovaskulare (ku shumicën dërrmuese e përbën hipertensioni) me pothuaj 389 000 raste dhe ato endokrine (ku shumicën dërrmuese e përbën diabeti) me rreth 135 000 raste.

Duhet nënvizuar se disa probleme shëndetësore kronike si hipertensioni dhe diabeti, megjithëse



klasifikohen si sëmundje të mirëfillta, shpesh konsiderohen edhe si faktorë risku për sëmundjet e tjera të qarkullimit të gjakut, që janë kërcënuese për jetën. Për këtë arsye përmes kontrollit të tyre mund të parandalohen, si barra e këtyre sëmundjeve në sistemin shëndetësor, ashtu edhe vitet e pashëndetshme të jetës dhe vdekjet e parakohshme. Që të jetë efektiv, kontrolli i tyre duhet të jetë gjithëpërfshirës; parandalim primar përmes mbështetjes së jetës së shëndetshme, diagnostikim i hershëm dhe menaxhim i mirë përmes këshillimit dhe mjekimit.

Në Shqipëri vërehet një rritje e qëndrueshme e rasteve të trajtuara pranë shërbimeve të KSHP për hipertensionin dhe diabetin. Programi i kontrollit shëndetësor bazë për personat 35-70 vjeç ka kontribuar në mënyrë sinjifikative për rritjen e identifikimit dhe ndjekjes së këtyre dy problemeve shëndetësore në KSHP. Kështu, për vitin 2015 (kur ka filluar ky program) vërehet një rritje prej mbi 30% për diabetin dhe mbi 12% për tensionin e lartë arterial, krahasuar me vitin paraardhës (Raporti i SJT 2018). Megjithatë, Studimi Demografik e Shëndetësor (ADHS 2018) dëshmon një prevalencë shumë të lartë të hipertensionit të pakontrolluar në popullatë, ndërkohë që ende një pjesë shumë e madhe e individëve me hipertension nuk janë të ndërgjegjshëm për këtë. Duket se identifikimi i hershëm dhe menaxhimi efektiv i hipertensionit është një sfidë parësore për KSHP në Shqipëri.

Gjithashtu, KSHP duhet të përshtatet me nevojat specifike të popullatave vulnerabël (të moshuar të izoluar, personat me aftësi të kufizuara, komuniteti rom, etj.) Ata janë më shumë të ekspozuar ndaj rreziqeve shëndetësore dhe janë kategoritë më pak të mbrojtura nga pasojat negative të këtyre rreziqeve. Aktualisht, shërbimet e KSHP për grupet e cënueshme janë të ndara nga shërbimet sociale. Të dyja shërbimet duhet të jenë më të koordinuara dhe më të integruara.

2.4 Metodologjia e ndërtimit të strategjisë

Ky dokument strategjik është bazuar në një analizë shumë dimensionale të sistemit të KSHP në Shqipëri dhe faktorëve të lidhur me të. Në këtë kuadër, në mënyrë specifike është kryer një vlerësim i KSHP bazuar në modelin e 'WHO European Framework for Action on Integrated Health Service Delivery' dhe në instrumentat e monitorimit të propozuar nga Qendra Europiane e

OBSH për KSHP. Janë kontaktuar dhe intervistuar në 46 qendra shëndetësore e ambulanca në zona të ndryshme të Shqipërisë 73 profesionistë shëndetësorë të KSHP (drejtorë, mjekë, infermierë), të cilët mbulonin një popullatë prej më shumë se 180 000 banorësh. Gjithashtu janë intervistuar 25 informues kyç në 15 institucione relevante në nivel qendror dhe lokal.

Strategjia është ndërtuar gjatë një pune 6 mujore nga një grup ndër-disiplinar me specialistë të fushave të ndryshme të KSHP. Puna e grupit është mbështetur nga ekspertë ndërkombëtarë të fushës.

3. Vizioni i strategjisë mbi shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor në Shqipëri

3.1 Vizioni i KSHP:

Shërbime të KSHP që mbrojnë dhe përmirësojnë shëndetin e komunitetit duke parandaluar sëmundjet, duke ofruar shërbime të bazuara në fakte, duke trajtuar në mënyrë proaktive pabarazitë, nëpërmjet mbulimit të grupeve vulnerabël, dhe duke reduktuar nevojën për shërbime të shmangshme spitalore. Shërbimet ofrohen pavarësisht gjinisë, kombësisë apo statusit ekonomik.

Parimet/vlerat mbi të cilat bazohen shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor

- Respekti për pacientin/qytetarin: Në institucionet e kujdesit shëndetësor parësor, të gjithë trajtohen me vëmendjen, mirësjelljen dhe kujdesin e duhur; shërbimet përqëndrohen te pacientët dhe ata mbështeten për shëndetin e tyre;

- Puna në ekip: Personeli i kujdesit shëndetësor bashkëpunon për të siguruar transparencën dhe për të bërë më të mirën për pacientët e tyre.

- Cilësia: Praktika bazohet në parimin e mjekësisë bazuar në fakte dhe synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

- Gjithëpërfshirja: Komunitetet dhe konsumatorët përfshihen në menaxhimin strategjik dhe në vlerësimin e performancës të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor.

- Vijmësia e kujdesit: shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor garantojnë lidhjen dhe koordinimin me nivelet e tjera të sistemit shëndetësor, me komunitetin dhe shërbimet sociale.

- Kosto-efektiviteti: në kujdesin shëndetësor parësor prioritizohen shërbime dhe praktika klinike që ofrojnë kontroll të problemeve shëndetësore me koston më të ulët.



Synimet e Strategjisë

Kjo strategji ka për qëllim :

-Të rrisë cilësinë dhe spektrin e shërbimeve në KSHP, çka do të sjellë:

-uljen e numrit të referimeve në shërbimet sekondare, terciare dhe në shërbimet e urgjencës;

-rritje të kënaqësisë së pacientëve; dhe

-rritje të reputacionit të mjekëve të familjes.

-Të ofrojë shërbime shëndetësore dhe sociale të integruara për t'iu përgjigjur nevojave individuale të individëve dhe grupeve në nevojë;

-Të përmirësojë aksesin për marrjen e shërbimeve dhe sigurojë kujdes shëndetësor të koordinuar e në vijimësi nëpërmjet bashkëpunimit me mjekun specialist;

-Të përgatisë sistemin shëndetësor për sfidat e mundshme, përfshirë rritjen e nevojave për shërbime dhe përballjen me mungesë të personelit shëndetësor duke promovuar rolin e infermierëve në qendrat shëndetësore të KSHP dhe infermierët në komunitet.

3.2 Treguesit e ndikimit të strategjisë

1. Rritje me 1 vit të jetgjatësisë së shëndetshme (vitet e jetës pa sëmundje) ;

2. Rritje me 10% e përdoruesve (numrit të vizitave) të shërbimeve të KSHP ;

3. Ulje me 5% e shtrimeve në spital të rasteve me sëmundje të trajtueshme në KSHP (Hipertension, diabet, astma, SPOK, depression etj) ;

4. Ulje me rreth 10% e proporcionit të personave që nuk e përdorin KSHP megjithëse kanë nevojë për shërbimet, në kategori të caktuara të popullatës.

PJESA E DYTË: QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË STRATEGJISË

Fushat e prioritetit strategjik për zhvillimin e KSHP në Shqipëri

Janë identifikuar 9 politika prioritare për zhvillimin e KSHP në Shqipëri:

1. Forcimi institucional për një qeverisje më të mirë të KSHP;

2. Burimet njerëzore në sistemin e KSHP;

3. Infrastruktura dhe teknologjia shëndetësore në institucionet e KSHP;

4. Sistemi i informacionit të KSHP;

5. Shërbimet bazë të KSHP për Mbulimin Shëndetësor Universal;

6. Financimi dhe kontraktimi për Mbulimin Shëndetësor Universal;

7. Përcaktimi, pilotimi i tipeve të reja të shërbimeve dhe rishpërndarja gjeografike;

8. Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve të KSHP;

9. Menaxhimi i institucioneve të KSHP.

Për secilën politikë prioritare, është paraqitur një analizë e shkurtër e nevojave, janë përcaktuar, objektivat e përgjithshëm dhe specifike, si dhe listuar ndërhyrjet apo aktivitetet për ndryshim. Për çdo objektiv janë parashikuar gjithashtu disa tregues kryesorë të performancës dhe rezultate të pritshme.

3.2 Politika 1. Forcimi institucional për një qeverisje më të mirë të KSHP

Konteksti dhe çështjet për t'u adresuar

Qeverisja dhe organizimi i institucioneve të KSHP kanë të bëjnë me rregullat e tyre të funksionimit, menaxhimit, marrëdhëniet ndër-institucionale brenda dhe jashtë sistemit shëndetësor, normat e shpërndarjes në terren, si dhe me funksionimin e integruar të të gjitha shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor për të mundësuar ofrimin e paketës së cilësisë më të mirë të kujdesit duke marrë parasysh burimet e vendit.

Reforma në organizimin e kujdesit shëndetësor ka cuar në krijimin e institucioneve të reja, të tilla si Operatori Kombëtar i Kujdesit Shëndetësor me 4 drejtoritë e tij rajonale të cilat po marrin përsipër një seri funksionesh të planifikimit dhe administrimit të kujdesit shëndetësor në fushën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor dhe dytësor. Duke qenë se këto janë institucione të sapokrijuara, është e nevojshme që ato të forcohen në funksion të planifikimit dhe administrimit më të mirë të sistemit të KSHP. Gjithashtu, roli i tyre do të zgjerohet më tej, duke kaluar nga kontrolli, në mbështetjen e institucioneve ofruese të KSHP. Për më tepër, Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2020 përcakton që bashkitë duhet të kenë më shumë kompetenca dhe të jenë më përgjegjëse për çështje të tilla si: planifikimi i rrjetit të institucioneve të KSHP, duke përfshirë rehabilitimin e ambienteve, blerjen e pajisjeve.

Integrimi i kujdesit shëndetësor me mbështetjen sociale është realizuar tashmë në nivelin qendror të menaxhimit shëndetësor. Integrimi do të shtrihet deri te shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor, veçanërisht duke mbajtur parasysh që qeveria ka



prioritet të ofrojë mbulimin universal, pra të trajtojë personat më vulnerabel me një paketë bazë shërbimesh. Shërbimet tradicionale të kujdesit shëndetësor parësor do të përvetësojnë më shumë elementë të mbrojtjes sociale, duke përmirësuar njëkohësisht koordinimin midis sistemit shëndetësor dhe shërbimeve sociale në nivel bashkiak. Ndërkohë reforma e gjerë territoriale ka cuar në integrimin e komuniteteve të vogla në bashki më të mëdha si dhe pritjet të sjellë një proces decentralizimi që synon të ofrojë më shumë fuqi dhe përgjegjësi në nivelin e qeverisjes vendore, përfshi këtu edhe përgjegjësi në fushën e shëndetësisë

Misioni i KSHP nënkupton fokusin te shëndeti i komunitetit dhe jo vetëm në shëndetin individual. Një pjesë e rëndësishme e shërbimeve të ofruara në institucionet e KSHP duhet të synojë parandalimin e sëmundjeve dhe promovimin shëndetësor. Shumë programe të shëndetit publik, si për kontrollin e sëmundjeve të transmetueshme dhe atyre kronike (vaksinimi, edukimi, survejanca, depistimi) mund ti arrijnë komunitetet vetëm nëpërmjet shërbimeve të KSHP. Efikasiteti i marrëdhënieve midis njësive të reja vendore të kujdesit shëndetësor dhe qendrave shëndetësore do të përmirësohet më tej në fushën e parandalimit të sëmundjeve dhe vlerësimit të grupeve vulnerabel apo të rrezikuara.

Objekti i përgjithshëm i politikës 1: Përmirësimi i kapacitetit institucional për qeverisje me të mirë të KSHP me përfshirjen e gjithë institucioneve me ndikim.

3.2.1 Objekti i specifik 1 i politikës 1

Të rrisim kapacitetet organizative të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Operatorit të Shërbimit Shëndetësor në nivel qendror, rajonal dhe vendor lidhur me planifikimin strategjik dhe monitorimin e performancës së KSHP.

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme

- Kryerja /hartimi i planeve strategjike të zhvillimit institucional së bashku me një plan të zhvillimit Institucional (Plan Biznesi) për Operatorin Kombëtar (OK)/4 Operatorët Rajonalë (OR) që do të përfshijnë:

- Misionin, vizionin dhe objektivat e secilës organizatë;

- Zhvillimin dhe konsolidimin e strukturave dhe të sistemeve përkatëse;

- Përcaktimin e programeve dhe të shërbimeve;

- Zhvillimin e kapaciteteve të personelit;

- Buxhetin;

- Kapacitetet komunikuese.

- Zhvillimi me përparësi i kapaciteteve për monitorimin dhe matjen e performancës së shërbimeve të Kujdesit Parësor. Kjo do të përfshijë veçanërisht:

- Modelet e treguesve dhe të dhënave të standartizuara lidhur me monitorimin e performancës së shërbimeve të KSHP;

- Metodologjinë operacionale lidhur me mbështetjen e auditeve klinike për qendrat shëndetësore;

- Mundësimin e një kulture të vlerësimit në ekip, transparencës dhe feedback-ut.

Ndërtimi dhe konsolidimi i një sistemi të integruar të informacionit shëndetësor në nivelin e kujdesit shëndetësor parësor dhe të shërbimeve të shëndetit publik. Për këtë qëllim, është e nevojshme të arrihet një marrëveshje me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor mbi rolet, bashkëpunimin dhe shmangien e informacionit të duplikuar të mbledhur nga qendrat shëndetësore. Ky sistem i informacionit shëndetësor do të lejojë një njohje të shpejtë dhe dinamike të situatës së treguesve shëndetësor dhe të shërbimeve, duke bërë të mundur që Operatori dhe strukturat e tij të planifikojnë ndërhyrje në varësi të nevojave reale. Gjithashtu, sistemi i informacionit do të bëjë të mundur kthimin e të dhënave të përpunuara (feed-back) në nivelin e qendrave shëndetësore dhe të njësive vendore, me qëllim që këto të fundit të krahasojnë treguesit shëndetësor dhe ato të performancës dhe të marrin masat e nevojshme për përmirësimin e tyre të mëtejshëm.

Fuqizimi i infrastrukturës për Operatorin. Operatori dhe degët e tij rajonale do të plotësohen me personelin e nevojshëm. Forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe krijimi i një kulture të punës në ekip do të jenë objektiva imediate, me qëllim që strukturat e reja të Operatorit të realizojnë funksionet e tyre në nivel optimal. Njëkohësisht, operatori do të pajiset me të gjitha kapacitetet e nevojshme infrastrukturore dhe logjistike për kryerjen e detyrave dhe realizimin e misionit të tij.



Koordinim më i mirë i shërbimeve të kujdesit parësor me shërbimet sociale.

Rezultatet e pritshme

-OKSH-ja ka kapacitetin e mjaftueshëm institucional për hartimin e planeve strategjike shëndetësore rajonale e vendore duke mundësuar pjesëmarrjen e QSH-ve dhe aktorëve të tjerë dhe duke ofruar orientim për procesin;

-Ndërtohet dhe konsolidohet sistemi i informacionit shëndetësor nga qendrat shëndetësore deri tek Operatori, në mbështetje të procesit të hartimit të planeve strategjike dhe operacionale dhe në mbështetje të përmirësimit të treguesve shëndetësor dhe të performancës të ofruesve të shërbimeve;

-Ndërtohet dhe funksionon infrastruktura dhe kapacitetet e Operatorit Kombëtar dhe agjensive të tij;

-OKSH-ja realizon integrimin e masave parandaluese të shëndetit publik dhe monitorimin e SJT-ve brenda sistemit të KSHP;

-Ndërtohet dhe funksionon një model për monitorimin e performancës së KSHP.

3.2.2 Objektivi specifik 2 i politikës 1.

Të forcojmë, përmirësojmë dhe zgjerojmë kapacitetet e rrjetit të institucioneve të Shëndetit Publik

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme

-Përcaktimi i roleve institucionale, që do të siguronin mbështetje më të mirë të QSH-ve nga ana e njësisve vendore të kujdesit shëndetësor në fushën e shëndetit publik; promocioni shëndetësor, vaksinimi, depistimi i kancereve, survejanca e sëmundjeve të transmetueshme dhe jo të transmetueshme, parandalimi i shpërthimeve epidemike, kryerja e kontrollit bazë shëndetësor, vlerësimi i riskut për SJT-të, dhe identifikimi i grupeve të cënueshme;

-Përshtatja e informacionit mbi gjendjen shëndetësore dhe aftësinë e kufizuar në mënyrë të tillë, që të lejojë vlerësimin e shëndetit jo vetëm sipas kategorive demografike, por edhe sociale, (p.sh. të pastrehët/ të papunët), etnike dhe kulturore (p.sh., komuniteti rom);

-Fuqizimi i kapaciteteve për kërkime operacionale në fushat e shërbimeve parandaluese dhe të kujdesit shëndetësor parësor, veçanërisht aplikimin e metodave cilësore të vlerësimit, për të kuptuar dhe adresuar vështirësitë që hasin grupet

vulnerabël në marrjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor;

-Standartizimi i kapaciteteve laboratorike të shëndetit publik në mbështetje të parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve të transmetueshme me potencial epidemik dhe të risqeve mjedisore;

-Ngritja, konsolidimi dhe bërja funksionale e programeve të parandalimit të sëmundjeve kronike, sipas përparësive të Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë dhe integrimi i tyre në strukturat e kujdesit shëndetësor parësor, me përfshirje të veçantë të infermierëve dhe personelit tjetër shëndetësor;

Rezultatet e pritshme:

-Përgjegjësite institucionale lidhur me shëndetin publik janë të bashkërenduara e funksionale midis ISHP, OK, Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NjVKSh) dhe QSH-ve;

-Prioritetet e shëndetit publik identifikohen dhe integrohen më mirë në praktikatat e KSHP;

-Aplikohen mjete dhe forma të reja bashkëpunimi mes KSHP dhe NjVKSh.

3.3.3 Objektivi specifik 3 i politikës 1

Të rrisim rolin e njësisve të qeverisjes vendore (NjQV) në mbështetje të KSHP

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme

-Intensifikim i bashkëpunimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e strukturave në vartësi të saj, me organet e Qeverisjes Vendore me synim përfshirjen më të madhe dhe rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore në proceset e planifikimit, projektimit dhe zbatimit të projekteve të mirëmbajtjes së infrastrukturës së shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor;

-Rishikimi i rolit, buxhetit dhe sigurimi i mbështetjes nga ana e bashkive për mirëmbajtjen e QSH-ve në territorin e tyre, bazuar në legjislacionin ekzistues;

-Mobilizimi i qeverisjes vendore për të kontribuar në mënyrë aktive në përmirësimin e gjendjes shëndetësore të komuniteteve të tyre, përmes organizimit të programeve të përbashkëta të promocionit shëndetësor me NjVKSh;

-Fuqizimi i bashkëpunimit midis Operatorit dhe NjQV lidhur me koordinimin e shërbimeve të mbrojtjes sociale që ofrohet në nivel Bashkie me atë që ofrohet në nivelin e qendrave të kujdesit shëndetësor.



Rezultatet e pritshme

-NJQV-të janë më të angazhuara në proceset e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor; NJQV-të përfitojnë nga dispozitat ligjore dhe buxhetet përkatëse për t'i ofruar QSH-ve mbështetje të qëndrueshme;

-Qendrat e Kujdesit Parësor sigurojnë mirëmbajtje efikase të infrastrukturës së tyre përmes mbështetjes administrative, financiare dhe teknike të NJQV-ve;

-Shërbimet sociale në varësinë e Bashkive ofrojnë shërbime në koordinim të ngushtë me shërbimet sociale të ofruara në nivelin e qendrave shëndetësore.

Ndryshimi strategjik: Rol më i madh qeverisës i Operatorit Shëndetësor dhe Njësive Vendore të Kujdesit për shërbimet e KSHP. Nivel i ri bashkërendimi institucional dhe rritje e qëndrueshme e funksioneve të lidhura me shëndetin komunitar në shërbimet e KSHP

Tregues rezultati për politikën 1

- 100% e OKSH rajonale kanë përgatitur plane biznesi dhe janë pajisur me instrumenta të monitorimit të punës në KSHP;

- 50% e qendrave shëndetësore vlerësojnë në mënyrë sistematike grupet sociale më në nevojë dhe mbështeten nga OKSH dhe institucionet e shëndetit publik të ndërtojnë plane ndërhyrje të integruar në komunitet;

- 100 QSH përfitojnë mbështetje për mirëmbajtjen nga NJQV.

3.3. Politika 2. Burimet njerëzore në sistemin e KSHP

Konteksti dhe çështjet për t'u adresuar

Një personel i motivuar dhe në përshtatje me detyrat është thelbësor për ofrimin e shërbimeve më cilësore të kujdesit shëndetësor parësor. KSHP në Shqipëri ka nevojë për personel të shpërndarë sipas nevojave shëndetësore të komunitetit, i aftë të përshtatet me kërkesën gjithnjë e më komplekse dhe në rritje për shërbime të kujdesit shëndetësor nxitur nga ndryshimet e shpejta demografike, epidemiologjike dhe sociale. Asnjë reformë nuk do të mund të arrijë qëllimet e saj pa adresuar hendekun dhe nevojat lidhur me burimet njerëzore, në veçanti të mjekëve dhe infermiereve që punojnë në këtë sektor.

Pesoneli i KSHP përballet me disa çështje kyçe:

Shumica e mjekëve që punojnë në KSHP janë mjekë të përgjithshëm dhe jo mjekë të specializuar

të familjes. Edukimi pas-universitar për Mjekësinë e Familjes nuk përfiton nga të drejtat e ngjashme që gëzojnë specialitetet e tjera, që e vështirëson ndjekjen e formimit të specializuar të mjekësisë së familjes nga një mjek i përgjithshëm. Ndërkohë ka shumë kategori të disponueshme në nivel të qendrave shëndetësore për punonjësit shëndetësorë (MP për fëmijë, MP për të rritur, MP për të gjitha moshat, mjekë për fëmijë të shëndetshëm në konsultore, mjekë për gra të shëndetshme në konsultore, specialistë, etj.), nuk ka përshkrime/profile të qarta të vendeve të punës për kategoritë e ndryshme të personelit shëndetësor (mjekë dhe infermiere). Prania e kategorive të shumta të profesionistëve shëndetësorë në QSH-të mund të çojë në fragmentimin e shërbimeve të KSHP dhe nevojitet më shumë harmonizim dhe mënjanim të ndarjeve tradicionale mes specialiteteve (psh mjekë pediatër që marrin përsipër të rritur dhe anasjelltas) me një fokus te mjekësia e gjithë familjes, si dhe një kategorizim i ri sipas standardeve ndërkombëtare.

Trajnimi bazë si për mjekët ashtu edhe infermierët e KSHP zhvillohet në spitale, duke pasur pak mundësi për të hasur probleme shëndetësore specifike të KSHP.

Kurse të edukimit të vazhdueshëm mjekësor (EVM) përshtaten më shumë me profilin e shoqatave që i ofrojnë ato se sa me nevojat reale të punonjësve shëndetësorë të institucioneve të KSHP. Shpesh, ato realizohen në kuadër të aktiviteteve, konferencave dhe kanë një kohëzgjatje tepër të shkurtër. Nuk ka ofrues afatgjatë dhe të përhershëm të EVM në nivel kombëtar me fokus te zbatimi i udhërrëfyesve, protokolleve dhe standardeve të reja klinike. Gjithashtu, mungojnë dhe kurse trajnimi në menaxhimin e KSHP ndërkohë që ka një nevojë në rritje për mjekët menaxherë të QSH-së. Institucionet e KSHP dhe ofrues të tjerë shëndetësorë nuk po investojnë mjaftueshëm në trajnimin e profesionistëve të tyre shëndetësorë. Shërbimet e reja që duhet të zhvillohen në kuadër të kësaj strategjie, kërkojnë edhe hartimin e udhëzuesve dhe protokolleve të praktikave, dhe profesionistët shëndetësor do të duhet të trajnohen mbi njohuritë dhe aftësitë e reja.

Ajo çfarë bie në sy në sistemin e KSHP është një numër i madhi infermiereve, edhe pse shpërndarja e tyre varion shumë (nga 7,2 në 34,7 për 10 000 banorë). Potenciali i tyre për të



përmirësuar kapacitetin e KSHP dhe aktivitetet parandaluese në komunitet, aktualisht nuk po shfrytëzohet si duhet. Paketa e shërbimeve bazë në Kujdesin Shëndetësor Parësor përshkruan përgjithësisht kompetencat e kërkuara për mjekët e familjes, por jo për infermierët. Është e nevojshme që të përmirësohet formimi i infermierëve dhe rishikimi i rolit të tyre, në mënyrë që ato të marrin përsipër detyra të reja dhe të luajnë një rol më të madh në ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të komuniteteve.

Trysnia e migrimit të jashtëm e të brendshëm mbetet një kërcënim për të ardhmen duke u reflektuar në uljen e numrit të mjekëve në shërbimin shëndetësor parësor. Gjithashtu ka një ulje të madhe të mjekëve të cilët zgjedhin të specializohen në Mjeksinë e Familjes (në 2019 veç 2 mjekë kanë zgjedhur Mjeksinë e Familjes). Gjithashtu, specializimi në Mjeksinë e Familjes bazohet vetëm në praktikën spitalore, dhe nuk ka arritur të lidhet me praktikën në shërbimin primar. Sfidat do të adresohen me instrumente që synojnë të rrisin cilësinë e kualifikimit, motivimin dhe performancën; gjithashtu do të vijojë të mbështetet prania e mjekëve të përgjithshëm në zonat e thella.

Objektivi i përgjithshëm i politikës 2: Mbështetja e zhvillimit të burimeve njerëzore të qëndrueshme e cilësore në fushën e KSHP

3.3.1. Objektivi specifik 1 i politikës 2

Të mbështesim mjekët e përgjithshëm për t'u bërë mjekë familje

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme:

- Ngritja e një programi të akredituar trajnimi afatmesëm dhe pa shkëputje nga puna për mjekët e përgjithshëm nën 45 vjeç, që do të zhvillohet në disa faza (program urë në mjekësi familje). Ky program do të rrisë aftësitë klinike të mjekëve të përgjithshëm duke synuar mbulimin e spektrit të shërbimeve që priten të ofrohen nga mjeku i familjes sipas standarteve Europiane;

- Aplikimi i politikave për të inkurajuar të diplomuarit e rinj që të bëhen mjekë familje; trajtim i njëjtë me specialitetet e tjera mjekësore, kriteret prioritare të rekrutimit për mjekët me specializim, aplikimi i Incentivave të zhvillimit profesional për mjekët e familjes, përfshi mundësinë për thellimin në një subspecialitet, harmonizim me mjekësinë e punës për të lejuar punë me dy kontrata, pagesa gjatë programit të specializimit etj;

- Reduktimi i fragmentimit të modeleve ekzistuese të ofrimit të KSHP (fëmijët dhe gratë, të rritur, etj.); bashkërendimi i kategorive të ndryshme për profesionistët e KSHP me standarde ndërkombëtare (ILO-përshkrimi i kategorive të personelit). Një numër më i vogël mjekësh do të jenë të aftë të ofrojnë shërbimet pediatrike, konsultorin e nënës dhe fëmijës, kujdesin prenatal, shëndetin mendor, të mbulojnë shërbimin e urgjencës etj. Gjithashtu, infermierët dhe mamitë do të marrin një rol më të madh në mjekësinë parandaluese, mirërritjen e fëmijës apo ndjekjen e gruas shtatzanë;

Rezultatet e pritshme:

- Në vitin 2025, 50% e mjekëve që punojnë në KSHP do të jenë mjekë të mjekësisë së familjes;

- Dallimi ndërmjet kategorive të ndryshme të mjekëve të familjes është zvogëluar

- Mjekë të familjes të motivuar profesionalisht, cilësi më e lartë shërbimesh për pacientët;

- Një numër më i madh mjekësh të rinj që zgjedhin mjekësinë e familjes.

3.3.2. Objektivi specifik 2 i politikës 2

Të përmirësojmë programet bazë të edukimit për profesionistët e KSHP

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme:

- Përshtatja e trajnimit të profesionistëve të KSHP duke u krijuar atyre mundësinë që të trajnohen në kushte të ngjashme me praktikën e përditshme të QSH-ve (përgatitje e trajnuesve nga QSH të përzgjedhura);

- Krijimi i një programi master për infermierët e familjes dhe komunitetit (në kuadër të projektit HAP 2);

- Ngritja e një rrjeti Qendrash Universitare (të ekselencës) të Mjekësisë së Familjes si një mbështetje për të përmirësuar formimin profesional të mjekëve dhe infermiereve në programet universitare dhe pasuniversitare të mjekësisë së familjes. Kjo nënkupton promovimin e qendrave shëndetësore të përzgjedhura në nivel qendrash universitare ku ofrohen shërbime shëndetësore dhe ku studentët e ciklit të parë dhe të dytë realizojnë praktika universitare nën drejtimin dhe mbikqyrjen e mjekëve dhe infermierëve të familjes. Kjo formë e re edukimi do të mund të realizohet nga bashkëpunimi mes Ministrisë dhe Universitetit të Mjekësisë. Ngritja e qendrës së parë do të realizohet në formë ndërhyrje



pilot dhe përvoja e fituar do të bëjë të mundur shtrirjen e mëtejshme të modelit;

- Ngritja e programeve pasuniversitare të formimit afatgjatë për mjekët e përgjithshëm dhe të familjes, duke krijuar module trajnimi për aftësi të reja (urgjencia mjekësore, konsultori i nënës dhe fëmijës, kujdesi prenatal, kujdesi paliativ, shëndeti mendor, kujdesi në familje, menaxhimi i rastit, etj.);

- Ngritja e nivelit të arsimit gjatë specializimit në Mjekësinë e Familjes; specializantët do të kenë përgjegjësi kujdesi për pacientët veçanërisht në mjekësi interne dhe urgjencë, 1 vit eksperiencë klinike në mjekësi interne, 6 muaj në urgjencia dhe 1 vit në qendrat e ekselencës së Mjekësisë së Familjes apo dhe në qendra të tjera të akredituara në mësimdhënie.

Rezultatet e pritshme:

- 70% e mjekëve të përgjithshëm të kualifikuar si mjek familje në vitin 2025 do të jenë praktikuar në QSH gjatë programit të tyre bazë të edukimit;

- Mjekë dhe infermierë të familjes bëhen trajnues në edukimin bazë të profesionistëve të KSHP;

- 50 infermierë të familjes që operojnë në KSHP do të kenë përfunduar Programin e ri Master të infermieristikës në familje dhe në komunitet.

3.3.3. Objektivi specifik 3 i politikës 2

Të përmirësojmë rolin e edukimit të vazhdueshëm për të mbështetur zhvillimet kritike në ofrimin e shërbimeve të KSHP

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme:

- Shtimi i ofrimit dhe zgjerimi i gamës së aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm. Përshtatja e kurrikulës dhe aktiviteteve formuese të EV me nevojat reale të KSHP (profile të reja - p.sh. kujdesi në familje/palativ/aftësi për shëndetin mendor/udhëzues për vlerësimin dhe kontrollin e rreziqeve të SJT-ve dhe monitorimi i SJT-ve, etj.);

- Mbështetja e QSH-ve për krijimin e mundësive të EV në vendin e punës, psh informimi në grupet e kolegëve. Shtrirja e grupeve të kolegëve në të gjitha qendrat shëndetësore me synim që të shtohen kapacitetet për edukim në vazhdim në vendin e punës si edhe që të rritet vetëbesimi i profesionistëve të kujdesit parësor. Nxitja dhe mbështetja për krijimin dhe funksionimin e grupeve mikse të kolegëve (mjekë dhe infermierë) do t'i japë një shtysë të mëtejshme punës në ekip

dhe arritjes së rezultateve më të kënaqshme për përdoruesit e shërbimeve;

- Futja e normave të edukimit të vazhdueshëm për menaxherët e KSHP. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të ndërtojë një sistem të kombinuar edukimi në vazhdim për mjekët administratorë dhe menaxherët e institucioneve të Kujdesit Shëndetësor Parësor (por jo vetëm), me synim rritjen e kapaciteteve menaxheriale të ekipeve drejtuese të qendrave shëndetësore;

- Do të përpunohen mekanizma për krijimin e mundësive për financim të qëndrueshëm për trajnimet e EV (p.sh. lidhje e EV me të ardhurat dytësore);

- Në çdo rajon do të promovohet një numër minimal Qendrash Shëndetësore për ofrimin e trajnimeve të EV-së në secilin rajon, deri në funksionimin e plotë të rrjetit të Qendrave të Ekselencës (Universitare) të Mjekësisë së Familjes. Këto qendra do të mbështeten në mënyrë periodike me ekspertë klinikistë, që zotërojnë eksperiencën e nevojshme për edukimin në vazhdim të mjekëve dhe infermierëve të familjes, mbi tema prioritare të kujdesit parësor dhe shëndetit komunitar;

- Aplikim i i trajnimit periodik, për mjekët e familjes, mbi urgjencën mjekësore në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore dhe Qendrat e Ekselencës të Mjekësisë së Familjes.

Rezultatet e pritshme

- Programe të qëndrueshme dhe të planifikuara të Edukimit të Vazhdueshëm

- Aftësi të reja për mjekë dhe infermierë të KSHP;

- 50% e qendrave të përfshira në aktivitete të strukturuar dhe bazuara në fakte të grupeve të kolegëve;

- Një numër minimal prej 2 QSH caktohen për ofrimin e trajnimeve të EV-së në secilin rajon deri në vitin 2025.

3.3.4. Objektivi specifik 4 i politikës 2

Të zgjerojmë dhe ripërcaktojmë rolin e infermierëve brenda ekipit profesional të KSHP

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme:

- Rishikim i profileve të punës që mund të ofrohen nga infermierët në nivelin e kujdesit shëndetësor parësor. Infermierët do të trajnohen me qëllim që të aftësohen për të ndërmarrë role të reja, për të ofruar shërbime të reja dhe për një



angazhim proaktiv në nivel komuniteti (p.sh. menaxherë dhe ofrues të shërbimeve të kujdesit në familje, këshillimi për parandalimin e SJT-ve, etj.). Rishikimi i profileve të punës të infermierëve do të aplikohet në bazë eksperimentale në zona të caktuara gjeografike me potencial suksesi dhe më pas do të shtrihet në të gjithë territorin e vendit;

- Rishikim i përshkrimeve të punës së infermierëve që të përfshijnë përgjegjësi të reja; fuqizimi i tyre për të pasur një profil më të lartë profesional, duke përfshirë edhe rastin e infermierëve që punojnë në ambulanca në zona të thella ku nuk ka mjekë familje.

Rezultatet e pritshme

- Infermierët kanë më shumë aftësi dhe mundësi për veprim;

- Infermierët janë më të angazhuar brenda ekipeve të punës me profesionistë të tjerë (p.sh. punonjësit social, psikologët, etj.);

- Puna e infermierëve në komunitete është më proaktive.

3.3.5. Objektivi specifik 5 i politikës 2

Të krijojmë një mjedis nxitës dhe motivues për një punë në ekip, profesional e të përgjegjshëm në KSHP

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme:

- Rivlerësimi, rformatimi, përmirësimi i profileve të punës për profesionistët e KSHP (si mjekë të mjekësisë së familjes ashtu edhe infermierë). Përcaktimi i aftësive të duhura profesionale për pozicione të ndryshme të punës në KSHP. Mbështetje për punë në ekip dhe punë ndërdisiplinore në qendrat shëndetësore (delegim i detyrave në grup, grupe të përziera me mjekë dhe infermierë, ekipe të menaxhimit: mjekë, financierë, infermierë, etj.);

- Krijimi i një mjedisi pune, ku faktorë stresues të rutinës profesionale të shmangen, ose zvogëlohen nëpërmjet praktikave menaxhuese të mira, dhe politikave efektive mbi burimet njerëzore. Rritja e ndërgjegjësimit të menaxherëve dhe punonjësve për shkaqet dhe efektet e stresit. Angazhimi me stafin për të krijuar marrëdhënie konstruktive dhe efektive;

- Vendosje rregullash në institucion që ndihmojnë të mbajnë ekuilibrin e duhur gjatë kohës së punës dhe sigurojnë mbrojtje nga arbitrariteti;

Përkujdesja për mirëqenien dhe shëndetin e punonjësve nëpërmjet programeve dhe nismave

efektive të promocionit shëndetësor për reduktimin e stresit personal dhe të kolegëve. Zhvillimi i një kulture të hapur dhe mbështetëse për profesionistët që përjetojnë stres ose forma të tjera të cenimit të shëndetit mendor;

- Aplikimi i stimuljeve për të motivuar personelin që punon në zonat e thella e të pafavorshme. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të hartojë një seri masash që do të mbështesin shpërndarjen e njëtrajtshme të personelit dhe mbajtjen e tij pranë komuniteteve në nevojë në zona të ndryshme gjeografike.

Rezultatet e pritshme

- Profesionistët e KSHP ndihen të mbështetur për të ofruar shërbime më cilësore;

- Vetëvlerësim dhe motivim i rritur i profesionistëve të KSHP.

Ndryshimi strategjik:

Profesionistë me kualifikim gjithnjë e më të lartë të KSHP punojnë në një mjedis motivues për të ofruar shërbimet më të mira shëndetësore në nivelin bazë

Tregues rezultati për politikën 2

- 50% e mjekëve që punojnë në KSHP do të jenë mjekë të mjekësisë së familjes;

- 50 infermierë të familjes që operojnë në KSHP do të kenë përfunduar Programin e ri Master të infermieristikës në familje dhe në komunitet;

- Të paktën një qendër shëndetësore e ekselencës e ngritur dhe e përfshirë në programet e trajnimit.

3.4. Politika 3. Infrastruktura dhe teknologjia diagnostikuese në institucionet e KSHP

Konteksti dhe çështjet për t'u adresuar

Krahas burimeve njerëzore të kualifikuara dhe të përkushtuara, shërbimet e sistemit të KSHP varen nga një infrastrukturë e përshtatshme (duke përfshirë hapësirë të përshtatshme për shërbime, energji, ujë etj), teknologji informacioni e komunikimi (duke përfshirë aksesin në internet dhe menaxhimin e të dhënave të kompjuterizuara) dhe teknologji shëndetësore (duke përfshirë barnat, vaksinat, pajisjet mjekësore dhe mjetet e tjera të konsumit).

Është e nevojshme që të rishikohen standardet minimale dhe nevojitet më shumë investim për përmirësimin e infrastrukturës së qendrave shëndetësore në mënyrë që të korrespondojnë me standardet funksionale të një qasjeje moderne të



KSHP në drejtim të aksesueshmërisë (sidomos për personat me aftësi të kufizuar), dhoma për shërbimet këshilluese, puna në ekip, dhoma e triazhit, salla të përshtatshme për recepsionin dhe pritjen. Rindërtimi ose rehabilitimi i të gjitha QSH-ve të vjetra dhe pikave shëndetësore përkatëse do të vazhdojë gradualisht, duke i dhënë përparësi më të vjetrave dhe atyre që mbulojnë popullata të mëdha.

Problemet lidhur me aksesin e pacientëve në shërbime laboratorike dhe diagnostike vërehen sidomos në zonat rurale. Për teste të thjeshta, të rekomanduara nga mjekët e përgjithshëm, pacientët duhet të shkojnë në poliklinikat në zonat urbane. Ekziston një model i mbledhjes së kampionëve të gjakut në qendrat e KSHP ose ambulancat dhe transportimi i tyre në laboratorë të centralizuar (Programi Kombëtar i Kontrollit Shëndetësor Bazë), por ai mbulon vetëm individët e shëndetshëm që kryejnë ekzaminimet parandaluese. Kjo strategji parashikon mënyrat se si të optimizohen kapacitetet ekzistuese laboratorike, duke koordinuar punën ndërmjet disa qendrave shëndetësore dhe transportimit të kampionëve nga pika e kujdesit në një laborator kryesor. Programi Kombëtar për Kontrollin Shëndetësor Bazë ka përmirësuar aksesin në testet e ekzaminimit dhe teknologjisë përkatëse në qendrat shëndetësore, duke përfshirë dhe teknologjinë digjitale për EKG-të. Por ende ka mungesë të konsiderueshme të pajisjeve diagnostikuese në disa qendra të KSHP, si edhe mungesë standardizimi për sa i përket pajisjeve mjekësore që përdoren nga çdo qendër shëndetësore; secila ka pajisje të ndryshme. Shumica e MP-ve kanë mungesa të pajisjeve bazë të tilla si termometra, nebulizatore, otoskopë, oftalmoskopë, spirometra, diapazonë, tabela për vlerësimin e shikimit etj. Nuk ka teknologji imazherie në KSHP dhe EKG-ja ofrohet vetëm në kuadër të Programin Kombëtar për Kontrollin Shëndetësor Bazë. Pajisjet bazë për infermierët gjithashtu nuk janë të standardizuara dhe mungojnë në shumë qendra shëndetësore. Në vitin 2016, projekti HAP i financuar nga SDC-ja ka pajisur mjekët dhe infermierët e KSHP në dy qarqe me një set pajisjesh mjekësore të standardizuara. Në këtë kontekst, do të merret parasysh përshtatja e standardeve për pajisjet mjekësore dhe përmbushja e tyre graduale, duke konsideruar kapacitetin funksional të niveleve të ndryshme të qendrave të

KSHP (urbane, rurale, QSH, ambulanca me MP, dhe ato pa MP) dhe përdorimi i përvojave dhe standardeve ndërkombëtare. Në përgjithësi, qendrat shëndetësore dhe ambulancat janë të mirëpajisura për imunizimin dhe zinxhirin ftohës, ndërsa temperaturat në frigorifer ruhen në nivele të përshtatshme.

Objektivi i përgjithshëm i politikës 3. Mundësimi i aksesit në një KSHP me infrastrukturë dhe teknologji diagnostike të përshtatshme e të qëndrueshme

3.4.1. Objektivi specifik 1 i politikës 3

Të forcojmë në mënyrë të qëndrueshme infrastrukturën ndërtimore të QSH-ve

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme

- Hartimi dhe miratimi i normave për infrastrukturën ndërtimore të institucioneve të KSHP me synim sigurimin e mbulimit shëndetësor universal dhe aksesin e barabartë në shërbime;

- Rehabilitimi i qendrave shëndetësore sipas normave të mësipërme, nëpërmjet investimeve publike dhe mbështetjes së donatorëve. MSHMS do të vijojë zbatimin e programit të rehabilitimit të 300 qendrave shëndetësore;

- Monitorimi dhe zgjidhja graduale e problemeve lidhur me aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara në institucionet e KSHP dhe përmbushja e përshkallëzuar e kushteve në përputhje me legjislacionin përkatës;

- Qartësimi i roleve dhe përgjegjësi të NJQV-ve për zhvillimin/mirëmbajtjen e infrastrukturës ndërtimore të KSHP. Do të hartohen dhe do të zbatohen mekanizma të financimit dhe bashkë/financimit lidhur me fuqizimin e kapaciteteve të pushtetit lokal për mirëmbajtjen parandaluese si edhe për rehabilitimin e infrastrukturës së qendrave shëndetësore. Autoritetet e qeverisjes vendore do të zgjidhin përfundimisht aspektet legale të pronësisë mbi qendrat e kujdesit parësor, ç'ka do t'i hapë rrugën investimeve të mëtejshme në këto qendra nga pushteti lokal dhe partnerët e tij të mundshëm, përfshirë edhe sektorin privat.

Rezultatet e pritshme

- Më shumë se 75% e popullatës (duke përfshirë personat me aftësi të kufizuar) do të kenë akses në QSH-të e rehabilituara deri në vitin 2025;

- 50% e bashkive ku NJQV-të janë përfshirë në mirëmbajtjen e QSH-ve.



3.4.2. Objektivi specifik 2 i politikës 3

Të rrisim aksesin në shërbimet diagnostikuese dhe trajtuese në nivel të KSHP sipas një pakete bazë të rishikuar

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme

- Hartimi dhe miratimi i normave për pajisjet dhe mjetet diagnostikuese për institucionet e niveleve të ndryshme të KSHP, si për mjekët ashtu edhe për infermierët;

- Përbushja e përshkallëzuar e standarteve lidhur me pajisjet diagnostikuese;

- Fuqizimi i qendrave të përzgjedhura shëndetësore në 10 qytete të mëdha me qëllim krijimin e një modeli të përqëndruar të ofrimit të shërbimeve të mjekësisë së familjes, shërbimeve diagnostike (RO, imazheri), laboratorike dhe të rehabilitimit. Ky model më pas do të shtrihet në mënyrë të përshkallëzuar edhe në zona të tjera urbane;

- Futja e alternativave fleksibël nëpërmjet mbështetjes logjistike për mbledhjen e mostrave biologjike pranë QSH rurale dhe analizimin e tyre në mënyrë të centralizuar. Ky model do të aplikohet në QSH rurale, të cilat e kanë të vështirë ose të pamundur ofrimin e shërbimit laboratorik;

- Hartimi dhe miratimi i listës së testeve të shpejta laboratorike në ndihmë të diagnozës, që kryhen në institucionet e KSHP dhe rregullimi i ofrimit të shërbimit (në çdo QSH ose në mënyrë të centralizuar);

- Përdorimi i pajisjeve/shërbimeve të Telemjekësisë, në zonat e thella të izoluar/ numër të reduktuar të personelit/ infermierëve pa mjekë të familjes;

- Analizimi i mundësisë për zgjerimin e modelit ekzistues apo mundësimi i përdorimit të pajisjeve të kontrollit shëndetësor bazë për aktivitete të tjera në ndihmë të diagnozës pranë QSH.

Rezultatet e pritshme

- Shërbimet janë më pranë pacientëve;

- 75% e menaxhimit të rasteve mund të mbyllen në nivelin e KSHP. Pacientët fillojnë të kenë më shumë besim në shërbimet e KSHP;

- Shërbimet janë më kosto efektive, duke reduktuar udhëtime të panevojshme/ referime të tepërta në kujdesin dytësor.

Ndryshimi strategjik: Infrastruktura e KSHP përmirësohet në mënyrë të harmonizuar në mbarë

vendin duke mundësuar aksesin e barabartë për të gjithë në shërbimet e KSHP

Tregues rezultati për politikën 3

- 1500 mjekë janë pajisur me një paketë pajisjesh moderne diagnostike;

- Më shumë se 75% e popullatës (duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara) do të kenë akses në QSH-të e rehabilituara dhe që ofrojnë shërbime të plota diagnostike;

- Rritje me 10% e rasteve të sëmundjeve të menaxhuara në nivelin e KSHP, dhe ulje me 5% e rasteve të shtruara në spital për disa sëmundje të caktuara.

3.5 Politika 4. Sistemi i informacionit të KSHP

Konteksti dhe çështjet për t'u adresuar

Sistemi i informacionit shëndetësor të KSHP është një mjet i mirë që shërben për të ndihmuar vendimmarrjen në dy nivele: menaxhimi i shërbimeve të KSHP dhe mbrojtja e shëndetit publik.

Sfidat e sistemit të informacionit të KSHP në Shqipëri janë të ngjashme me vendet e tjera; mund të ketë mungesë të të dhënave ose vlefshmëri të ulët në disa fusha, apo përdorim të ulët/të fragmentarizuar të analizës së të dhënave). Aktualisht, pjesa më e madhe e të dhënave nga QSH-të kërkohej nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe raportohet aty. Disa të dhëna kërkohej edhe nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor. Rrallëherë, ofruesit e KSHP marrin feedback rreth rezultateve përkatëse të informacionit të shkëmbyer, dhe gjithashtu rrallë e përdorin informacionin për vlerësimin e nevojave të komunitetit të cilit i shërbejnë ose për qëllime planifikimi. Strategjia parashikon rikonceptimin e objektit, formatit dhe rrugëve të raportimit për shumicën e sistemit ekzistues të informacionit (krijimi i Operatorëve të Kujdesit Shëndetësor dhe transformimi i Drejtorive Rajonale Shëndetësore në Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor është një mundësi për të reformuar edhe sistemin e informacionit në nivel të KSHP). Institucionet e reja të Shëndetit Publik do të përdorin më mirë të dhënat epidemiologjike që gjenerohen në qendrat e KSHP në shërbim të monitorimit të popullatave në rrezik.



Objekti i përgjithshëm i politikës 4: Përcaktimi dhe zbatimi i Sistemit të Informacionit të Menaxhimit Shëndetësor me fokus të KSHP-ja

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme

- Vlerësimi i statusit aktual të Sistemit të Informacionit të Menaxhimit Shëndetësor (SIMSH) dhe përshtatja e tij me kuadrin e ri institucional duke marrë në konsideratë zhvillimet e shëndetësisë; vlerësimi i racionalitetit dhe efektivitetit të formularëve të raportimit;

- Arritja e marrëveshjeve mbi të dhënat që duhet të mblidhen/ formati i raportimeve dhe koha e raportimit (për të shmangur informacionin e panevojshme, duplikimet, ngarkesën e tepërt);

- Trajnimi i personelit të QSH-ve, Njësive Vendore të Kujdesit dhe të Operatorit që të kryejnë rolet e tyre brenda SIMSH. Orientimi për vendimmarrësit mbi përdorimin e informacionit me qëllim zhvillimin e politikave shëndetësore më të përshtatshme bazuar në fakte;

- Standardizimi, rregullimi i rrjedhës së informacionit dhe përmirësimi i të dhënave mbi sëmundjet kronike në institucionet e KSHP. Forcimi i rolit të NjVKSht në përdorimin e informacionit;

- Përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit elektronik të lëshimit të recetave dhe referimit dhe planifikimi për krijimin e një karteje elektronike të pacientit duke nisur nga niveli i KSHP.

Rezultatet e pritshme

- Dakordësohet një grup formatesh për të dhënat që duhet të mblidhen;

- Profesionistë të trajnuar të Operatorëve/ Njësive Vendore të Kujdesit/ Qendrave Shëndetësore në përdorimin e SIMSH-së. Vendimmarrës të informuar për zbatimin e informacionit të marrë nga analiza e të dhënave në kohë reale;

- Politika më të mirëpërshtatura të KSHP bazuar në fakte të mbështetura nga SIMSH.

- Ndryshimi strategjik:

Përdorim më i mirë i informacionit të prodhuar nga SIMSH në KSHP për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së shërbimeve dhe për përmirësimin e shëndetit

Tregues rezultati për politikën 4

- 100% e QSH raportojnë bazuar në një format të ri dhe efektiv, mbi të dhënat që duhet të mblidhen në KSHP (duke shmangur informacionin

e panevojshme, dublikimet, ngarkesën e tepërt) dhe 100% marrin feedback mbi rezultatet e analizës.

3.6. Politika 5. Shërbimet bazë të KSHP për Mbulimin Shëndetësor Universal

Konteksti dhe çështjet për t'u adresuar

Politikat e fundit të sistemit shëndetësor në Shqipëri theksojnë nevojën për mbulim universal, ofrimin të shërbimeve shëndetësore cilësore dhe të barabarta për të gjithë popullsinë. Së fundmi, këto politika janë pasqyruar në zbatimin e Programit Kombëtar të kontrollit bazë shëndetësor dhe në heqjen e bashkëpagesave për vizitat pranë shërbimeve në qendrat shëndetësore, duke përmirësuar kështu aksesueshmërinë në shërbime të KSHP.

Paketa bazë e shërbimeve është instrumenti kryesor që siguron gamën e nevojshme të shërbimeve në nivel të KSHP për të gjithë popullatën. Ka 7 kategori shërbimesh të përfshira në paketën ekzistuese: nga kujdesi i urgjencës në promocionin shëndetësor dhe edukimin. Paketa nuk përcakton shërbimet që ofrohen në nivelin e ambulancave ose pikave shëndetësore. Të gjitha qendrat shëndetësore angazhohen për të ofruar shërbime të integruara në paketë edhe pse kanë dallime në kapacitete, aftësi të personelit shëndetësor, akses në testet laboratorike. Rishikimi i paketës bazë së shërbimeve do të pasqyrojë zhvillimet dhe modelet e reja të shërbimeve, si dhe aftësitë e reja të përfuara nga personeli shëndetësor. Ai do t'i përshtasë ato me nevojat shëndetësore dhe kapacitetet e niveleve të ndryshme të KSHP. Procesi i rishikimit duhet të garantojë që çdokush përfiton shërbimet e KSHP në mënyrë të barabartë.

KSHP mund ta arrijë synimin e vet afatgjatë, lidhur me përmirësimin e shëndetit të komuniteteve, duke siguruar përfshirjen dhe bashkëpunimin me qytetarët. Aktivizimi efektiv i individëve realizohet në 4 shkallë; Afrim i individëve/familjeve me shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor. Pozitivitet gjatë takimit me shërbimet e KSHP. Ndërveprim. Vendimmarrje e përbashkët për kujdesin, trajtimin.

Objekti i përgjithshëm i politikës 5: Rritja e aksesit në shërbime bazë të KSHP për të gjithë dhe përfshirja e individëve, familjeve dhe komuniteteve për optimizimin e shëndetit të tyre



3.6.1. Objektivi specifik 1 i politikës 5.

Të përmirësojmë dhe përshtatim paketën shëndetësore bazë në përputhje me nevojat duke rritur në të njëjtën kohë autonominë klinike në KSHP

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme

- Vlerësimi/shqyrtimi i ofrimit të paketës aktuale bazë në nivel të KSHP. Ripërcaktimi i shërbimeve bazë brenda paketës do të kryhet sipas efektivitetit, kostos, bazës shkencore, dhe modeleve aktuale të barrës së sëmundjes;

- Rishikimi i funksionimit aktual të shërbimeve, me qëllim caktimin e më shumë autonomie klinike mjekëve të KSHP, kur marrin vendime për trajtimin e sëmundjeve kronike të zakonshme;

- Shtimi i shërbimeve të reja dhe integrimi me shërbimet psiko-sociale (kujdesi paliativ, kujdesi në familje, kujdesi psikologjik, rehabilitimi fizik etj. (fizioterapia është pjesë e rehabilitimit fizik);

- Përforsimi i ofrimit të vijimësisë së kujdesit për SJT-të. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale do të plotësojë sistemin e ndjekjes së pacientëve me rregullat e kundër-referimit nga specialistët tek mjekët e familjes, me qëllim që vijimi i kujdesit të pacientëve të realizohet në mënyrë racionale.

Rezultatet e pritshme:

- Rritet përqindja e shërbimeve për SJT-të (në proporcion me modelin aktual të barrës së sëmundjeve);

- Rritet numri i rasteve që trajtohen në mënyrën e duhur në qendrën shëndetësore dhe nuk referohen tek specialisti;

- Kujdesi shëndetësor parësor zgjidh 75% të problemeve shëndetësore të pacientëve dhe konsumatorëve;

- Numër më i vogël i shtrimeve spitalore.

Ndryshimi strategjik: Shtohet gama e shërbimeve bazuar në fakte e përfshirë në paketën shëndetësore bazë dhe pasqyron nevojat shëndetësore parësore të grupeve vulnerabël

3.6.2. Objektivi specifik 2 i politikës 5

Të sigurojmë një bashkëpunim të qëndrueshëm mes individëve, familjeve dhe komuniteteve dhe institucioneve të KSHP.

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme

Aktivizimi i individëve:

- Përkallëzim i afrimit të individëve që janë indiferentë ndaj kujdesit shëndetësor parësor përmes intensifikimit të programeve ekzistuese të depistimit/kontrollit, aktiviteteve në shkollë, fushatave informuese, partneritetit me organizata që punojnë në nivel komunitar, dhe ndërhyrjeve specifike për grupime apo shtresa të caktuara të popullatës;

- Krijimi i mundësive për individët për të bërë pyetje, për të kërkuar informacion, sqarime, duke vendosur standarte të kohës së mjaftueshme të vizitës, angazhim të vecantë të personelit infermieror, duke mbështetur kualifikimin e duhur të personelit mjek/infermier/ psikolog/ punonjës social në komunikim, dhe krijimin e një mjedisi që krijon konfidencialitet;

- Vendimmarrje e përbashkët për planin e kujdesit shëndetësor dhe social duke aplikuar instrumente efektive (pyetësorë, lista-kontrolli, protokolle, ditar individual të kujdesit, etj.). dhe duke stimuluar diskutimin e përbashkët për problemet shëndetësore, alternativat për zgjidhje, alternativat më të përshtatshme, veprimet që duhen ndërmarrë (nga kush, kur, si);

- Inkurajimi dhe mbështetja për pjesëmarrje të individëve me probleme shëndetësore kronike në grupime mbështetjeje sipas problemit / çështjes. Grupimet mund të jenë offline dhe/ose online;

- Përcaktimi i koordinatorit të kujdesit dhe promovimi i tij pranë individëve dhe familjeve.

Aktivizimi i familjeve:

- Inkurajimi i familjeve për regjistrim tek e njëjta njësi e KSHP (Qendër Shëndetësore);

- Përkallëzim i vizitave në shtëpi nga ekipi i kujdesit. Vlerësim i vulnerabiliteteve sociale, mjedisore, etj. Bashkë-hartim i planeve mbështetëse për familjet, me familjet. Përfshirje e punonjësit social;

- Përfshirje e anëtarëve të familjes, me pëlqimin e informuar të individëve, në planet e kujdesit specifik për individët;

- Edukimi shëndetësor i anëtarëve të familjes për kujdesje, monitorim të individëve me probleme shëndetësore specifike.

Aktivizimi i komuniteteve:

- Vlerësim i mjedisit të komuniteteve (mjedisi fizik, mjedisi social, etj.). Realizohet në bashkëpunim me Njësitë Vendore të Shëndetit Publik;



- Stratifikimi i komunitetit sipas nevojave shëndetësore (census në nivel komuniteti);
- Komunikim/informim për problemet, alternativat për zgjidhje, veprimet e nevojshme);
- Inkurajimi i komunitetit për organizim civil (shoqata, organizata, grupime, etj);
- Përfshirje e përfaqësuesve apo individëve më të zëshëm në organe konsultative/vendimmarrëse në nivel QSH, Operatori Rajonal të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Bashki.

Tregues rezultati për politikën 5

Rritje me 10% e rasteve të sëmundjeve të menaxhuara në nivelin e KSHP, dhe ulje me 5% e rasteve të sëmundjeve të caktuara të shtruara në spital.

75% e qendrave shëndetësore kanë caktuar koordinatorin e kujdesit komunitar

3.7.Politika 6. Financimi dhe kontraktimi për Mbulimin Shëndetësor Universal

Konteksti dhe çështjet për t'u adresuar

Financimi i mbulimit shëndetësor universal është një mjet madhor për të mbrojtur grupet e cënueshme nga shpenzime katastrofike në rast sëmundje. Qeveria e Shqipërisë ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim (siç përshkruhet edhe më sipër në këtë dokument). Sigurimi i efikasitetit alokues për nivelet bazë të kujdesit si KSHP ose Kujdesi Afatgjatë (shërbimet mjekësore sociale të kujdesit në familje) rezulton në reduktimin e shmangies së shtrimit në spital dhe si rrjedhojë, efikasitet më i madh i fondeve të kujdesit shëndetësor.

Krahas sigurimit të një niveli të duhur të financimit të shërbimeve të KSHP dhe kujdesit në familje, mënyra se si ofrohet apo kontraktohet financimi për ofruesit, ndikon edhe në sjelljen e ofruesit. Qasja pasive është tipike e ofruesve që marrin alokime buxhetore pa informacionin rreth performancës së tyre. Zbatimi i një financimi më aktiv nënkupton lidhjen e transferimit të fondeve, të paktën pjesërisht, me informacionin rreth performancës së ofruesve ose me nevojat shëndetësore të popullatës që ata shërbejnë. Në Shqipëri, është e nevojshme të fillojë të aplikohet gradualisht një sistem pagese sipas nivelit të riskut, paralelisht me përmirësimin e sistemit të informacionit dhe pas pilotimit të treguesve të rishikuar në rajone të përzgjedhura. Këto strategji të reja rimbursimi konsiderohen një stimul për një ndryshim sjelljeje nga ana e ofruesit, duke

shpërblyer ata MP që punojnë më shumë dhe më mirë.

Modeli i kontraktimit do të bëjë të mundur që mjeket e përgjithshëm ose mjekët e familjes mund të praktikojnë aftësi të reja të përftuara nga kualifikimi/specializimi. Gjithashtu ata do të mund të lejohen që sipas kontratës të kryejnë shërbime gjithnjë e më komplekse, duke ulur shtrimin e panevojshëm në spital apo vizitën te specialisti i ngushtë.

Megjithëse lista e barnave të rimbursueshme është zgjeruar gradualisht gjatë viteve të fundit, sërish shpenzimet për barna përbëjnë pjesën kryesore të shpenzimeve direkte nga xhepi për shërbime shëndetësore në Shqipëri. Është e nevojshme që të vijohet me masa për sigurimin e mbrojtjes financiare për të gjithë qytetarët.

Objekti i përgjithshëm i politikës 6: Sigurimi i Mbulimit Shëndetësor Universal në KSHP përmes buxhetimit të qëndrueshëm dhe efektiv

3.7.1. Objekti i specifik 1 i politikës 6.

Të sigurojmë financimin e duhur dhe të qëndrueshëm për KSHP-në

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme

- Do të futet gradualisht buxheti i shërbimeve të KSHP bazuar në nevojat shëndetësore, prioritetet lidhur me barrën e sëmundjeve, paketën e shërbimeve dhe burimet e disponueshme;

- Buxheti i shërbimeve të integruara mjekësore-sociale të kujdesit në familje. Për këtë qëllim, është e nevojshme që Fondi i Detyruar i Sigurimeve të punojë ngushtë me Drejtoritë përkatëse të qendrave shëndetësore si edhe me Operatorët rajonale, me qëllim që buxhetet t'i përgjigjen nevojave për shërbime të qytetarëve;

- Do të përmiresohet metodologjia e hartimit të buxheteve si edhe do të ndërtohet një program trajnimi lidhur me aplikimin në praktike të kësaj metodologjie. Do të trajnohen vendimmarrësit (OK/OR & FDSKSH) për metodat e buxhetimit shëndetësor të kujdesit parësor;

- Kalimi nga buxhetet historike në planifikimin e investimeve në përputhje me vlerësimin e nevojave;

- Kalimi nga modeli aktual i pagesës së KSHP në një model të ndryshëm bazuar në një kombinim të pagesës per capita dhe shpërblyerit për performancë. Vlerësimi i gatishmërisë së sistemit për të aplikuar gradualisht shpërblyerimin sipas performancës. Përshtatja graduale e pagave të



personelit të QSH-ve duke rritur fleksibilitetin në përputhje me ngarkesën e punës dhe performancën;

- Do të pilotohet financimi i integruar i shërbimeve shëndetësore dhe sociale në nivel komuniteti (p.sh. kujdesi në shtëpi);

- Do të mundësohet përdorimit i 3% të të ardhurave dytësore për trajnimin e personelit të QSH-ve, veçanërisht për të lehtësuar zbatimin e grupeve mikse të kolegëve si edhe pjesëmarrjen e personelit në programin bridge të ri-trajnitimit për mjekët e përgjithshëm;

- Alokimi i buxhetit të dedikuar brenda buxhetit të KSHP për aktivitete parandaluese dhe të promocionit shëndetësor;

- Identifikimi i burimeve shtesë financimi për KSHP-në edhe jashtë sektorit të shëndetësisë, veçanërisht përmes kontributeve nga pushteti lokal dhe nga sektori privat.

Rezultatet e pritshme:

- Përqindja e fondeve që alokohet për KSHP-në rritet nga 18% në 25%;

- Përqindja buxhetit që alokohet për Shërbimet e Kujdesit në Shtëpi: 0.5% gjatë vitit të dytë, 1% në vitin e tretë, 1,5% në vitin e katërt, 2% në vitin e pestë të zbatimit të strategjisë;

- Ulje e shpenzimeve personale nga ana e grupeve vulnerabël.

3.7.2. Objektivi specifik 2 i politikës 6

Të bashkërendojmë kontraktimin financiar të shërbimeve me rritjen e cilësisë/performancës së shërbimeve të KSHP

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme

- Adoptimi i paketës së shërbimeve në përputhje me nevojat dhe kapacitetet e institucioneve të KSHP /paketë e përshtatur për secilin nivel të KSHP (Qendrat e Ekselencës të Mjeksisë Familjare, Qendrat Shëndetësore e Sociale, Qendra Shëndetësore, Ambulancat);

- Trajnimi i menaxherëve të OK-së/OR-ve, NJVK-ve, QSH-ve për të kuptuar mekanizmat e kontraktimit;

- Përshtatja e kontraktimit për të lejuar mjekët e familjes që të kryejnë në praktikën ditore një gamë më të gjerë procedurash e të përdorin aftësitë në mënyrë më autonome.

Rezultatet e pritshme

- Treguesit e performancës zgjidhen sipas prioriteteve shëndetësore;

- Kontratat e KSHP kthehen në mjete fleksibël që të arrihen rezultate shëndetësore më të mira.

3.7.3. Objektivi specifik 3 i politikës 6

Të forcojmë mbrojtjen financiare për të gjithë banorët rezidentë në Republikën e Shqipërisë

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme

Mbrojtje nga ndikimi i bashkëpagesave përmes:

Aplikimi i bashkëpagesave fikse dhe jo në përqindje;

Përfshirja progresiv dhe vendosja e një tavani për nivelin e bashkëpagesave nga familje me të ardhura të ulëta ;

Aplikimi i mekanizmave rregullator që të mundësojnë dhënien e barnave të duhura, me cilësi të garantuar dhe të lira nga mjekët ;

Përfshirja graduale e mjeteve të konsumit në skemën e rimbursimit.

- Mbrojtje nga pagesat indirekte përmes:

- Mbështetjes/njohjes për kujdestarët informalë në familje dhe rishikimi i kriterëve të vlerësimit të nevojës për kujdestarë për personat me aftësi të kufizuar;

- Realizimi i ekzaminimeve pa nevojë zhvendosjeje; Lehtësim i pagesave të transportit (dializa, kemio/radioterapia, aftësia e kufizuar etj);

- Eliminimi i mungesave eventuale të barnave, pajisjeve e materialeve mjekësore;

- Kontraktimi i ofruesve jo-publikë për të mbuluar nevojat për shërbime të munguar në gamë apo të cunguara në shtirje gjeografike.

- Rritje e transparencës në kujdesin shëndetësor përmes:

- Ngritja/venia në funksion e Këshillit Kombëtar të Pacientëve;

- Shfrytëzimi i potencialit të platformave e-Albania, portalit “Për Shqipërinë që duam”, portali i bashkë-qeverisjes;

- Krijimi i hapësirave për forcimin e rolit të Avokatit të Popullit, KLSH dhe ILDKPKI.

Rezultatet e pritshme

- 100% e bashkëpagesave fikse, jo në përqindje;

- Përfshirja e të paktën 1 pajisjeje mjekësore (kujdesi ambulator) çdo vit në skemën e rimbursimit;

- Lehtësim në masën 50% e barrës së shpenzimeve të transportit për pacientët në dializë, kemio/radioterapi.

Ndryshimi strategjik:



Financimi i KSHP është i qëndrueshëm dhe lidhet gradualisht me performancën; përmirëson motivimin e mjekëve të familjes për ofrimin e shërbimeve më cilësore

Shërbimet mjekësore-sociale të kujdesit në familje fillojnë të buxhetohen.

Tregues rezultati për politikën 6

- Përqindja e fondeve që alokohet për KSHP-në rritet nga 18% në 25% të buxhetit të përgjithshëm të shëndetësisë;

- Përqindja buxhetit që alokohet për Shërbimet e Kujdesit në Shtëpi 2% në vitin e pestë të zbatimit të strategjisë.

3.8.Politika 7. Përcaktimi dhe pilotimi i tipeve të reja të shërbimeve dhe rishpërndarja gjeografike

Konteksti dhe çështjet për t'u adresuar

Një sërë faktorësh po çojnë në disa ndryshime në priren dhe shpërndarjen e nevojave shëndetësore të popullsisë shqiptare. Proporcioni i të moshuarve po rritet dhe bashkë me ta po rritet edhe nevoja e shërbimeve të KSHP për të trajtuar në mënyrë më sistematike sëmundjet jo të transmetueshme, probleme të shëndetit mendor dhe aftësitë e kufizuara. Aktualisht në Shqipëri, hipertensioni dhe diabeti janë sëmundjet që trajtohen më së shumti në KSHP. Nëse kujdesi afatgjatë për pacientët me sëmundje kronike (me paraqitjet e tyre komplekse dhe multipatologjite shoqëruese), nuk koordinohet si duhet, atëherë ka një rrezik të madh për shtrim në spital. Ndërkohë që shërbimet tradicionale për nënat dhe fëmijët janë të mirëorganizuara dhe të mirëmbështetura, KSHP në Shqipëri do të fillojë të ofrojë shërbime të reja dhe të integruara mirë në këto fusha.

Për më tepër, KSHP duhet të përshtatet me nevojat specifike të popullatave vulnerabel (të moshuar të izoluar, personat me aftësi të kufizuara, komuniteti rom, etj.) Ata janë më shumë të ekspozuar ndaj rreziqeve shëndetësore dhe janë kategoritë më pak të mbrojtura nga pasojat negative të këtyre rreziqeve. Aktualisht, shërbimet e KSHP për grupet e cënueshme janë të ndara nga shërbimet sociale. Të dyja shërbimet duhet të jenë më të koordinuara dhe më të integruara.

Adoleshentët janë një grup me nevoja specifike shëndetësore, duke përfshirë dhe abuzimin me substanca, depresionin, shëndetin seksual dhe ushqyerjen, por normat e përdorimit të shërbimeve të KSHP për ta janë shumë të ulëta, të ndikuara

nga pritshmëri të ulëta dhe mungesë të shërbimeve të përshtatshme. Modele të reja të shërbimeve të integruara për adoleshentë (p.sh. HEADSS), duhet të integrohen edhe në KSHP e Shqipërisë.

Shpërndarja gjeografike e popullatës ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme në Shqipëri ndërkohë që organizimi territorial i KSHP nuk ka ndryshuar shumë gjatë 30 viteve të fundit. Qendrat shëndetësore dhe pikat ambulatorie janë të shpërndara në mënyrë të pabarabartë në mbarë vendin, ku qytetet e mëdha kanë qendra shëndetësore që mbulojnë një popullatë dhjetëfish më të madhe në krahasim me qendrat në zonat rurale. Në Tiranë apo qytete të tjera të mëdha, kapaciteti i qendrave shëndetësore është më i madh në kuptimin e personelit mjekësor dhe disa shërbimeve të veçanta, të tilla si: konsultori i fëmijës dhe gruas. Nevojitet një rishpërndarje territoriale e personelit, qendrave shëndetësore dhe, në mënyrë që të krijohen modele shërbimesh të reja gjithëpërfshirëse e të integruara të mjekësisë së familjes dhe mbështetjes sociale, në zona me nevoja më të mëdha dhe kapacitetet e duhura, do të pilotohet një nivel i ri i qendrës së kujdesit shëndetësor; Qendra e Mjekësisë Familjare.

Objekti i përgjithshëm i politikës 7: Përshtatja e shërbimeve të KSHP me nevojat e popullatës bazuar në analizë demografike, epidemiologjike dhe sociale.

3.8.1.Objekti i specifik 1 i politikës 7

Të organizojmë shërbimet e KSHP, gjithmonë e më të integruar me kujdesin social në nivel vendor

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme

- Pilotimi i një modeli të ri të organizimit të integruar të shërbimeve sociale e shëndetësore për grupet në nevojë në 4 qytete (një për secilin operator shëndetësor rajonal), me krijimin e Qendrës Social Shëndetësore pranë Qendrës së Mjekësisë Familjare me personel shtesë psikolog, punonjës social etj. Ky model do të sjellë më pranë qytetarëve shërbime të tilla si: Kujdesi afatgjatë, kujdesi në shtëpi, kujdesi paliativ, shëndeti mendor komunitar, këshillim psikologjik, social dhe ligjor, si dhe përkujdesje vetjake e ushqim, shërbime rehabilitimi, prindërimi, ndërkohë që përmirësohet menaxhimi SJT-ve në komunitet;

- Angazhim aktiv i institucioneve të qeverisjes vendore në fushën e ofrimit të mbështetjes sociale dhe shëndetësore në komunitete (duke siguruar



lidhjet më të mira të mundshme ndërmjet KSHP dhe komuniteteve vendase); Përfshirja e përfaqësuesve bashkiakë në mbledhjet vjetore rajonale të Operatorit Shëndetësor për KSHP dhe diskutimi i rasteve specifike, ku nuk janë përmbushur nevojat dhe strategjitë e bashkëpunimit për zgjidhjen e problemit;

- Ngritja e një Këshilli të Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale në nivel rajonal për koordinimin e sektorëve social dhe shëndetësor dhe Operatorëve dhe Bashkive;

- Riorganizimi i shërbimeve sociale të kujdesit në familje, kujdesi paliativ, shëndeti mendor i komunitetit, parandalimi i SJT-ve për të ofruar kujdesin shëndetësor dhe social për familjet/komunitetin. Do të pilotohen shërbime të kujdesit ditor të ofruara nga punonjësit socialë të integruara me shërbime mjekësore të ofruara nga infermierët;

- Përgatitja e një platforme të shkëmbimit të informacionit në mënyrë sistematike midis bashkive dhe institucioneve të KSHP rreth numrit, vendndodhjes dhe nevojave sociale dhe shëndetësore të grupeve dhe individëve në nevojë;

- Replikimi i modeleve të suksesshme të bashkë-financimit të shërbimeve të caktuara nga bashkitë (sipas shembullit të kujdesit paliativ në Korçë).

Rezultatet e pritshme

- Në vitin 2025, të paktën 12 Këshilla Shëndetësore dhe të Mbrojtjes Sociale janë funksionale dhe propozojnë veprime për të përmirësuar integrimin e kujdesit shëndetësor dhe social në nivelin e komunitetit të tyre;

- Pilotohen 4 modele të kujdesit të integruar (p.sh. Kujdesi afatgjatë, shërbimet e kujdesit në shtëpi, shëndeti mendor, shërbimet e kujdesit paliativ, kujdesi social dhe psikologjik parandalimi i sëmundjeve në komunitet), nxirren mësimet dhe përfshihen në vendimet për politikën; kryhen ndryshimet përkatëse në kuadrin ligjor për të mundësuar shpërndarjen e shërbimeve të integruara.

Ndryshimi strategjik: Njerëzit në komunitete përfitojnë nga shërbimet e integruara të tilla si: kujdesi afatgjatë, kujdesi social dhe psikologjik, kujdesi në familje, kujdesi paliativ, shëndeti mendor, shërbimet e kontrollit të SJT-ve në komunitet

3.8.2. Objektivi specifik 2 i politikës 7

Të mbështesim integrimin vertikal të shërbimeve të KSHP

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme

- Përmirësimi i koordinimit të KSHP me hallkat e sistemit të kujdesit shëndetësor dhe social;

- Sigurimi i vijimësisë së kujdesit dhe reduktimi i pengesave gjatë referimit dhe kundër-referimit për/nga specialistët;

- Angazhimi i infermierëve të përcaktuar (infermierët e rastit) që do të ndjekin/mbështesin pacientin në të gjitha hallkat e sistemit;

- Përmirësimi i sistemit elektronik të referimit (e-referimi) që mundëson kundër-referimin;

- Hartimi dhe aplikimi i udhëzuesve dhe protokolleve të reja klinike të cilat përcaktojnë kriteret klinike të referimit dhe jo vetëm ato administrative të përcaktuara nga Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme Shëndetësore. Kjo do të bëhet e mundur në sajë të bashkëpunimit ndërmjet të gjithë aktorëve të sistemit, si Shoqatat e Mjekëve të Familjes, Fakulteti i Mjekësisë dhe ai i Shkencave Teknike Mjekësore, Urdhëri i Mjekëve, Fondi i Sigurimeve të Detyruara, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe agjensitë e saj.

Rezultatet e pritshme

- Ndjekje më të mirë të pacientëve/ vijueshmëri më e mirë e kujdesit;

- Mjekët specialiste të fushës bëhen më të ndërgjegjshëm/ përgjegjshëm për ndjekjen e pacientëve.

3.8.3. Objektivi specifik 3 i politikës 7

Të rrisim mbulimin e komunitetit me shërbime të KSHP duke i dhënë përparësi grupeve vulnerabël dhe në rrezik të lartë

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme

- Mbështetje e QSH-ve nga NJVKSH dhe OKSH për vlerësimin e nivelit të riskut dhe vulnerabilitetit në popullatën që ata mbulojnë (të moshuarit, gratë, fëmijët, pacientët me sëmundje kronike, grupet etnike, etj.), me qëllim përshtatjen e vazhdueshme të shërbimeve me nevojat;

- Trajnimi i personelit të kujdesit shëndetësor mbi nevojat specifike, komunikimin dhe menaxhimin e rasteve në grupet e marginalizuara;

- Ndërtimi dhe promovimi i modeleve të bashkëpunimit të suksesshem midis agjensive rajonale të Operatorit, Pushtetit Vendor dhe ekipeve të Qendrave Shëndetësore me Organizatat Jo-qeveritare, me synim mbështetjen e grupeve



vulnerabël brenda komuniteteve si edhe për "fuqizimin" (empowerment) e këtyre grupeve, me qëllim që ata të marrin në dorë zgjidhjen e problemeve të tyre shëndetësore;

-Grupet që duhen marrë në konsideratë:

a) Të moshuarit (pilotimi i kujdesit geriatrik, kujdesi në familje, krijimi i një modeli të integruar të kujdesit mjekësor-social etj.);

b) Pacientët me sëmundje kronike-vlerësim/monitorim i pacientëve me morbiditet të shumëfishtë/ Shtresëzimi i popullatës së mbuluar;

c) Personat me aftësi të kufizuar- më shumë kujdes social se sa shëndetësor;

Komuniteti rom- ata kanë nevojë për integrim/ shumë të varfër/ probleme me edukimin/ shpesh kanë probleme me aksesin në shërbime/ shpesh nuk iu rimbursohen barnat;

d) Kujdes për fëmijë me nevoja të vencata përfshi Autizëm, S Down, etj.;

e) Shëndeti i adoleshentëve;

f) Vlerësimi, përditësimi dhe zbatimi i protokolleve (protokollet e miratuara në vitin 2016).

Rezultatet e pritshme

-Personeli i KSHP ka aftësitë dhe njohuritë për të trajtuar grupet vështirë për t'u mbuluar;

-Grupet e cenueshme të trajtuara siç duhet përfitojnë nga shërbimet e KSHP.

3.8.4. Objektivi specifik 4 i politikës 7

Të rimodelojmë shpërndarjen gjeografike të KSHP për të ofruar kujdes më efikas, dhe njëkohësisht duke siguruar akses në shërbimet e KSHP për të gjitha kategoritë e popullatës së mbuluar dhe riorganizimi i QSH-ve në nivele të ndryshme.

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme

-Përcaktimi i hartës territoriale të shpërndarjes së QSH-ve për secilin Operator;

-Miratimi dhe zbatimi i normave lidhur me shpërndarjen në terren sipas popullatës së mbuluar dhe barrës së sëmundjeve apo problemeve shëndetësore të zonës gjeografike për secilin institucion të KSHP, duke përfshirë qendrat shëndetësore, ambulancat dhe qendrat e reja të mjekësisë së familjes. Rishikimi i organizimit dhe marrëdhëniet e tyre në secilin nivel;

-Përshtatje fleksibël e burimeve/ ofrimit të shërbimeve shëndetësore, duke u bazuar në karakteristikat dhe nevojat e popullatës;

-Ngritja e një modeli të Qendrës së Mjekësisë së Familjes, duke pilotuar dhe integruar atë në sistemin e KSHP. Do të ngrihen Qendrat e Mjekësisë së Familjes duke u bazuar në qendrat ekzistuese të kujdesit shëndetësor, duke i shërbyer një popullate të konsiderueshme (p.sh. 30.000 dhe 40.000 banorë) dhe duke pasur një numër të lartë të personelit shëndetësor. Në një fazë të dytë, ky model do të shërbejë për transformimin e disa spitaleve periferikë në institucione të KSHP. Qendrat e Mjekësisë së Familjes mund të përfshijnë disa shërbime të veçanta (mendore, paliative, fizioterapi, kujdes social psikologjik të integruar etj.);

-Pilotimi i modelit universitar në disa qendra të përzgjedhura të mjekësisë së familjes, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, duke krijuar Qendra Universitare të Mjekësisë së Familjes;

-Pilotimi i një rrjeti të QSH-ve/kujdesit social të komuniteteve në zonat e thella. Krijimi i modeleve të koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet qendrave të vogla shëndetësore në zonat rurale, me qëllim zgjerimin e spektrit të shërbimeve (duke përfshirë shërbimin 24 orë, ose shërbimet e testeve laboratorike) dhe mundësimi i një mjedisi të përshtatshëm profesional që do të sigurojë më pas përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Rezultatet e pritshme

-Modele të ndryshme të organizimit të KSHP përcaktohen për të pasqyruar më mirë dhe më qartë nevojat e popullatës së mbuluar;

-Krijimi i Modelit të Qendrës së Mjekësisë së Familjes duke ofruar shërbime më cilësore dhe duke përmirësuar imazhin e KSHP;

-Më shumë fleksibilitet brenda përcaktimeve ligjore të modele të ndryshme të organizimit të KSHP;

-Reduktimi i mospërputhjeve midis QSH-ve. Qendrat shëndetësore gjithëpërfshirëse të mjekësisë së familjes ofrojnë shërbime më cilësore.

Ndryshimi strategjik: Fleksibiliteti më i madh i organizimit të shërbimeve mundëson akses më të mirë në standarde më të larta të shërbimit të KSHP

Tregues rezultati për politikën 7

- 10 qendra të Mjekësisë Familjare të ngritura;

-4 qendra pilot të kujdesit të integruar shëndetësor e social;

-10 modele të shërbimit 24 orësh në zona të thella siguruar përmes QSH rurale të koordinuara;



-2 qendra të reja të kujdesit paliativ pranë KSHP.

3.9. Politika 8. Cilësia e shërbimeve të KSHP

Konteksti dhe çështjet për t'u adresuar

Në mënyrë që shërbimet e KSHP të mos jenë vetëm të aksesueshme universalisht por edhe më cilësore, ato duhet të bazohen në fakte shkencore, të jenë të sigurta dhe të kenë në qendër njerëzit.

Gjatë 15 viteve të fundit, ka pasur një farë progresi në përmirësimin e cilësisë së KSHP në Shqipëri, me prezantimin e mekanizmave institucionale, të tillë si: krijimi i Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit (QKCSA), miratimi i kuadrit rregullator ligjor për akreditimin e institucioneve shëndetësore, si dhe hartimi i disa udhëzuesve klinikë.

Sidoqoftë, ka shumë boshllëqe lidhur me:

-Protokollet klinike që ose nuk përdoren ose nuk janë të përditësuara. Profesionistët e KSHP që nuk janë përfshirë sa duhet në proces, dhe rrallëherë janë organizuar trajnime për të mbështetur zbatimin e udhëzuesve apo protokolleve. Në këto rrethana, zbatimi i auditit klinik, si një mënyrë e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë (e parashikuar në ndryshimet e fundit të ligjit të kujdesit shëndetësor), nuk ka qenë i mundur. Nevojitet hartimi i protokolleve dhe udhëzuesve klinikë të përditësuar dhe gjithëpërfshirës. Ato do të bazohen në fakte shkencore, përvojën më të mirë ndërkombëtare dhe të përshtaten me mjedisin e KSHP në Shqipëri. Modeli i auditit klinik do të ndjekë procesin e zbatimit të protokolleve në praktikën klinike.

-Në vitin 2018, nisi procesi i akreditimit në qendrat shëndetësore të KSHP. Programi HAP 1 kontribuo në përparimin e këtij procesi duke përcaktuar formate dhe nëpërmjet rritjes së kapaciteteve në nivel të QSH-ve për plotësimin e formularëve të nevojshëm për akreditimin.

Objekti i përgjithshëm i politikës 8: Aplikimi i një modeli të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve të KSHP

3.9.1. Objekti i specifik 1 i politikës 8

Të sigurojmë ofrimin e shërbimeve të KSHP gjithnjë e më cilësore duke garantuar normat bazë të cilësisë dhe duke aplikuar modele të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme

-Zhvillimi i një kulture të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe qeverisjes klinike në KSHP;

-Qartësimi i roleve të institucioneve (QKCSA OK/OR, ISHP, QSUT, MSHMS Shoqatat, urdhërat profesionale) në hartimin, zbatimin, monitorimin e protokolleve;

-Krijimi i parakushteve për zbatimin e ciklit të cilësisë;

-Hartimi, rishikimi, përmirësimi i udhëzuesve dhe protokolleve klinike për prioritetet kryesore të shëndetit publik përmes një pune në ekip dhe në bashkëpunim me specialistë të fushës dhe vendimmarrësit;

-Përshtatja dhe miratimi i protokolleve klinike për praktikën në nivel të KSHP për problemet shëndetësore më të shpeshta/më serioze, përfshirja e Ministrisë në proces, (Operatori, qendra e cilësisë, ISHP, etj.) ofruesit e KSHP, Universiteti, shoqatat e profesionistëve. Përdorimi i praktikave më të mira ndërkombëtare dhe pasqyrimi i kapaciteteve dhe organizimit vendor;

-Lidhja e temave klinike të protokollit me proceset EVM-së për të siguruar që më shumë aktivitete trajnime të mbulojnë tema të reja;

-Përpilimi i protokolleve që mungojnë;

-Hartimi i udhëzimeve parandaluese bazuar në fakte për secilën grupmoshë. Përditësim i rregullt i tyre.

-Krijimi i metodologjive për verifikimin mes kolegëve (peer review), auditin klinik dhe supervizionin mbështetës;

-Ngritja e kapaciteteve për zbatimin dhe monitorimin e protokolleve nëpërmjet verifikimit mes kolegëve dhe auditit klinik.

Rezultatet e pritshme

-Udhëzime, protokolle klinike të përmirësuara ose të hartuara për herë të parë;

-Specialistë të fushës në grupet e punës;

-Metodologjitë për verifikimin mes kolegëve, auditin klinik janë përcaktuar. Përkufizohet dhe zbatohet cikli i cilësisë;

-Përfordhet kultura e ngritjes profesionale (pa penaltete që e dëmtojnë procesin).

3.9.2. Objekti i specifik 2 i politikës 8

Të mbështesim zbatimin e procedurave të akreditimit brenda çdo qendre shëndetësore



Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme

-Qartësimi i situatës lidhur me Pikat Shëndetësore (ambulancat) në procesin e akreditimit;

-Zhvillimi i ekipeve në nivel të QSH-ve të ngarkuar me procesin e akreditimit;

-Trajnimi i personelit të QSH-ve me plotësimin e procesit dhe formularëve të akreditimit;

-Në zbatim të kërkesës nga procesi i akreditimit, ngritja e një bordi në nivel të QSH-ve i cili zhvillon periodikisht kontrolle klinike, duke përdorur verifikim mes kolegëve;

-Akreditimi i shërbimeve sociale — miratohen ose rishikohen standardet e shërbimeve të reja;

-Akreditimi i shërbimeve të krijuara rishtasi (p.sh. kujdesi në familje mjekësor-social i integruar, shërbimet paliative, etj.), dhe teknologji të reja (p.sh. mikro laborator, telemjekësia, etj.).

3.9.3. Objektivi specifik 3 i politikës 8

Të përfshijmë në mënyrë sistematike pacientët dhe konsumatorët në mekanizmat e përmirësimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme

-Ndërtimi i një platforme/aplikacioni me fokus sistemin e kujdesit shëndetësor parësor për marrjen e ankesave dhe përfshirjen e konsumatorëve në mekanizmin e përmirësimit të cilësisë së shërbimeve.

Rezultatet e pritshme / objektivat

-100% e QSH-ve janë angazhuar në procesin e akreditimit;

-75% e QSH-ve arrijnë të paktën standardet e kuqe;

-50% e QSH-ve arrijnë standardet optimale;

-25% e QSH-ve arrijnë standardet e ardhshme.

Ndryshimi strategjik: Komunitetet përfitojnë nga shërbimet e një cilësie të lartë dhe bazuar në fakte të ofruara në QSH-të e akredituara

Tregues rezultati për politikën 8

-100% e QSH-ve janë angazhuar në procesin e akreditimit;

-75% e QSH-ve arrijnë të paktën standardet e kuqe, 50% e QSH-ve arrijnë standardet optimale, 25% e QSH-ve arrijnë standardet e ardhshme.

3.10. Politika 9. Menaxhimi i institucioneve të KSHP

Konteksti dhe çështjet për t'u adresuar

Qendrat shëndetësore të KSHP në Shqipëri janë institucione shëndetësore përgjegjëse për administrimin e personelit, buxhetit, infrastrukturës, produkteve dhe sistemeve të informacionit. Në qendrat shëndetësore ka pasur gjithnjë mangësi në kapacitetet menaxheriale. Drejtorët e qendrave shëndetësore, por edhe personeli tjetër si psh kryeinfermierët, duhet të përmirësojnë në vijimësi aftësitë e tyre lidhur me menaxhimin e ekipit, menaxhimin e informacionit, përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, si dhe vlerësimin shëndetësor të komunitetit. Reforma e organizmit të sistemit shëndetësor dhe prezantimi i institucioneve të reja, si Operatori i Shërbimeve Shëndetësore, do të krijojë marrëdhënie të tjera ndërinstitucionale dhe së bashku me to do të krijohen detyra të tjera menaxheriale për qendrat shëndetësore. Menaxhimi i QSH-ve do të duhet të mbështetë Njësitë e Shëndetit Publik dhe Operatorët për vlerësimin e nevojave, planifikimi strategjik dhe buxhetimi për shërbime të reja në zonat e tyre të mbulimit.

Në veçanti, ka më shumë nevojë për aftësi dhe kapacitete menaxheriale më të mira, në qendra shëndetësore më të mëdha. Qasje të tilla si trajnime të përshtatura për menaxherë dhe prezantimi i modeleve më efikase në qendrat shëndetësore do të shërbejë për të përmirësuar vazhdimisht menaxhimin e KSHP.

Objektivi i përgjithshëm i politikës 9: Përmirësimi i efikasitetit të menaxhimit të institucioneve të KSHP

Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme

Rritja e kapaciteteve të tjera të menaxhimit dhe punës së ekipit në qendra shëndetësore (menaxherë /kryeinfermierë/ekonomistë). Kjo do të arrihet përmes punësimit të studentëve të diplomuar në Masterin e Menaxhimit Shëndetësor, veçanërisht në administratat e qendrave shëndetësore të reja dhe me shërbime të kombinuara shëndetësore dhe sociale si edhe zbatimit të programeve të edukimit në vazhdim për menaxherët e institucioneve shëndetësore;

-Rritja e kapacitetit të personelit të QSH-ve për të mbështetur operatorët rajonal në përcaktimin e planeve strategjike shëndetësore (vlerësimi i nevojave në nivel komuniteti, planifikimi për krijimin e shërbimeve të nevojshme, ngritja e kapaciteteve për zbatimin e shërbimeve të reja, etj.);



- Përgatitja e modeleve të planifikimit strategjik dhe pilotimi i tyre në disa QSH të përzgjedhura në bashkëpunim me stafin e vetë QSH-ve. Ky proces është zbatuar në mënyrë pilot në qarqet e Fierit dhe Dibrës. Procesi i hartimit dhe zbatimit të planeve strategjike dhe operacionale për çdo Qendër të Kujdesit Parësor do të shtrihet në shumicën e strukturave të kujdesit parësor gjatë pesëvjeçarit të ardhshëm;

-Mundësimi i shkëmbimit të përvojave më të mira midis Qendrave Shëndetësore (përsëritja e përvojës në organizimin e mbledhjeve midis qendrave shëndetësore dhe përfaqësuesve të komunitetit me qëllim vendosjen e komunikimit të hapur dhe transparent midis ekipeve të shërbimeve shëndetësore dhe sociale dhe banorëve në zonat e mbuluara në mënyrë që: a) qendrat shëndetësore u përgjigjen drejtpërdrejt kërkesave dhe nevojave të komunitetit dhe, b) banorët mund të kuptojnë më mirë shërbimet e ofruara, si dhe mundësitë dhe kufizimet e kujdesit shëndetësor parësor;

-Zgjerimi i përvojës së ofrimit të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë menaxherët, duke përdorur ri-certifikimin dhe duke u dhënë kredite për temat lidhur me menaxhimin e institucioneve shëndetësore;

-Mundësimi për krijimin, pilotimin dhe menaxhimin e rrjeteve të QSH-ve;

-Standardizimi i dokumentacionit të nevojshëm administrativ (paketa dhe formate të dokumenteve të vihen në dispozicion të ekipeve menaxheriale të qendrave shëndetësore në format elektronik dhe të shtypur).

Rezultatet e pritshme

-Performancë e rritur e menaxhimit operacional të qendrës shëndetësore;

-Kapacitet i rritur për vlerësimin e nevojave dhe propozimi për krijimin e shërbimeve të reja të nevojshme në nivel komuniteti.

Ndryshimi strategjik: Menaxhimi i QSH-ve kthehet në një funksion menaxhimi proaktiv duke përmbushur më mirë nevojat shëndetësore të komuniteteve të tyre

Tregues rezultati për politikën 9

-Të paktën 50% e qendrave shëndetësore kanë përgatitur plane strategjike dhe kryejnë çdo vit shkëmbimin e përvojave më të mira në administrim.

4. MONITORIMI DHE LLOGARIDHËNIA

Për zbatimin e kësaj Strategjie ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sipas planit të veprimit në përputhje me qëllimet e politikës dhe arrijten e objektivave si dhe institucionet e saj të varësisë, Universiteti i Mjekësisë, Urdhri i Infermierëve, mamive, fizioterapistëve të Shqipërisë, Urdhri i Mjekut i Shqipërisë si dhe njësitë e qeverisjes vendore.

Monitorimi i planit të veprimit mbi KSHP do të drejtohet nga grupi tematik për përfshirjen sociale, brenda strukturës së grupit për menaxhimin e integruar të politikave (GMIP) të miratuar me Urdhërin e Kryeministrit Nr. 157, datë 22.10.2018 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”.

Grupi i Treguesve dhe Integritetit të Statistikave (GTIS), do të bashkërendojë aktivitetin monitorues me Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

I gjithë procesi do të kryhet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij dokumenti politik. Gjithashtu në tryezat e konsultimit mund të marrin pjesë përfaqësues nga: INSTAT, qarqet akademike dhe qendrat universitare, shoqëria civile.

Raportet monitoruese dy vjeçare do të përgatiten në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe do të miratohen nga GMIP.

Monitorimi do të bazohet në ndjekjen e treguesve të detajuar për secilin objektiv specifik dhe analizimin e progresit dhe problemeve në secilën prej politikave prioritare. Raporti i standartizuar do të përmbajë fakte dhe të dhëna të standartizuara, bazuar në kornizën e indikatorëve të parashikuar nga ky plan kombëtar.

Në mbështetje të monitorimit të zbatimit të planit të veprimit, lidhur me treguesit e impaktit do të jenë edhe rezultatet kuantitative të siguruar nga sistemet e informacionit spitalor si dhe vlerësime të jetëgjatësisë së shëndetshme, të parashikuara në pasaportën e indikatorëve.

Procesi i përgatitjes së raporteve të monitorimit për planin kombëtar të veprimit do të harmonizohet me përgatitjen e raportit kombëtar për Komisionin Ekonomik të Kombeve të



Bashkuara për Europën (UNECE), mbi progresin lidhur me vijimin e zbatimit të Planit Ndërkombëtar të Veprimit mbi Moshimin, të Madridit dhe Strategjisë Rajonale të Zbatimit (MIPAA/RIS).

5. Referenca

-Të dhëna shëndetësore, INSTAT, FSDKSH, ISHP.

-Raporti kombëtar i sëmundjeve jo të trasmetueshme 2018 ISHP-INSTAT.

-Studimi Demografik Shëndetësor 2018.

-Strengthening people-centred health systems in the WHO European Region: framework for action on integrated health services delivery. WHO Regional office for Europe. 2016.

<http://www.euro.who.int/en/about-us/governance/regional-committee-for-europe/past-sessions/66th-session/documentation/working-documents/eurrc6615-strengthening-people-centred-health-systems-in-the-who-european-region-framework-for-action-on-integrated-health-services-delivery>.

-Primary health care in Albania: Structures and Model of Care. Comprehensive PHC assesment. WHO European Centre for Primary Health Care. WHO Regional Office for Europe. Nov. 2018.

Roadmap to monitoring health services delivery in the WHO European Region. WHO European Centre for Primary Health Care. Copenhagen. WHO Regional Office for Europe 2017. <http://www.euro.who.int/en/health-topics/Health-systems/health-services-delivery/publications/2017/roadmap-to-monitoring-health-services-delivery-in-the-who-european-region-2017>;

-Ligji Nr. 10107, datë 30.03.2009, Mbi kujdesin shëndetësor.

-Ligji Nr. 10138, datë 11.05.2009 Për shëndetin publik.

-Vendimi i Këshillit të Ministrave nr 419, datë 4.7.2018, Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

-Vendimi i Këshillit të Ministrave nr 737, datë 05.11.2014, Mbi financimin e shërbimeve publike të kujdesit shëndetësor në KSHP nga skema e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.

-Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 101 datë 4.2.2015. Paketa e shërbimeve shëndetësore, në KSHP publik që financohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

-Ligji nr. 8652, datë 31.7.2000, Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore (ndryshuar me ligj nr .9208, datë 18.3.2004).

-Strategjia Kombëtare për Shëndetin 2016-2020,

-Plani kombëtar i kontrollit të SJT 2016-2020,

-Plani i veprimit të Promocionit Shëndetësor 2017-2021.

-Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015-2020.

VENDIM

Nr. 407, datë 20.5.2020

PËR DALJEN JASHTË PËRDORIMIT, PËR QËLLIME KULLIMI, TË NJË PJESE TË INFRASTRUKTURËS SË KULLIMIT, NË BASHKINË BERAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr.24/2017, “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave


VENDOSI:

1. Daljen jashtë përdorimit, për qëllime kullimi, të kanalit kullues, me sipërfaqe totale 600 (gjashtëqind) m², në parcelën me numër pasurie 1590/21, volumni 3, faqe 53 dhe bankinës së kanalit me sipërfaqe 1 600 (një mijë e gjashtëqind) m², në parcelën me numër pasurie 1593, volumni 3, faqe 65, zona kadastrale 1587, në njësinë administrative Otlak, Bashkia Berat, sipas përcaktimit në lidhjen 1 (Planrilevimi), që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Brendshme, Bashkia Berat dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**




KUFIJTE:

- VERIU ME PAS. 1593 (PJESE)
- LINDJA ME PAS. 1590 /19
- JUGU ME PAS. 1592 /9
- PERENDIMI ME PAS. 159 /22;7

SHENIME :

- SIP. E PARCELES NR.PAS. 1593 (BANKINE) DHE 1590 /21 (KANAL) KERKOHEN TE MBYLLEN PASI KANE HUMBUR FUKSIONIN E TYRE FILLESTARE.
- KETO SEKSIONE KAPIN NJE SIPERFAQE PREJ 854 M² ,PER PJESEN NE KRAHUN LINDORE TE PASURISE 1592 /21.
- » NGA KETO 577M² PER PJESEN E PASURISE 1590 /21
- » NGA KETO 277M² PER PJESEN E PASURISE 1593

PRONARI
SHTET





PLAN RILEVIMI

PERGATITI :

Emri : Ing. Fuat SHAMETI

Data e Pergatitjes : 23.03.2017

FUAT SHAMETI
ING. TOPOGRAFI
R. LITETZ, 10, 1000

IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE : 1587

NUMRI I PASURISE : 1590/21, 1593 Vol. , Fq.

INDEKSI I HARTES : K - 34 - 112 -(207 - C)

SHKALLA = 1:2500


ADRESA E PASURISE : Rrethi Berat

Fshati : Dushnik, Rr/L:

PRONARI : Shtet

☐ Siperfaqja e Bankines = 130 m²

☐ Siperfaqja e Kanalit = 45 m²





PLAN RILEVIMI

PERGATITI :

Emri : Ing. Fuat SHAMETI

Data e Pergatitjes : 23.03.2017

FUAT SHAMETI
ING. TOPOGRAF
R. LITESH, D. L. L. RAY

IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE : 1587

NUMRI I PASURISE : 1590/21, 1593 Vol. , Fq.

INDEKSI I HARTES : K - 34 - 112 - (207 - C)


SHKALLA = 1:2500

ADRESA E PASURISE : Rrethi Berat

Fshati : Dushnik, Rr/L:

PRONARI : Shtet

- ☒ Siperfaqja e Bankines = 54 m²
- ☒ Siperfaqja e Kanalit = 18 m²





PLAN RILEVIMI

PERGATITI :

Emri : Ing. Fuat SHAMETI

Data e Pergatitjes : 23.03.2017

FUAT SHAMETI
ING. TOPOGRAF
R. L. L. T. D. O. R. B. R. A. Y

IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE : 1587

NUMRI I PASURISE : 1590/21, 1593 Vol. , Fq.

INDEKSI I HARTES : K - 34 - 112 -(207 - C)

SHKALLA = 1:2500


ADRESA E PASURISE : Rrethi Berat

Fshati : Dushnik, Rr/L:

PRONARI : Shtet

☐ Siperfaqja e Bankines = 90 m²

☐ Siperfaqja e Kanalit = 30 m²





PLAN RILEVIMI

PERGATITI :

Emri : Ing. Fuat SHAMETI

Data e Pergatitjes : 23.03.2017

FUAT SHAMETI
ING. TOPOGRAF
R. LICE 109, 12. RAY

IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE : 1587

NUMRI I PASURISE : 1590/21, 1593 Vol. , Fq.

INDEKSI I HARTES : K - 34 - 112 - (207 - C)

SHKALLA = 1:2500

ADRESA E PASURISE : Rrethi Berat

Fshati : Dushnik, Rr/L:

PRONARI : Shtet

- ☐ Siperfaqja e Bankines = 200 m²
☐ Siperfaqja e Kanalit = 70 m²





PLAN RILEVIMI

PERGATITI :

Emri : Ing. Fuat SHAMETI

Data e Pergatitjes : 23.03.2017

FUAT SHAMETI
ING. TOPOGRAFI
D. LESTIT, BERAT

IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE : 1587

NUMRI I PASURISE : 1590/21, 1593 Vol. , Fq.

INDEKSI I HARTES : K - 34 - 112 - (207 - C)

SHKALLA = 1:2500


ADRESA E PASURISE : Rrethi Berat

Fshati : Dushnik, Rr/L:

PRONARI : Shtet

Siperfaqja e Bankines = 200 m2

Siperfaqja e Kanalit = 70 m2





VENDIM
Nr. 408, datë 20.5.2020

PËR MIRATIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES SË TEKSTEVE TË BOTUARA NGA QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN, “KLASIKËT DYGJUHËSH” DHE “FJALOR DYGJUHËSH PËR FËMIJË” DHE TË KATEGORIVE QË PËRFITOJNË FALAS KOPJE TË TEKSTEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të nenit 5, të ligjit nr.16/2018, “Për diasporën”, të shkronjës “gj”, të nenit 21, të ligjit nr.9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, dhe në vijim të pikave 10, shkronja “dh”, dhe 19, të vendimit nr.469, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimeve të shitjes së teksteve të botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, të serisë “Klasikët dygjuhësh” dhe “Fjalor dygjuhësh për fëmijë”, sipas listës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, me qëllim mundësimin e ruajtjes, të zhvillimit dhe të mësimin të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë.

2. Kategoritë që i përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën janë nxënësit dhe mësuesit, sipas përcaktimeve në vendimin nr.443, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë”.

3. Seria “Klasikët dygjuhësh” dhe “Fjalor dygjuhësh për fëmijë”, të botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, duhet të jenë të pajisura me logon e këtij institucioni.

4. Çmimet e serisë “Klasikët dygjuhësh” dhe “Fjalor dygjuhësh për fëmijë” vendosen në kopertinat përkatëse, në përputhje me listën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi, në vlerën prej 2 800 000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekësh, përballohen nga buxheti i

miratuar për Qendrën e Botimeve për Diasporën, për vitin 2020.

6. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lista nr. 1

1. Çmimin në kopertinë prej 800 lekësh për serinë (kolanën) “Klasikët dygjuhësh”.

Seria ka në përbërje 7 libra me nga 2 rrëfenja për secilin titull:

1. E bukura dhe Bisha – Ujku dhe 7 kecat;
2. Hirushja – Pinoku;
3. Libri i xhunglës – 3 derrkucët e vegjël;
4. Rosaku i shëmtuar – Kësulëkuqja;
5. Piter Pani – Bukuroshja e fjetur;
6. Sirena e vogël – Udhëtimet e Guliverit;
7. Ushtari prej plumbi – Borëbardha.

- a) Klasikët dygjuhësorë shqip – italisht
- b) Klasikët dygjuhësorë shqip – greqisht
- c) Klasikët dygjuhësorë shqip – anglisht
- d) Klasikët dygjuhësorë shqip – gjermanisht
- e) Klasikët dygjuhësorë shqip – frëngjisht

2. Çmimin në kopertinë prej 1500 lekësh për librin “Fjalor dygjuhësh për fëmijë”.

- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – italisht
- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – greqisht
- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – anglisht
- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – gjermanisht

gjermanisht

- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – turqisht
- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – frëngjisht
- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – ukrainisht
- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – kroatisht
- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – spanjisht



VENDIM
Nr. 409, datë 20.5.2020

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Lorena Haxhiu, zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr.193/2, datë 14.5.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN
NR. 193, DATË 20.3.2020 “PËR
MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E
LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4 dhe 15, të ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në vijim të shkresave të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 2470, prot, datë 29.4.2020 dhe nr. 2604, datë 8.5.2020,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 193, datë 20.3.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në listën bashkëlidhur këtij urdhri bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:

126	ARSIMIMI Vetëm institucionet e arsimit parauniversitar, të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	LEJOHEN
-----	---	---------

	për zhvillimin e procesit mësimor dhe provimeve të Maturës Shtetërore në datat e vendosura nga kjo ministri.	
--	--	--

2. Institucionet arsimore të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri do të ushtrojnë veprimtarinë në zbatim të protokolleve të miratuara për “Masat ndaj COVID-19”, që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr.193/3, datë 15.5.2020

“PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN
NR. 193, DATË 20.3.2020 “PËR
MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E
LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.193, datë 20.03.2020 “Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Fjalja e fundit e pikës 3, ndryshohet si më poshtë:

“Përfshijmë nga ky rregull bëhet për pikat e shitjes së produkteve ushqimore me pakicë dhe farmacitë, të cilat ditën e shtunë, datë 16 maj 2020, lejohen të ushtrojnë aktivitetin e tyre deri në orën 17:30.”

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu



URDHËR

Nr. 193/4, datë 15.5.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN
NR. 193, DATË 20.3.2020
“PËR MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E
LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.193, datë 20.3.2020 “Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në tabelën bashkëlidhur urdhrit bëhet ky ndryshim:

131	Bibliotekat, arkivat, muzeumet dhe të tjera aktivitete kulturore	Lejohen (Përfshihen aktivitetet kulturore, të cilat vijnë të jenë të mbyllura deri në një urdhër të dytë.)
-----	--	---

2. Aktivitetet e përcaktuara si të lejuara në pikën 1 të këtij urdhri, të respektojnë rregullat e distancimit social dhe të higjenes, sipas protokolleve të miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik.

3. Çdo parashikim që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR

Nr. 319, datë 15.5.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN
NR 263, DATË 17.4.2020 “PËR
PËRCAKTIMIN E ORAREVE TË
LËVIZJES PËR KËMBËSORËT
PENSIONISTË, TË SËMURËVE
KRONIKË NË TRAJTIM MJEKËSOR
DHE TË RREGULLAVE PËR LËVIZJEN
E MJETEVE PRIVATE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 7 të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 263 datë 17.04.2020 “Për përcaktimin e orareve të lëvizjes për këmbësorët, pensionistë, të sëmurëve kronikë në trajtim mjekësor dhe të rregullave për lëvizjen e mjeteve private”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 riformulohet si vijon:

“1. Lejohet lëvizja e këmbësorëve pensionistë, ditën e shtunë dhe ditën e diel, datë 16 dhe 17 maj 2020 deri në orën 10:00, të shoqëruar me jo më shumë se një person në krah.”

2. Pika 1/1 riformulohet si vijon:

“1/1. Lejohet lëvizja e prindërve me fëmijëve deri në moshën 14 vjeç, ditën e shtunë dhe ditën e diel, datë 16 dhe 17 maj 2020, nga ora 11:00 deri në orën 17:30, të shoqëruar me persona të tjerë në krah”

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu



URDHËR

Nr. 320, datë 15.5.2020

“PËR DISA KUFIZIME NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË BARE, RESTORANTE DHE LOKALE, *FAST-FOOD*”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si dhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19 në Republikën e Shqipërisë,

URDHËROJ:

1. Ofrimin e shërbimit në bare, restorante dhe lokale, *fast-food*, në të gjithë vendin, duke filluar nga data 18 maj, vetëm në mjediset e tyre të hapura, sipas orareve të përcaktuara në urdhrat përkatëse për secilën zonë, duke respektuar protokollat e sigurisë, të miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe subjektet që ushtrojnë aktivitetet e përcaktuara në pikën 1, të këtij urdhri.

3. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor mbikëqyr zbatimin e urdhrat dhe vendos masën e gjobës, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Urdhri nr. 164, datë 12.3.2020 “Për mbylljen e bareve, restoranteve dhe lokaleve, *fast-food* dhe kufizimin e shërbimeve që ofrohen nga struktura akomoduese që ofrojnë shërbim për klientët” dhe çdo urdhër tjetër që bie në kundërshtim me parashikimet e këtij urdhri, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR

Nr. 326, datë 15.5.2020

PËR KUFIZIMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, nenit 7, pika 4 gërma b të ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Stërvitjet e sportistëve lejohen të zhvillohen, për të gjithë llojet e sporteve, vetëm në ambiente të hapura.

2. Aktivitetet sportive dhe stërvitjet e sportistëve në ambiente të mbyllura vijojnë të jenë të ndaluara.

3. Aktivitetet e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri të kryhen duke respektuar protokollat e sigurisë të miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik.

4. Ngarkohet për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.

5. Çdo parashikim i mëparshëm që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR

Nr. 327, datë 18.5.2020

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 193, DATË 20.3.2020 “PËR MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e



shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.193 datë 20.3.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:

1. Në të gjithë përmbajtjen e urdhërit fasha orare zgjatet deri në orën 21:00.
 2. Paragrafi i parë e pikes 1/1 shfuqizohet.
 3. Në të gjithë vendin, hiqen autorizimet për lëvizjen e këmbësorëve apo automjeteve gjatë javës.
 4. Çdo parashikim në udhrat e mëparshëm që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR

Nr. 328, datë 18.5.2020

“PËR DISA SHTESA NË URDHRIN NR.279, DATË 25.4.2020 “PËR LEHTËSIMIN E POSAÇËM TË LËVIZJES NË “ZONAT E GJELBËRTA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 7, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, si dhe vendimit nr. 2357, datë 16.5.2020 të Komitetit të Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirus i ri, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 279 datë 25.4.2020 “Për lehtësimin e posaçëm të lëvizjes në “Zonat e Gjellbërta”, të ndryshuar bëhet shtesa dhe ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1, pas fjalës “Peqin”, shtohet fjala “Fier”.

2. Pikat 2 dhe pika 3, shfuqizohen.
 3. Në pikën, 6 togfjalëshi “nga ora 09:30 deri në orën 21:30”, shfuqizohet.
 4. Pika 6/1 shfuqizohet.
 5. Çdo parashikim i mëparshëm që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR

Nr. 333, datë 20.5.2020

PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT TË INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK PËR “MASAT NDAJ COVID-19 QË DUHET TË NDERMARRIN INSTITUCIONET E KOPSHTJEVE DHE ÇERDHEVE”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni COVID-19,

URDHËROJ:

1. Miratimin e udhëzuesit të Institutit të Shëndetit Publik për “Masat ndaj COVID-19 që duhet të ndërmarrin institucionet e kopshteve dhe çerdheve”.
 2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Ministria përgjegjëse për arsimin dhe organet e qeverisjes vendore.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu



UDHËZUES

PËR “MASAT NDAJ COVID-19 QË DUHET
TË NDERMARRIN INSTITUCIONET E
KOPSHTEVE DHE ÇERDHEVE”PËR FËMIJËT E KOPSHTEVE DHE
ÇERDHEVE**A - Sjellja dhe marrja e fëmijëve nga
institucioni (çerdhe, kopësht)**

- Orari për sjelljen dhe marrjen e fëmijëve në këto institucione rregullohet sipas një grafiku të hartuar nga drejt e institucionit dhe të monitoruar nga edukatorët.

- Në hyrje dhe në dalje të institucionit të vendoset një higjenizues për duart në trajtë solucion me përmbajtje aktive të alkoolit 60% i cili duhet të jetë gjatë gjithë kohës i pranishëm, në mënyrë që fëmijët të pastrojnë duart kur vijnë dhe kur ikin.

- Prindërit duhet të sjellin dhe marrin fëmijët duke respektuar me përpikmëri në orarin e përcaktuar.

- Fëmija shoqërohet nga njëri prind, i cili qëndron jashtë ambienteve të institucionit dhe pret në distancë 1.5 m nga prindërit e tjerë për ta dorëzuar fëmijën tek personeli i çerdhes/kopështit.

- Gjithmonë fëmija të pritët dhe shoqërohet brenda institucionit nga një edukatore e cila e merr fëmijën në hyrje të kopështit/çerdhes.

- Drejtuesi i institucionit duhet të caktojë një person i cili në momentin kur fëmija hyn në institucion të kryejë çdo ditë:

- Matjen e temperaturës me termometër digjital.

- Pastrimin e duarve të fëmijës me solucionin higjenizues në momentin që hyn në çerdhe/kopësht.

- Nëse është e mundur të vendosen vaska me solucion dezinfektues me bazë klori aktiv, për dezinfektimin e shuajve të këpucëve përpara hyrjes në ambientet e brendshme të çerdhes/kopështit.

- Fëmija lejohet të hyjë dhe të dalë nga institucioni vetëm në mbërritje dhe në ikje.

- Rekomandohet që sjellja apo marrja e fëmijëve nga çerdhja/kopështi të bëhet nga prindi dhe jo nga gjyshërit.

- Dera e institucionit do të qëndrojë e mbyllur gjatë kohës që fëmijët janë brenda, ndërsa dritaret e sallave të hapen herë pas here për të lejuar ajrosjen

e nevojshme brenda tyre. Ambjenti duhet të jete i ajrosur gjatë gjithë kohës.

- Në rast se fëmija shfaq temperaturë, prindi duhet të informojë menjëherë edukatoren dhe të mbajë fëmijën në shtëpi.

- Nëse fëmija shfaq temperaturë apo shenja të tjera të shëndetit jo të mire, njoftohet prindi që të paraqitet për të marrë fëmijën sa më pare nga ambientet e kopështit/çerdhes.

**B - Strategjitë e distancimit shoqëror gjatë
qëndrimit në kopësht/çerdhe**

- Rekomandohet shfrytëzimi maksimal i ambienteve të institucionit, për të ruajtur distancimin fizik në grupet me numër të madh të fëmijëve.

- Fëmijet e një grupi duhet të qëndrojnë në të njëjtën sallë/dhomë çdo ditë dhe me të njëjtën edukatore.

- Rekomandohet të mos kryhet asnjë aktivitet jashtë ambienteve të kopështit.

- Gjatë procesit mësimor, edukatorët qëndrojnë duke respektuar distancën dhe rekomandohet të përpiqen t'i vendosin fëmijët në distancë nga njëri tjetri (p.sh. rreth një tavolinë me 10 karrige ulen 5 fëmijë).

- Të merren masat e nevojshme që fëmijët të mos ndihmojnë në perhapjen e transmetimit të virusit duke:

- Mbajtur secilin grup fëmijësh në një dhomë/sallë të veçantë.

- Kufizuar përzierjen e fëmijëve midis grupeve, në kohën që ata kryejnë aktivitete të tilla si lojra ne oborr, duke hartuar një grafik sipas grupeve për këto aktivitete.

- Lojrat me njëri tjetrin, apo aktivitete të tjera, duhet të organizohen në mënyrë që të respektohet gjithmonë brenda mundësive distancimi fizik midis fëmijëve.

- Në kohën e gjumit të shfrytëzohet hapësira e dhomës maksimalisht duke i vendosur fëmijët larg nga njëri tjetrit.

- Rekomandohet të mos organizohen festa ditëlindjesh të fëmijëve në kopësht.

Kujdesi në mjediset e kopështit/çerdhes**A - Kujdesi për higjienën**

- Fëmijët duhet të ndërgjegjësohen për rëndësinë që ka distancimi fizik dhe higjiena personale në ambientet brenda dhe jashtë institucionit, nëpërmjet mesazheve të dhëna nga edukatorja.



- Fëmijëve duhet tu flitet në mënyrë të vazhdueshme për COVID-19, rregullat e higjienës, larjen e duarve, mënyrën e duhur të kollitjes dhe teshitjes.

- Të vendosen postera të veçantë për mënyrën e larjes së duarve.

- Në ambientet e institucionit të afishohen postera mbi masat e parandalimit të infektimit me COVID-19, higjienën respiratore dhe atë personale si dhe rregullat për distancimin fizik, të dizenuara në mënyrë sa më të thjeshtë dhe të kuptueshme nga fëmijët.

- Çdo fëmijë duhet të nxitet të lajë duart pas çdo veprimi që mund të përbëjë rrezik për përhapjen e virusit: prekja e hundës, syve, gojës etj.

- Duhet të sigurohen: uji i rrjedhshëm, sapuni i lëngët, letra për fshirjen e duarve dhe xheli me përmbajtje alkooli 60%, në ambientet e institucionit.

- Të kryhet dezinfektimi i çdo dhome, çdo ditë. Pas largimit të fëmijëve, të kryhet pastrimi i sipërfaqeve dhe orendive me lëndë dezinfektuese.

- Në fund të çdo dite duhet të kryhet edhe dezinfektimi i mjedisve të përbashkëta.

Pastrimi dhe dezinfektimi i lodrave

- Lodrat të cilat nuk mund të dezinfektohen nuk duhet të përdoren.

- Lodrat apo objektet që futen në gojë dhe që janë të ndotur me sekrecione duhet të largohen dhe të mos përdoren deri sa të dezinfektohen.

- Lodrat prej rrobe që mund të lahen në lavanderi duhet të përdoren vetëm nga një fëmijë dhe më pas të lahen, përpara se të përdoren nga një fëmijë tjetër.

- Lodrat apo mjetet didaktike nuk duhet të kalohen nga një grup (klasë) në tjetrën pa i larë më parë apo dezinfektuar ato.

- Librat e fëmijëve, si dhe materialet e tjera me bazë letre, si letra, zarf, revista, dosje nuk konsiderohen se përbëjnë një rrezik të lartë për transmetim dhe nuk kanë nevojë për procedura shtesë të pastrimit ose dezinfektimit.

Kujdesi për foshnjat dhe fëmijët e vegjël

- Ndërrimi i pampersit

- Kur ndërrohet një fëmijë, më parë duhen larë duart, më pas duhen përdorur doreza për të vijuar me ndërrimin.

B - Për Edukatorët

- Staf i mjekësor i institucionit ose personeli i institucionit i caktuar nga drejtuesi dhe i trajnuar

për veprimet e mëposhtme, kryen për çdo fëmijë procedurën si vijon:

- Mat temperaturën me termometër digjital për të gjithë fëmijët si edhe për të gjithë stafin e kopshtit/çerdhes.

- Spërkat dezinfektues me me përmbajtje alkooli 60% në duart e fëmijëve dhe të stafit.

- Vëren gjëndjen shëndetësore të fëmijëve si edhe ruajtjen e masave higjieno-sanitare prej tyre.

- Gjatë kohë që edukatorja qëndron me fëmijët duhet të përpiqet të respektojë distancimin social duke i orientuar ata në vendet ku duhet të qëndrojnë.

C - Për personelin ndihmës

- Drejtuesi i institucionit duhet të hartojë një grafik me oraret për pastimin dhe dezinfektimin e institucionit.

- Rekomandohet pastrimi në mënyrë rutinë i sipërfaqeve dhe objekteve të cilat preken më shpesh nga fëmijët, veçanërisht lodrat, karriget, tavolinat, kutitë e lodrave, etj.

- Pastrimi i këtyre objekteve nuk duhet kryer në prani të fëmijëve në dhomë/ambient.

- Korridoret dhe tualetet pastrohen dhe dezinfektohen rregullisht sipas një grafiku.

- Sanitaret të mbajnë gjatë gjithë orarit të punës maskën, dorezat.

- Largimi nga institucioni bëhet pas përfundimit të pastrimit dhe dezinfektimit të çdo ambienti të tij.

- Kryhen të gjitha detyrat duke respektuar distancimin social me fëmijët dhe edukatorët dhe stafin.

Përgatitja e ushqimit dhe shërbimi i tij

A - Punonjësit e kuzhinës

- Personeli që përgatit ushqimin duhet të mbajë gjithmonë maskë.

- Personeli duhet të lajë gjithmonë duart para, gjatë dhe pas mbarimit të përgatitjes së ushqimit.

- Mjetet dhe sipërfaqet që përdoren për përgatitjen e ushqimit duhet të lahen para dhe pas përdorimit të tyre.

- Lavamanet që përdoren për larjen dhe përgatitjen e ushqimit nuk duhet të përdoren për asgjë tjetër.

- Mjedisi ku kryhet ushqyerja e fëmijëve duhet të pastrohet dhe dezinfektohet para dhe pas ngrënies së çdo grupi të fëmijëve.

- Edukatorët duhet të sigurohen që fëmijët t'i lajnë duart gjithmonë para dhe pas ngrënies, ose t'u pastrohen herë pas here (për fëmijët e çerdheve).



- Edukatorët duhet t'i lajnë duart gjithmonë para përgatitjes së ushqimit si dhe pasi i ndihmojnë fëmijët për të ngrënë.

PËR PRINDIN

- Nënshkruan ose konfirmon në rrugë elektronike, tek edukatorja, këtë rregullore.

- Plotëson formularin e vetëdeklarimit ditor me përgjegjësi për gjëndjen shëndetësore të fëmijës në numrin e kontaktit të edukatores.

- Në rast nevojë për komunikim me edukatoren apo drejtuesin përdoret vetëm komunikimi elektronik.

- Në rastet e shoqërimit të fëmijës në institucion, prindi nuk duhet të hyjë në mjediset e brendshme për asnjë arsye.

- Prindi duhet të deklarojë nëse ka patur kontakt me persona të prekur me COVID-19 në familje apo në ambientet e punës.

- Në rast se fëmija shfaq temperaturë apo simptoma të tjera të shëndetit jo të mirë, prindi duhet të paraqitet menjëherë për të marrë fëmijën.

PËR DREJTUESIT

- Të sigurojnë pajisjen e stafit me mjetet mbrojtëse, si: maska, doreza, solucione dezinfektuese.

- Për çdo fëmijë i cili paraqet probleme shëndetësore si rritje të temperaturës, të konstatuar në ambientet e institucionit apo të njoftuar nga prindi, ka patur kontakt me dikë të prekur me COVID-19, si dhe nëse prindi përkatës është i sëmurë, apo ka patur kontakte me persona të prekur nga COVID-19, drejtuesi lajmëron menjëherë Njësine Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJ.V.K.SH) dhe strukturën përkatëse për këtë njësi.

- Për çdo edukatore apo personel tjetër të institucionit, i cili paraqet probleme shëndetësore, si psh. rritje të temperaturës, etj., apo ka njoftim se ka patur kontakt me dikë të prekur me COVID-19, drejtuesi lajmëron menjëherë Njësine Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJ.V.K.SH) dhe strukturën përkatëse në këtë njësi.

Shënim: Ky udhëzues mund të ndryshojë në varësi të nevojave të lidhura direkt me ndryshimin e situatës epidemiologjike në vend.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 672 lekë